

LETRAT E HIRZIUT

DREJTUAR NJË DJALLI TË RI, NGA XHAXHAI I TIJ I MOSHUAR

Clive Staples Lewis (1898-1963) ishte një nga intelektualët më të mëdhenj të shekullit XX dhe pa diskutim shkrimtari më me ndikim i kohës. Ai ishte pedagog dhe udhëheqës shkencor për letërsinë angleze në universitetin e Oksfordit deri në vitin 1954, kur edhe u zgjodh njëzëri përgjegjës i departamentit të anglishtes së Mesjetës dhe Rilindjes në universitetin e Kembrixhit, post ku qëndroi derisa doli në pension. Shkroi mbi 30 libra, duke bërë për vete një publik të larmishëm dhe duke vazhduar të tërheqë mijëra lexues të rinj çdo vit, edhe sot e kësaj dite. Ndër veprat e tij më të spikatura dhe më të njohura janë *Kronikat e Narnias*, *Trilogjia kozmike*, *Katër dashuritë*, *Letrat e Hirziut* dhe *Thjesht krishtërim*.

Titulli origjinal i veprës:
The Screwtape Letters by CS Lewis
© C. S. Lewis Pte Ltd. 1942. First published by Geoffrey Bles in 1942.
Published by Collins in 1957
Published by Shigjeta Publishing House under license from
The CS Lewis Company Ltd.

Faqja e internetit të autorit: www.cslewis.com

Titulli i përkthimit në shqip:
Letrat e Hirziut
C. S. Lewis



Botuar nga shtëpia botuese “Shigjeta”.
© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Ndalohet ribotimi i këtij libri pa marrë
më parë lejen me shkrim nga botuesi, tërësisht apo pjesërisht,
si dhe fotokopjimi apo shumëfishimi në çfarëdo lloj mënyre.

Përktheu: Sergej Meçe
Redaktoi: Fabiola Kadi
Faqosja: Vision Printing shpk

ISBN: 978-9928-295-64-4

Shtëpia Botuese “Shigjeta”
Rr. Niko Dodona, nr. 6, Korçë, 7001
Albania
Email: shtepiabotueseshigjeta@gmail.com

Shtypur në shtypshkronjën “Vision Printing shpk”
Tirazhi: 500 kopje

LET RAT E HIRZIUT

DREJTUAR NJË DJALLI TË RI, NGA XHAXHAI I TIJ I MOSHUAR

— *C. S. Lewis.* —

PASUAR NGA
HIRZIU NGRE NJË DOLLI

Ky botim do të pasohet nga libri
Thjesht krishtërim i të njëjtit autor.

Dedikuar J. R. R Tolkien-it

“Mënyra më e mirë për ta zbuar djallin, nëse u reziston teksteve të Shkrimit, është ta përqeshësh dhe ta përçmosh, pasi ai nuk e duron dot fyerjen.”

MARTIN LUTERI

“Djalli . . . ky shpirt krenar . . .
nuk duron dot kur e tallin.”

THOMAS MORE

PARATHËNIE

Nuk kam ndërmend të sqaroj si më ra ndër duar letër-këmbimi që po i ofroj sot publikut. Për sa u përket djajve, ne si racë njerëzore mund të biem në dy gabime, sa të ngjashëm, aq edhe të ndryshëm nga njëri-tjetri. Njëri është mosbesimi në ekzistencën e tyre. Tjetri është besimi dhe interesi i tepruar e i pashëndetshëm për ta. Ata vetë janë njëlloj të kënaqur me të dy gabimet dhe e brohorasin materialistin me po aq kënaqësi sa edhe magjistarin. Stili që kam përdorur në këtë libër mund të mësohet lehtësisht nga kushdo që arrin të kuptojë mekanizmin; por keqdashësit dhe të pamaturit, të cilët mund ta përdorin atë për keq, nuk kanë për ta mësuar nga unë.

I këshilloj lexuesit të kenë parasysh se djalli është gënjeshtar. Jo gjithçka që thotë Hirziu duhet marrë si e vërtetë, edhe duke e parë nga këndvështrimi i tij. Unë nuk kam bërë asnjë përpjekje të identifikoj ndonjë nga qeniet njerëzore; por mendoj se ka pak gjasa që portretet

si, Atë Spajku apo nëna e pacientit, të jenë të plotë si karaktere. Edhe në Ferr mund të shihen ëndrra me sy hapur, ashtu si në Tokë.

Së fundmi, më duhet të shtoj se nuk kam bërë asnjë përpjekje për t'i vendosur letrat në mënyrë kronologjike. Ajo me numër XVII duket të jetë shkruar para se racioni-mi i kohës të bëhej diçka e rëndësishme; por përgjithësisht metoda djallëzore e llogaritjes së kohës duket se nuk ka lidhje me kohën tokësore dhe unë nuk jam munduar ta kopjoj atë. Historia e luftës në Europë, përveçse në rastet kur ndikonte në gjendjen shpirtërore të një qenieje njerëzore, duket qartë që nuk i interesonte Hirziut.

C. S. LEWIS
MAGDALEN COLLEGE
5 KORRIK 1941

LETRAT
E HIRZIUT

I

I dashuri im Krimbaq,

Kam qenë duke menduar për atë që më shkrove për ndikimin në leximet e pacientit tënd, si dhe kujdesin që po tregon që ai të kalojë sa më tepër kohë me mikun e vet materialist. Por, nuk mendon se po tregohesh pak *naiv*? Fjalët e tua të bëjnë të mendosh se *diskutimi* është mënyra e duhur për ta mbajtur larg kthetrave të Armikut. Mund të kishte qenë kështu, nëse ai do të kishte jetuar shekuj më parë. Asokohe njerëzit ende e dinin shumë mirë se kur diçka vërtetohej e kur jo; dhe nëse bindeshin, e besonin atë me të vërtetë. Ata ende e lidhnin të menduarit me të vepruarit dhe ishin gati që, si rezultat i një sërë arsyetimesh, ta ndryshonin mënyrën e jetesës. Por, me shtypin e përjavshëm dhe me armë të tjera si këto, ia dolëm ta ndryshojmë gjerësisht këtë fenomen. Njeriu yt është mësuar që fëmijë të ketë në kokë një duzinë filozofish të papajtueshme me njëra-tjetrën, të cilat vërtiten rreth

njëra-tjetrës atje brenda. Kur i studion doktrinat, nuk shikon në radhë të parë nëse janë ‘të vërteta’ apo ‘të rreme’, por, a janë ‘akademike’ ose ‘praktike’, ‘të vjetra’ ose ‘bashkëkohore’, ‘tolerante’ ose ‘të ngurta’. Aleati yt më i mirë për ta mbajtur larg nga Kisha pacientin tënd nuk është argumenti, por fjalët boshe. Mos humb kohë duke e nxitur të mendojë se materializmi është *i vërtetë!* Futi në kokë mendimin se materializmi është tregues i forcës, guximit, apo trimërisë – se është filozofia e së ardhmes. Për kësi gjërash merakoset ai.

E keqja e argumentimit është se e zhvendos të gjithë betejën në terrenin e vetë Armikut. Edhe ai di të argumentojë; ndërkohë që në propagandën praktike të llojit për të cilin po të flas, duket prej shekujsh me radhë se Armiku është tejet inferior ndaj Atit tonë atje Poshtë. Vetë akti i argumentimit e zgjon arsyen e pacientit; dhe, në çastin kur kjo është zgjuar, kush mund ta parashikojë rezultatin? Edhe nëse do të mund të shtrembërosh ndonjë rrymë të caktuar arsyetimi në favorin tonë, do të shohësh se do të forcosh tek pacienti yt zakonin fatal për t’u kushtuar vëmendje çështjeve universale, duke e larguar atë nga rrjedha e përvojave shqisore të çastit.

Detyra jote është t'ia fiksosh vëmendjen te kjo rrjedhë. Mësoje ta quajë 'jeta reale' dhe mos e lejo të bëjë pyetjen se ç'do të thotë fjala 'reale'.

Ki parasysh se ai nuk është thjesht shpirt, siç je ti. Për shkak se nuk ke qenë kurrë njeri (Ah, ky avantazh i neveritshëm i Armikut!), ti nuk e kupton se sa të skllavëruar janë ata ndaj trysnisë së gjërave të zakonshme. Dikur kisha një pacient, ateist i flaktë, i cili shkonte për të lexuar në "British Museum". Një ditë, teksa u ul të lexonte, vura re se filli i një mendimi shkoi në drejtimin e gabuar. Armiku, natyrisht, ishte ulur pranë tij. Përpara se të arrija të mblidhja veten, pashë tek po më tretej gjithë puna që kisha bërë për njëzet vite me radhë. Po ta kisha humbur toruan dhe të kapesha pas argumentit për t'u mbrojtur, do të kishte qenë fundi për mua. Por unë nuk isha aq mendjelehtë. Godita menjëherë në atë pjesë të tijën që e kisha më tepër nën kontroll dhe i pëshpërita se po i afronte koha e drekës. Besoj se Armiku i dha këshillën e kundërt (e ke vënë re se asnjëherë nuk e dëgjojmë se çfarë u thotë Ai njerëzve *saktësisht*?), duke i thënë se kjo ishte më e rëndësishme se dreka. Të paktën, kjo, ma ha mendja, do të ketë qenë përpjekja e tij, sepse kur i

thashë: «Shumë mirë. Në fakt, është *tepër* e rëndësishme të mendosh mbi këtë çështje kur paradites tashmë po i vjen fundi», pacienti u gjallërua shumë; dhe derisa shtova: «Do të jetë shumë më mirë të kthehesh pas drekës dhe ta trajtosh çështjen me mendje të freskët», ai e kishte bërë tashmë gjysmën e rrugës për te dera. Me të dalë në rrugë, beteja ishte e fituar. I tregova gazetashitësin, i cili po shpallte me zë të lartë titujt e gazetës së drekës, një autobus, me Nr. 73, që po kalonte dhe, përpara se të mbërrinte në fund të shkallëve, e binda njëherë e mirë se, çfarëdo idesh të çuditshme t'i hyjnë njeriut në kokë kur mbyllet i vetëm me librat, një dozë e shëndetshme 'jete reale' (në këtë rast autobusi dhe gazetashitësi) mjafton për ta bindur se "të gjitha ato gjëra" thjesht nuk mund të jenë të vërteta. Ai e dinte se shpëtoi për një fije, dhe më vonë ndiente një kënaqësi të madhe teksa fliste për 'atë nevojë të pashprehur për aktualitet e cila është mburoja jonë e fundit kundër lajthitjeve të logjikës së thjeshtë.' Tani, ai njeri është i sigurt në shtëpinë e Atit tonë.

A po e kupton çfarë dua të të them? Falë proceseve që filluam tek ata shekuj më parë, për njerëzit është gati e pamundur ta besojnë të pazakonshmen kur e kanë

të zakonshmen përpara syve. Vazhdo të vësh theksin mbi *të zakonshmen* e gjërave. Mbi të gjitha, mos bëj provë ta përdorësh shkencën (shkencat e vërteta, e kam fjalën), si mbrojtje kundër krishtërimin. Ato nuk do të bëjnë gjë tjetër veçse ta nxitin të mendojë për realitete të cilat nuk mund t'i prekë e as t'i shohë. Ka pasur raste të trishtueshme ndër fizikanët modernë. Nëse do patjetër që të llapashitet në shkencë, lidhe pas ekonomisë dhe sociologjisë; mos e lejo të largohet nga kjo e vyer “jetë reale”. Madje, idealja do të ishte të mos e lejoje të lexojë fare shkencë, por t'i jepje idenë madhështore se ai e njeh të gjithë shkencën dhe se gjithçka që përfton në biseda apo lexime të rastësishme janë ‘rezultate të studimeve shkencore të fundit’. Mbaje mirë ndërmend se detyra jote është ta *çoroditësh*. Nga mënyra sesi flisni disa nga ju djajtë e rinj, të krijohet ideja sikur detyra juaj është të *jepni mësim*.

Khaxhi yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Me trishtim të thellë të bëj me dije se pacienti yt u bë i krishterë. Mos ushqe ndonjë shpresë se mund t'u shmangesh dënimeve që jepen në këto raste; vërtet, as mos ëndërro t'u shpëtosh pasojave. Ndërkohë, të shikojmë ç'mund të nxjerrim nga kjo situatë. Nuk duhet të dëshpërohem; qindra nga këta të kthyer tek Armiku janë rifituar pas një rrugëtimi të shkurtër në kampin kundërshtar dhe tani janë me ne. Të gjitha *zakonet* e pacientit në fushën e mendjes apo të trupit, ende janë në favorin tonë.

Një nga aleatët tanë më të mëdhenj për momentin është vetë kisha. Përpiqu të mos më keqkuptosh. Nuk e kam fjalën për kishën ashtu siç e shohim ne, të përhapur në kohë dhe hapësirë dhe të rrënjosur në përjetësi, e tmerrshme si një ushtri me flamuj valëvitës. E pranoj, ky është një spektakël që bën nervozë edhe tunduesit tanë më

të guximshëm. Por, për fat, kjo është krejt e padukshme për njerëzit. Gjithçka shikon pacienti yt, është një godinë gjysmë e përfunduar me stil të rremë gotik, e ngritur në një vend të caktuar. Kur hyn brenda saj, gjen shitësin e lagjes, i cili, me një fytyrë të dhjamosur, nxiton t'i japë një libërth me kapak të shndritshëm që përmban një liturgji të cilën asnjëri prej tyre nuk e kupton dhe një libërth tjetër të përdorur, me faqe të zhubrosura të një liste këngësh fetare, të printuara keq, aq sa mezi lexohen fjalët. Kur arrin te stoli i tij dhe hedh një sy rreth e qark, shikon se kanë ardhur pikërisht ai grup fqinjësh të cilëve deri tani është munduar t'u shmanget. Përqendrohu sa të jetë e mundur tek ata fqinj. Bëj që mendja e pacientit tënd të fluturojë sa andej-këtej, nga fraza të tilla si 'trupi i Krishtit' tek fytyrat që sheh në stolin aty pranë. Sigurisht, nuk ka shumë rëndësi se çfarë lloj njerëzish janë në të vërtetë ata që ndodhen në stolin pranë tij. Ti ndoshta mund ta njohësh njërin prej tyre si luftëtar të madh në anën e Armikut. Nuk ka rëndësi. Pacienti yt, falë Atit tonë atje Poshtë, është i cekët në gjykim. Mjafton që njëri prej tyre të stonojë teksa këndon, apo të ketë këpucë që i kërcasin, apo gushën e varur, apo veshje të çuditshme

dhe pacienti yt do të dalë shpejt në përfundimin se edhe besimi i tyre, për këto arsye, duhet të jetë qesharak. Sepse, në fazën ku ndodhet tani, ai ka në mendje një ide të caktuar për “të krishterët”, të cilën ai e konsideron si shpirtërore, por që në fakt është vetëm piktoreske. E ka mbushur mendjen me tunika, sandale, armatime e këmbë të zbathura dhe vetëm fakti që të tjerët në kishë veshin rroba moderne, përbën një pengesë serioze për të, megjithëse, natyrisht, ai nuk e kupton. Mos lejo kurrë që të bëhet i vetëdijshëm për këtë problem; mos e lejo për asnjë moment të pyesë veten sesi pret ai të duken të krishterët nga pamja e jashtme. Mbaje gjithçka në mendjen e tij në gjendje të mjegullt tani dhe do të kesh gjithë përjetësinë në dispozicion për t’u argëtuar e për të prodhuar tek ai atë qartësi të veçantë që ofron Ferri.

Puno fort, pra, me zhgënjimin, i cili, pa dyshim do ta befasojë pacientin në javët e tij të para si anëtar i kishës. Armiku lejon të ndodhë një zhgënjim i tillë në fillim të çdo përpjekjeje njerëzore. Kjo ndodh në çastin kur djaloshi, i magjepsur që në kopsht me “*Aventurat e Odisesë*”, i vihet seriozisht studimit të greqishtes. Ndodh kur dy të dashuruar martohen dhe nisin të kuptojnë

përgjegjësitë e jetesës së bashku. Në çdo fushë të jetës, ka një moment që shënon kalimin nga faza ëndërrimtare në realitetin e veprimit. Armiku e lejon këtë rrezik, sepse ka një fantazi të çuditshme për t'i kthyer të gjithë këta krimba të neveritshëm njerëzorë në të ashtuquajtur të dashurit dhe shërbëtorët e tij “të lirë”; “bij” është fjala që përdor ai, në dashurinë e tij të pandreqshme për ta prishur gjithë botën shpirtërore me lidhjet e panatyrshme me kafshët dykëmbëshe. Për shkak se dëshiron lirinë e tyre, Ai refuzon t'i mbajë të lidhur pas qëllimeve të tij bazuar thjesht tek ndjenjat apo tek forca e zakonit. Ai i lë ta marrin vetë vendimin me vullnet të lirë. Dhe këtu ne kemi një mundësi për të ndërhyrë. Por, gjithashtu, mbaje mend mirë se këtu gjendet edhe rreziku. Nëse e kalojnë me sukses këtë thatësirë të fillimit, ata bëhen më pak të varur nga emocioni dhe, si rrjedhojë, bëhet më e vështirë t'i tundosh.

Të kam shkruar deri tani bazuar në supozimin se njerëzit në stolin ngjitur nuk paraqesin asnjë *mundësi* nga ana logjike për zhgënjim. Sepse, nëse ndodh e kundërta – nëse pacienti e di se gruaja me kapele të çuditshme është lojtare fanatike e lojës me letra “bridge”, apo burri me

këpuçë që kërcasin është koprac dhe fajdexhi – atëherë detyra jote do të jetë shumë më e lehtë. Thjesht duhet ta mbash larg mendjes së tij pyetjen: «Nëse unë, kështu siç jam, mundem në njëfarë mënyre ta konsideroj veten të krishterë, pse vallë veset e ndryshme të atyre njerëzve në stolin tjetër duhet të më bindin se feja e tyre është thjesht hipokrizi dhe formalitet?». Ty mund të të lindë pyetja se a është e mundur vallë që të shmanget një mendim kaq i dukshëm nga një mendje njerëzore. Po, Krimbaq, po, është e mundur! Trajtoje atë siç duhet dhe kjo pyetje nuk do t'i shkojë kurrë ndër mend. Nuk ka kaluar akoma aq shumë kohë me Armikun sa të ketë fituar diçka që quhet përrulësia e vërtetë. Fjalët që thotë ai, edhe në gjunjë, në lidhje me mëkatin e vet, janë thjesht përsëritje si prej papagalli. Thellë-thellë, ai ende beson se ka fituar ca pikë në librin e llogarive të Armikut duke u kthyer në besim dhe mendon se është i përrulur dhe i denjë për shkak se po shkon në kishë bashkë me këta fqinj 'hundëpërrpjetë' dhe të rëndomtë. Përrpiqu ta mbash sa më gjatë në këto mendime.

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Sa u kënaqa kur lexova përshkrimin që i ke bërë marrëdhënies së pacientit tënd me nënën e vet! Vetëm se duhet ta shfrytëzosh këtë avantazh. Armiku do të punojë duke u nisur nga qendra në drejtim të skajeve, duke e ndikuar gradualisht, gjithnjë e më tepër sjelljen e pacientit tënd për t'iu përshtatur standardit të ri dhe mund të arrijë, nga momenti në moment, edhe në qëndrimin e tij ndaj së ëmës. Duhet me çdo kusht të arrish ti i pari ta ndikosh. Qëndro në kontakt me kolegun tonë Jargavecën, i cili është përgjegjës për nënën, dhe krijoni në atë shtëpi një zakon reciprok bezdisjeje të rrënjosur mirë; gjilpëra që shpojnë çdo ditë. Metodatat e mëposhtme do të jenë të dobishme.

1. Mbaje mendjen e tij të fokusuar tek jeta e brendshme. Ai mendon se kthimi i tij në besim është diçka *e brendshme*, dhe, si rrjedhojë, në këtë çast e ka të drejtuar

vëmendjen kryesisht te gjendjet e tij mendore – ose, më saktë, tek ai version i cunguar i tyre ku ti duhet ta kufizosh. Vazhdo të nxitësh këtë gjë. Mbaje mendjen e tij larg detyrave më elementare dhe fokusojë plotësisht tek ato që ai i konsideron më të thella dhe më shpirtërore. Syno të punosh mbi më të vyerën karakteristikë njerëzore, neveritjen dhe mospërfilljen ndaj gjërave që duken qartë. Duhet ta shtysh në një gjendje të tillë ku ai mund të praktikojë shqyrtimin e vetvetes për orë të tëra, pa arritur të zbulojë asnjë prej atyre fakteve për veten që janë krejtësisht të qarta për këdo që ka jetuar në të njëjtën shtëpi me të, ose që ka punuar me të në të njëjtën zyrë.

2. Natyrisht që është e pamundur ta ndalosh të lutet për nënën e tij, por ne kemi mjete për t'i bërë lutjet të padëmshme. Sigurohu që ato të jenë sa më tepër 'shpirtërore', që ai të jetë gjithë kohën i merakosur për gjendjen e shpirtit të saj dhe asnjëherë për reumatizmen e saj. Kjo do të na sjellë dy përparësi. Së pari, vëmendja e tij do të kapet pas atyre që ai i konsideron si mëkate të saj. Dhe, me pak drejtim nga ana jote, ai mund të nxitet t'i shikojë si mëkate të saj edhe çdo veprim që i prish punë atij, ose që e acaroon atë. Kështu do të mund të vazhdos

t'ia ngacmosh edhe më tepër lëndimin e përditshëm, edhe ndërsa lutet i gjunjëzuar. Operacioni nuk është aspak i vështirë, madje është shumë zbavitës. Së dyti, ngaqë idetë e tij në lidhje me shpirtin e saj do të jenë shumë të ashpra dhe shpesh të gabuara, ai do të jetë duke u lutur, deri në njëfarë mase, për një person imagjinar; dhe detyra jote do të jetë që ky person imagjinar të bëhet çdo ditë e më pak i ngjashëm me nënën e vërtetë – atë zonjë të vjetër që në tryezë ka një gjuhë kaq therëse. Me kalimin e kohës do të mund ta zgjerosh aq shumë këtë të çarë, sa asnjë mendim, apo ndjenjë nga lutjet e tij për nënën imagjinare nuk do shfaqet te mënyra si ai e trajton nënën e tij të vërtetë. Kam pasur pacientë të mitë, të cilët i kisha aq mirë në kontroll, saqë kishte nga ata që pasi ishin lutur plot pasion për 'shpirtin' e gruas ose djalit të tyre, i rrihnin, ose i fyenin ata pa asnjë brejtje ndërgjegjeje.

3. Kur dy qenie njerëzore jetojnë së bashku për shumë vite, ndodh rëndom që secili ka tone të zërit, ose shprehje të fytyrës që mund të bëhen jashtëzakonisht acaruese për tjetrin. Puno mbi këtë pikë. Sill në vetëdijen e pacientit zakonin e ngritjes së vetullës që ka nëna e tij, zakon që ai filloi ta urrente që kur ishte fëmijë dhe lëre të mendojë

se sa e padurueshme është bërë kjo gjë për të. Lëre të mendojë se ajo e bën enkas këtë gjë, përderisa e di se sa bezdisës është ky veprim për të – nëse e kryen mirë punën tënde, atij nuk do t'i bjerë ndër mend se nuk ka gjasa që kjo të jetë e vërtetë. Nga ana tjetër mos e lejo kurrë të dyshojë se edhe ai mund të ketë tone të zërit dhe shprehje të fytyrës të cilat e acarojnë nënën e vet. Kjo arrihet me lehtësi, për aq kohë sa ai as e shikon, dhe as e dëgjon vetveten.

4. Në botën e qytetëruar, urrejtja brenda familjes zakonisht ndodh kur thuhet gjëra të cilat do të dukeshin më se të padëmshme në letër (*fjalët* nuk janë fyese). Çështja qëndron tek toni i zërit, apo momenti kur thuhet, aq sa ato nuk dallojnë aspak nga një grusht në fytyrë. Që kjo lojë të mbetet e hapur, ti dhe Jargaveci duhet të kujdeseni që të dy këta mendjeshkurtër të kenë një standard të dyfishtë. Pacienti yt duhet të pretendojë se të gjitha thëniet e tij duhet të merren në kuptimin e parë dhe të gjykohen vetëm në bazë të fjalëve të thëna. Ndërsa, nga ana tjetër, ai duhet t'i gjykojë fjalët e nënës e t'i interpretojë siç e mendon ai vetë, të jetë i ndjeshëm ndaj tonit të zërit, kontekstit dhe qëllimit të fshehtë që

mund të ketë pasur. Dhe ajo duhet të nxitet të bëjë të njëjtën gjë. Kështu, në përfundim të çdo grindjeje, secili do të largohet i bindur në vetvete, ose pothuajse i bindur, se është krejtësisht i pafajshëm. Ti e di se si ndodh: «Unë thjesht e pyes kur do të bëhet darka dhe ajo merr flakë menjëherë». Sapo të rrënjoset mirë ky zakon, krijohet ajo situatë e mrekullueshme ku njerëzit thonë gjëra me qëllimin e dukshëm për të fyer, por hidhërohen thellë kur të tjerët i ofendojnë.

Së fundmi, më trego diçka mbi pozitën fetare të plakës. A është ndopak xheloze për elementin e ri në jetën e të birit? A i ka ngelur hatri që ai i mësoi nga të tjerët, dhe me kaq vonesë, ato gjëra që ajo mendon se ia ka ofruar aq qartë që në fëmijëri? A i duket sikur ai ‘po e tepron’ si shumë me disa gjëra – apo sikur po i merr me shumë mendjelehtësi disa të tjera? Të kujtohet vëllai i madh në historinë që tregoi Armiku?

Khaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Sugjerimet prej fillestari të letrës sate të fundit më paralajmërojnë se tashmë është koha të të shkruaj në mënyrë të plotë mbi çështjen e dhimbshme të lutjes. Mund edhe ta kishe shmangur komentin se këshilla ime lidhur me lutjet e tij për nënën “rezultoi një dështim i pashoq”. Nuk është diçka që një nip duhet t’i shkruajë xhaxhait të tij – as një tundues i ri nënsekretarit të një departamenti. Ky është tregues i një dëshire të shëmtuar për të shmangur përgjegjësinë. Duhet të mësosh të paguash për gabimet e tua.

Gjëja më e mirë, nëse është e mundur, do të ishte ta mbaje pacientin krejtësisht larg çdo qëllimi serioz për t’u lutur. Kur pacienti është në moshë madhore, si njeriu yt, i sapokthyer në palën e Armikut, kjo arrihet më së miri duke e inkurajuar të kujtojë, ose të mendojë se po kujton, llojin e lutjeve si prej papagalli që bënte në fëmijëri. Për

t'iu kundërvënë kësaj, ai mund të nxitet drejt diçkaje plotësisht spontane, të brendshme, jozyrtare dhe pa rregull. Për një fillestar si ai, kjo do të ishte një përpjekje për të krijuar në vetvete një gjendje të vagullt shpirtërore në të cilën përqendrimi i vullnetit dhe intelektit nuk luajnë rol. Njëri nga poetët e tyre, Coleridge, ka shkruar se ai nuk lutej “duke lëvizur buzët dhe duke përkthyer gjunjët”, por thjesht përmes “shpirtit të cilin e linte të lirë të dashuronte” dhe duke shijuar ‘një ndjesi përgjërimi.’ Pikërisht këtë lloj lutjeje duam ne. Dhe, për shkak se kjo i ngjan së jashtmi asaj lutjes së heshtur që praktikojnë ata që kanë përparuar shumë në shërbimin ndaj Armikut, pacientët inteligjentë, por dembelë, gënjehen duke menduar se po bëjnë këtë për një kohë të gjatë. Të paktën, ata mund të binden se nuk ka rëndësi pozicioni trupor në lutjet e tyre; sepse vazhdimisht harrojnë diçka që ti nuk duhet ta harrosh kurrë, se ata janë kafshë dhe çdo gjë që bëjnë trupat e tyre ndikon tek shpirti i tyre. Është qesharake në fakt: të vdekshmit na imagjinojnë gjithnjë duke iu futur gjëra në mendje; në fakt, puna jonë më e mirë kryhet duke mbajtur gjëra jashtë saj.

Nëse kjo nuk arrihet, duhet të provosh një devijim

më të sofistikuar të qëllimit të tij. Sa herë që ata janë në praninë e vetë Armikut ne jemi të mundur, por ka mënyra për t'i penguar ata ta arrijnë këtë. Më e thjeshta është t'ua kthesh vështirimin nga Ai tek vetja e tyre. Mbajti ata të fokusuar vazhdimisht tek mendja e tyre duke u përpjekur të prodhojnë *ndjenja* përmes vënies në veprim të vullnetit të tyre. Kur do të duan t'i kërkojnë Atij dashuri, të përpiqen më mirë të prodhojnë *ndjenja* dashurie në vetvete pa e kuptuar se çfarë po bëjnë. Kur do të duan të luten për kurajë, bëj që në realitet të përpiqen të ndihen trima. Kur thonë se po luten për falje, bëj që të përpiqen të ndihen të falur. Mësoji ta matin vlerën e çdo lutjeje nga suksesi i tyre në krijimin e *ndjenjës* së dëshiruar. Dhe asnjëherë të mos dyshojnë se një sukses i këtij lloji mund të ndikohet nga faktorë të tjerë të çastit, nëse ata janë mirë, apo të sëmurë, energjikë, apo të lodhur.

Por, mos harro që Armiku nga ana tjetër nuk do të qëndrojë duarlidhur. Ku ka lutje, ka edhe rrezik për veprim të menjëhershëm prej Tij. Ai lë pas me indiferentizëm dinjitetin e pozitës së Tij, si edhe tonin, si shpirtra autentikë, dhe derdh mbi kafshët njerëzore njohurinë për Qenien e Tij në mënyrë të paturpshme.

Megjithatë, kur ai bën që të dështojë përpjekja jonë e parë për devijim, ne kemi një armë edhe më të sofistikuar. Njerëzit nuk nisen nga perceptimi i drejtpërdrejtë i pranisë së Tij, të cilin ne, për fat të keq, nuk mund ta shmangim. Ata nuk e kanë njohur kurrë atë vezullim të llahtarshëm, atë shikim përvëlues dhe therës që për jetën tonë është sfondi i dhimbjes së përhershme. Po të shohësh në mendjen e pacientit tënd teksa lutet, nuk do të gjesh diçka të tillë. Nëse e shqyrton objektin pranë të cilit është ai, do të kuptosh se ai është një objekt i krijuar, shumë nga përbërësit e të cilit janë mjaft qesharakë. Do të gjesh imazhe që burojnë nga piktura të Armikut siç shfaqej gjatë periudhës së ulët të njohur si periudha e Mishërimit: do të gjesh imazhe më të vagullta – mbase më të bastarduara dhe feminare – që lidhen me dy Personat e tjerë. Edhe një pjesë e frikës dhe nderimit të tij (bashkë me ndjesitë trupore që e shoqërojnë) do të konkretizohen tek objekti që nderohet dhe do t'i atribuohen atij. Kam njohur raste kur ajo që pacienti quante “Perëndia” i tij, në fakt kishte një *vendndodhje* – cepin lart, apo majtas të dhomës, ose brenda kokës së tij, ose në një kryq të varur në mur. Por cilado qoftë natyra dhe përbërja e objektit, duhet ta bësh t’i

lutet vetëm asaj gjëje – gjësë që ka krijuar ai, jo Personit që e ka krijuar atë vetë. Mund të arrish edhe ta inkurajosh që t'i kushtojë rëndësi të madhe korrigjimit dhe përmirësimit të objektit të tij të krijuar dhe ta imagjinojë vazhdimisht gjatë gjithë kohës së lutjes. Sepse, nëse arrin që ta bëjë dallimin në ndonjë moment, nëse me vetëdije i drejton lutjet e tij “Jo drejt asaj që unë mendoj se ti je, por drejt asaj që Ti vetë e di se je”, atëherë situata jonë bëhet, në atë çast, e pashpresë. Është i rrezikshëm momenti kur të gjitha mendimet dhe imazhet e tij zbohen tej, ose qëndrojnë, por me vetëdije të plotë si gjëra thjesht subjektive në natyrë. Kur njeriu ia beson veten asaj Pranie krejtësisht reale, të jashtme dhe të padukshme, e cila ndodhet në dhomë me të, edhe pa e njohur kurrë siç njihet prej Atij Personi – vërtet, atëherë mund të ndodhë ajo që nuk pritet. Për ta shmangur këtë situatë – këtë shfaqje lakuriqe të shpirtit në lutje – do të ndihmohesh nga fakti që vetë njerëzit nuk e dëshirojnë aq shumë sa mendojnë këtë Prani. E megjithatë, ata marrin gjithnjë më tepër nga sa kërkojnë.

Khaxhai yt i shtrenjtë,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Mbetesh paksa i zhgënjyer kur, ndërkohë që ke pritur një raport të detajuar për punën, në vend të tij, të vjen një rapsodi e vagullt siç ishte letra jote e fundit. Më thua se je “i dalldisur nga gëzimi” sepse europianët kanë nisur një tjetër luftë të tyren. E kam mjaft të qartë se çfarë të ka ndodhur. Nuk je i dalldisur; je vetëm i dehur. Duke e lexuar midis rreshtave rrëfimin tënd tepër të çekuilibruar në lidhje me natën e pagjumë të pacientit, mund të bëj një analizë të përpiktë të gjendjes së mendjes sate. Për herë të parë në karrierën tënde ke shijuar atë verë që është shpërblimi i gjithë mundit tonë – angështimi dhe pështjellimi i një shpirti njerëzor – dhe të ka rënë në kokë. E kam të vështirë të të fajësoj për këtë. Nuk pres që të kenë kokë plaku shpatullat e një të riu. A reagoi vallë pacienti yt ndaj disa prej imazheve të llahtarshme të së ardhmes? A punove për të sjellë ndonjë vështtrim

melankolik të së shkuarës së lumtur, plot mëshirë për veten? Ndonjë dridhje të fortë nga gropa e stomakut, a i ndjeve? A i luajte të gjitha fijet, apo e humbe toruan? Mirë, mirë, e natyrshme është e gjitha. Por mbaje mend mirë, Krimbaq, se detyra vjen përpara dëfrimit. Sikur, për shkak të një neglizhence, ta humbasësh përfundimisht prenë, do të digjesh përjetësisht nga etja për atë pije të cilës tani je duke i shijuar vetëm gllënjikën e parë. Por, nga ana tjetër, nëse punon me gjakftohtësi dhe qëndrueshmëri dhe arrin që tani t'ia sigurosh përfundimisht shpirtin, atëherë ai do të jetë i yti përjetë – një kupë e gjallë plot dëshpërim, tmerr dhe habi, të cilën mund ta vësh në buzë sa herë do të dëshirosh. Mos lejo, pra, që një ngazëllim i çastit të ta heqë mendjen nga detyrat e vërteta të shkatërrimit të besimit dhe të penguarit e formimit të virtyteve. Dërgomë, pa më zhgënjyer përsëri, një tablo të plotë të reagimeve të pacientit ndaj luftës në letrën tjetër, me qëllim që të shqyrtojmë nëse ia vlen ta shtyjme të bëhet patriot ekstremist apo pacifist i zjarhtë. Mundësitë janë nga më të ndryshmet. Ndërkohë, më duhet të të paralajmëroj që të mos presësh shumë nga një luftë.

Natyrisht, lufta është argëtuese. Frika dhe vuajtja e

papritur e njerëzve është një çlodhje e merituar dhe e këndshme për mijëra nga punëtorët tanë të lodhur. Por çfarë dobie mund të na sjellë në përjetësi nëse nuk e përdorim për t'i çuar shpirtra Atit tonë atje Poshtë? Kur shoh vuajtjen e përkohshme të njerëzve, të cilët në fund na shpëtojnë nga duart, ndihem sikur më kanë lejuar të shijoj pjatën e parë të një banketi të pasur, por pastaj më mohojnë pjesën tjetër. Më mirë të mos kisha shijuar asgjë, sesa kështu. Armiku, besnik ndaj metodave të Tij barbare të luftës, na lejon të shikojmë vuajtjen e shkurtër të të preferuarve të Tij, vetëm që të torturohemi dhe të vuajmë, për t'u tallur më pas me urinë e pashuar që, le ta pranojmë, po na imponohet nga bllokada e Tij në fazën aktuale të konfliktit të madh. Prandaj, të mendojmë më mirë se si ta përdorim këtë luftë europiane, jo si ta shijojmë. Sepse ajo ka disa prirje në vetvete, të cilat nuk janë aspak të favorshme për ne. Ne mund të shpresojmë se do të ketë një dozë të mirë mizorie dhe ndyrësie. Por, nëse nuk jemi të vëmendshëm, do të shohim se, nga ky mjerim, me mijëra do t'i drejtohen Armikut, teksa vëmendja e dhjetëra mijërave të tjerë, që nuk do të arrijnë aq lart, do të largohet gjithsesi nga vetja e tyre në drejtim

të vlerave dhe kauzave të cilat i konsiderojnë më të larta se uni i tyre. E di që Armiku nuk i miraton shumë prej këtyre kauzave. Por pikërisht këtu Ai tregohet kaq i pandershëm. Shpesh ai i çmon njerëzit që kanë dhënë jetën për kauza, edhe pse në sytë e Tij janë të gabuara, vetëm sepse Ai ka parë se ata i mendonin të drejta këto kauza dhe po vepronin në mënyrën më të mirë që ata njihnin. Përveç kësaj, mendo edhe se çfarë vdekjesh të padëshirueshme ndodhin në kohë lufte. Njerëzit janë të vetëdijshëm që mund të vriten dhe shkojnë të përgatitur për vdekjen, nëse i përkasin ndopak palës së Armikut. Sa mirë do të ishte për ne sikur të gjithë njerëzit të vdisnin nëpër klinika të shtrenjta, pranë mjekësh që gënjejnë, infermieresh që gënjejnë, miqsh që gënjejnë, siç i kemi edukuar ne, duke u premtuar jetë atyre që po vdesin, duke nxitur besimin se sëmundja justifikon çdo mëkat, madje edhe – nëse punëtorët tanë dinë ta bëjnë mirë punën – duke e shmangur çdo sugjerim për praninë e një prifti, që të mos i zbulohet të sëmurit gjendja e tij e vërtetë! Dhe sa shkatërrimtar është për ne zgjimi ndaj faktit të vdekjes, të cilin lufta e përforcon vazhdimisht. Një ndër armët tona më të forta, kënaqësia me këtë botë, në këtë

mënyrë bëhet e padobishme. Në kohë lufte, çdo qenie njerëzore e kupton se jeta mund të ndërpritet papritur, se nuk ka siguri në këtë jetë.

Po, e di se Pemëkalbësi e të tjerë kanë parë te luftërat një rast të shkëlqyer për sulme kundër besimit, por unë mendoj se ky këndvështrim është i ekzagjeruar. Ato qenie njerëzore që janë përkushtuar ndaj Armikut, kanë mësuar qartazi prej Tij se vuajtja është pjesë thelbësore e asaj që Ai quan Shpengim; prandaj besimi që shkatërrohet nga lufta, ose murtaja ndoshta nuk duhet ta kishim marrë mundimin për ta shkatërruar. Këtu e kam fjalën për vuajtjen e zgjatur në një periudhë kohore që sjell lufta. Sigurisht, në momentin preciz të tmerrit, vajtimit ose dhimbjes fizike, mund ta kapësh njeriun tënd me arsyen përkohësisht jashtë përdorimit. Por edhe atëherë, nëse ai i drejtohet për ndihmë shtabit të Armikut, kam kuptuar që posti i tij ushtarak është pothuaj gjithmonë gati për t'u shtrirë dorën e për t'u ofruar ndihmë.

Khaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

M'u bë qejfi shumë kur mora vesh se për shkak të moshës dhe profesionit, pacientit tënd me siguri do t'i vijë thirrja për të kryer shërbimin ushtarak. Ne duam që ai të jetë në pasiguri maksimale, që mendja e tij të jetë e mbushur me pamje paradoksale të së ardhmes, ku secila prej tyre t'i shkaktojë shpresë, ose frikë. Nuk ka asgjë më të mirë se pasiguria dhe ankthi për ta mbajtur mendjen e njeriut larg Armikut. Ai do që njerëzit të merren me atë që po bëjnë në të tashmen; detyra jonë është t'i bëjmë të mendojnë vazhdimisht e të shqetësohen për atë që do t'u ndodhë në të ardhmen.

Pacienti yt sigurisht që e ka kapur sadopak idenë se duhet t'i nënshtrohet me durim vullnetit të Armikut. Ajo që Armiku ka si qëllim përmes kësaj është mbi të gjitha që njeriu të pranojë me durim vuajtjen që i ka rënë vërtet për pjesë – ankthi dhe pasiguria e çastit. Pikërisht për *këto*,

nëse ai thotë: “U bëftë vullneti Yt” dhe pranon detyrën e përditshme duke duruar të gjitha këto, do t’i sigurohet buka e përditshme. Ti ke për detyrë të sigurohesh që pacienti të mos e shohë kurrë situatën e tanishme si kryqi që i është caktuar të mbajë, por të përqendrohet vetëm tek gjërat nga të cilat ai ka frikë. Le t’i konsiderojë ato si kryqet e tij: le të harrojë se, ngaqë janë të papajtueshme me njëra-tjetrën, nuk është e mundur që ato të ndodhin të gjitha dhe le ta kalojë kohën duke u përpjekur të bëjë qëndresë me durim ndaj tyre. Sepse një dorëzim i vërtetë, në të njëjtën kohë, ndaj dhjetëra rreziqesh të ndryshme hipotetike, është pothuajse i pamundur dhe Armiku nuk i ndihmon shumë ata që përpiqen ta arrijnë këtë: dorëzimi ndaj vuajtjes së tashme dhe reale, edhe atje ku vuajtja shkaktohet vetëm nga frika, është më i lehtë dhe zakonisht ndihmohet nga ky veprim i drejtpërdrejtë.

Këtu hyn në lojë një ligj i rëndësishëm shpirtëror. Të kam shpjeguar se mund t’i dobësosh lutjet e tij duke ia larguar vëmendjen nga Vetë Armiku dhe duke i përqendruar te gjendjet e mendimeve të tij rreth Armikut. Nga ana tjetër, frika bëhet më e lehtë për t’u zotëruar nga ne nëse mendja e pacientit largohet nga gjëja e frikshme

dhe përqendrohet te vetë frika, që konsiderohet si një gjendje momentale dhe e padëshirueshme e mendjes së tij; dhe kur ta konsiderojë frikën si kryqin që duhet të mbajë, në mënyrë të pashmangshme, do ta mendojë si një gjendje të mendjes së tij. Kështu mund të formulohet një rregull i përgjithshëm; në të gjitha lëvizjet e mendimeve që favorizojnë kauzën tonë, puno që pacienti të mos jetë i vetëdijshëm për veten, por të përqendrohet tek objekti, kurse në të gjitha mendimet që favorizojnë Armikun, ktheja përqendrimin tek vetvetja. Bëj që një fyerje, apo trupi i një vajze t'ia tërheqë vëmendjen kaq shumë, sa që të mos ketë mundësi të mendojë: “Tani po hyj në atë zonë që quhet Zemërim – apo në zonën që quhet Epsh”. Përkundrazi, bëj që reflektimi si: “Ndjenjat e mia po bëhen më të devotshme, ose më të hirshme” t'ia tërheqin kaq shumë vëmendjen, sa të mos ketë mundësi të shohë përtej vetvetes, as për të parë Armikun tonë, as për të parë të afërmin e tij.

Përsa i përket qëndrimit të tij për luftën në përgjithësi, mos u mbështet tepër tek ato ndjenja urrejtjeje për të cilat njerëzit diskutojnë me aq zjarr në gazeta të krishtera, ose jo të krishtera. Në ankthin e tij, pacienti mund të

nxitet të hakmerret kundër udhëheqësve gjermanë, dhe kjo është gjë e mirë, për aq sa mund të realizohet. Por, zakonisht kjo ndjenjë është një urrejtje melodramatike ose e mitizuar kundrejt deshësh kurbanit imagjinarë. Ai nuk i ka takuar kurrë në jetë këta njerëz – ata janë thjesht imazhe të cilat marrin formë në bazë të asaj që shkruajnë gazetatat. Rezultatet e kësaj urrejtjeje imagjinare shpesh janë tepër zhgënjyese dhe, midis gjithë njerëzve të tjerë, anglezët janë ca qullashë të gjorë . Ata janë nga ai lloj i mjerë krijesash që shpallin me zë të lartë se as tortura nuk mjafton për armikun, dhe më pas i japin çaj dhe cigare të parit pilot gjerman të plagosur që u paraqitet në shtëpi fshehurazi.

Përpiqu sa të duash, në shpirtin e pacientit do të ketë gjithmonë një lloj mirësie që përballet me ligësinë. Më e mira do të ishte ta drejtoje ligësinë kundrejt fqinjëve më të afërt, ndërsa mirësinë ta shtyje në qarqet e largëta, ndaj njerëzve të cilët ai nuk i njeh. Në këtë mënyrë, ligësia bëhet krejtësisht reale, ndërsa mirësia, sa vjen e më imagjinare. Nuk ka asnjë vlerë t'i ndezësh urrejtjen kundër gjermanëve nëse, nga ana tjetër, zakoni i dëmshëm i dashurisë rritet mes tij dhe nënës, punëdhënësit, apo

bashkudhëtarit të tij në tren. Shikoje pacientin si një sërë rrathësh bashkëqendrorë, ku rrethi më i vogël është vullneti i tij, pas tij vjen intelekti, dhe në fund fantazia. Është e kotë të shpresosh të përjashtosh menjëherë nga të gjithë rrathët çdo gjë që mban erën e Armikut. Megjithatë, vazhdo t'i shtysh të gjitha virtytet jashtë derisa të ndodhen përfundimisht në rrethin e fantazisë dhe të gjitha cilësitë e dëshirueshme t'i tërheqësh brenda Vullnetit. Virtytet bëhen vërtet fatale për ne vetëm kur arrijnë të prekin vullnetin dhe trupëzohen në formën e zakoneve. (Sigurisht që nuk po flas për atë që pacienti e quan vullnet, i cili është thjesht turfullim dhe brejtje ndërgjegjeje për të vënë në zbatim vendimet me dhëmbët shtrënguar, por e kam fjalën për qendrën e vërtetë, atë që Armiku e quan Zemër.) Të gjitha llojet e virtyteve që marrin formë në fantazi, ose që miratohen nga intelekti, ose madje që, në njëfarë mase, adhurohen dhe admirohen, nuk e mbajnë njeriun larg nga shtëpia e Atit tonë: përkundrazi, ato mund ta bëjnë më dëfryes kur të mbërrijë aty.

Khaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Habitem që më pyet nëse duhet patjetër ta mbash pacientin në mungesë të plotë dijenie për ekzistencën tënde. Kjo pyetje, të paktën në fazën e tanishme të betejës, e ka marrë përgjigjen nga Komanda jonë e Lartë. Politika jonë për momentin është që ta fshehim veten. Natyrisht, nuk ka qenë gjithmonë kështu. Në fakt, ne përballemi me një dilemë mizore. Kur njerëzit nuk e besojnë ekzistencën tonë, ne humbasin të gjitha kënaqësitë që sjell terrorizimi i drejtpërdrejtë dhe nuk mund të krijojmë magjistarë. Nga ana tjetër, kur ata besojnë tek ne, nuk mund t'i bëjmë dot materialistë apo skeptikë. Të paktën, jo për momentin. Kam shpresa të mëdha se, do vijë dita kur do ta gjejmë mënyrën për ta kthyer shkencën e tyre në emocion dhe mit, aq sa, në fund, ajo që quhet besim nga ne (ndonëse jo me këtë emër) të struket tinëz në mendjen njerëzore, ndërkohë që vazhdon t'i besojë Armikut. 'Forca Jetësore',

adhurimi i seksit, dhe disa aspekte të psikanalizës mund të rezultojnë të dobishme për këtë. Nëse ia dalim të krijojmë kryeveprën tonë – Magjistarin Materialist, njeriun që jo vetëm përdor, por në fakt adhuron ato që i quan në mënyrë të vagullt ‘forca’, duke mohuar ekzistencën e “shpirtrave” – atëherë fundi i luftës do të jetë pranë. Por, ndërkohë duhet t’u bindemi urdhrave. Nuk besoj se do e kesh vështirë ta mbash pacientin në errësirë. Fakti që ‘djajtë’ janë kryesisht figura *komike* në imagjinatën e njeriut modern, do të të ndihmojë. Nëse një dyshim i vogël nis t’i krijohet në mendje për ekzistencën tënde, silli në mendje imazhin e dikujt të veshur me streçe të kuqe dhe binde se, meqë nuk mund të besojë te diçka e tillë (është një metodë e vjetër elementare për t’i ngatërruar ata), atëherë nuk mund të besojë as tek ti.

Nuk e kam harruar premtimin që të kam dhënë se do të shqyrtoja nëse duhet ta bëjmë pacientin patriot ekstrem apo pacifist ekstrem. Të gjitha ekstremet, me përjashtim të përkushtimit ekstrem ndaj Armikut, janë për t’u inkurajuar. Sigurisht, jo gjithmonë, por të paktën në këtë periudhë. Disa epoka janë të vakëta dhe të plogështa dhe është detyra jonë t’i përkundim për t’i

mbajtur në gjumë të thellë. Epoka të tjera, si kjo e tanishmja, janë të çekuilibruara e plot përçarje dhe detyra jonë është të ndezim sa më tepër grindje. Çdo klan i vogël, i bashkuar nga një interes, të cilin disa të tjerë e urrejnë ose e injorojnë, priret të zhvillojë një efekt serrë, duke pasur admirim reciprok brenda grupit, ndërsa jashtë tij urrejtje dhe krenari të madhe. Këto ndjenja mbrohen paturpësisht, për shkak se ‘Kauza’ është garancia e tyre e cila paraqitet si jopersonale. Kjo mbetet e vërtetë, madje edhe në rastet kur grupi i vogël ekziston fillimisht për qëllimet e vetë Armikut. Ne duam që Kisha të jetë e vogël, jo vetëm sepse duam që sa më pak njerëz ta njohin Armikun, por edhe që ata që e njohin, të karakterizohen nga tensioni i qëndrueshëm dhe nga mbrojtja me vetëdrejtësi e tipareve të një shoqërie sekrete, apo rrethi të fshehtë njerëzish. Sigurisht që Kisha vetë mbrohet fuqishëm dhe nuk ia kemi dalë ende t’i japim *të gjitha* tiparet e një klani; por grupime të vogla brenda saj shpesh kanë dhënë rezultate të admirueshme, që nga ndasitë e Palit dhe Apolit në Korint e deri te rrymat e ndryshme të Kishës anglikane.

Nëse pacienti nxitet të jetë pacifist i palëkundur, do

të bëhet vetvetiu pjesë e një shoqërie të vogël, që ngre zërin, e organizuar dhe e urryer nga të tjerët dhe pasojat do të jenë mëse të kënaqshme, veçanërisht për dikë të sapokthyer në krishtërim. Jam thuajse i bindur për këtë. Po them *thuajse* i bindur. A ka pasur ai më parë dyshime serioze për ligjshmërinë e të shërbyerit në një luftë të drejtë përpara se të fillonte kjo e tanishmja? A është njeri me kurajë të madhe fizike – aq të madhe sa të mos ketë asnjë gjysmë brejtje ndërgjegjeje për motivet e vërteta të pacifizmit të tij? A mund të ndihet ai, kur ballafaqohet me ndershmërinë dhe e ndien veten më pranë saj se kurrë, (asnjë njeri nuk është *kurrë* shumë afër), plotësisht i sigurt se po shtyhet vetëm nga dëshira për t’iu bindur Armikut? Nëse është ky lloj njeriu, ka gjasa që pacifizmi i tij nuk do të na sjellë shumë fitim dhe Armiku me siguri do ta mbrojë nga pasojat e zakonshme të të qenit pjesë e një sektit. Plani yt më i mirë, në këtë rast, do të ishte të përpiqeshe të krijoje një krizë të papritur, pështjelluese dhe emocionale prej së cilës të dalë si ithtar i shqetësuar për patriotizmin. Gjëra të tilla janë të realizueshme zakonisht. Por, nëse është ai lloj njeriu që mendoj unë, provo Pacifizmin.

Cilëndo rrugë të ndjekë, detyra jote kryesore do të

jetë e njëjtë. Le të fillojë duke e trajtuar patriotizmin ose pacifizmin si pjesë të fesë së tij. Pastaj, i ndikuar nga shpirti partizan, le ta konsiderojë atë si pjesën më të rëndësishme. Më pas, ushqeje në heshtje dhe vazhdo hap pas hapi në këtë drejtim derisa të arrijë fazën ku feja bëhet thjesht një pjesë e ‘kauzës’, në të cilën krishtërimi vlerësohet më tepër për shkak të argumenteve të shkëlqyera që mund të nxirren prej tij për të justifikuar përpjekjet britanike qoftë për luftë, qoftë për pacifizëm. Qëndrimi të cilit duhet t’i ruhesht është ai ku çështjet e përkohshme trajtohen kryesisht si material për bindje. Kur të arrish ta kthesh Botën në qëllim dhe besimin në mjet, pothuajse e ke fituar pacientin tënd dhe ka pak rëndësi se çfarë qëllimi të botës po ndjek ai. Në çastin kur mitingjet, pamfletet, politikat, protestat, kauzat dhe kryqëzatat janë më të rëndësishme për të sesa lutjet, urdhërimet dhe dashuria, ai është i yti – dhe sa më ‘fetar’ të jetë (sipas këtij përcaktimi), aq më i sigurt mund të jesh për këtë. Unë mund të të tregoj një kafaz të mbushur deng me llojin e tyre këtu poshtë.

Khaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Pra, ti po “shpreson fort se po i vjen fundi fazës fetare të pacientit tënd”, apo jo? E kam menduar gjithmonë që Shkolla e Trajnimit mori fund që kur vunë në krye Gojëlëmshin, por tani jam plotësisht i sigurt për këtë. Nuk të ka treguar ndokush për ligjin e Valëzimit?

Njerëzit janë amfibë, gjysmë shpirt e gjysmë kafshë. (Vendosmëria e Armikut për të prodhuar një hibrid kaq të neveritshëm ishte një nga gjërat që e detyruan Atin Tonë të mos e mbështeste më.) Si shpirtra, ata i përkasin botës së përjetshme, por si kafshë ata jetojnë në kohë. Kjo do të thotë se ndërkohë që e drejtojnë shpirtin te një objekt i përjetshëm, trupat, pasionet dhe imagjinata e tyre janë në ndryshim të vazhdueshëm, sepse të jesh në kohë, do të thotë të ndryshosh. Ajo që i afron më tepër me qëndrueshmërinë mbetet valëzimi – një rikthim i vazhdueshëm te një nivel në të cilin bien vazhdimisht,

një seri kulmesh dhe gropash. Po ta kesh shqyrtuar me kujdes pacientin tënd, do ta kesh vënë re këtë valëzim në çdo aspekt të jetës së tij – në interesin e tij për punën, qëndrimin me miqtë e vet, orekset e tij fizike; të gjitha shkojnë herë poshtë e herë lart. Sa të jetë gjallë mbi tokë, periudhat e bollëkut dhe gjallërisë emocionale dhe trupore do të alternohen me periudha plogështie dhe varfërie. Thatësia dhe ndjenja e kotësisë që ai po përjeton nuk janë pasojë, siç ta ka qejfi ta mendosh, e aftësive të tua; ato janë thjesht një fenomen i natyrshëm, i cili nuk do na vlejë aspak nëse nuk e përdorim si duhet.

Për të vendosur se si ta shfrytëzojmë maksimalisht situatën, duhet të bësh pyetjen se çfarë synimi ka Armiku, e pastaj të përpiqesh të nxitësh të kundërtën. Për ty mund të jetë e habitshme, por Ai, në përpjekjet e Tij për ta fituar përjetësisht një shpirt njerëzor, përdor më tepër situatat në gropat sesa te kulmet. Disa prej të preferuarve të tij nga më të veçantët kanë kaluar nëpër gropa më të thella dhe më të mëdha se kushdo tjetër. Arsyeja pse ndodh kështu është sepse për ne, një njeri është para së gjithash ushqim; qëllimi ynë është që vullneti i tij të përthithet prej tonit, që uni ynë të zmadhohet në kurriz të të tijit.

Por bindja që Armiku kërkon prej njerëzve është diçka krejt ndryshe. Duhet ta pranojmë faktin se gjithçka që thotë në lidhje me dashurinë e Tij për njerëzit dhe me lirinë e përkryer që sjell shërbimi ndaj Tij, nuk është (ashtu siç do të donim me gjithë qejf ta besonim), thjesht propagandë, por një e vërtetë e llahtarshme. Ai do *vërtet* që ta mbushë universin me sa më shumë kopje të vogla të neveritshme të Vetvetes – me krijesa që jetojnë, në një shkallë më të ulët, cilësisht si Ai, jo për shkak se i ka thithur te Vetja e vet por sepse vullneti i tyre përputhet lirisht me të Tijin. Ne duam gjedhë që të na shërbejnë në fund si ushqim; Ai do shërbëtorë që në fund bëhen bij. Ne duam të thithim, Ai do që të japë. Ne jemi bosh dhe duam të mbushemi; Ai është plot dhe rrjedh për të tjerët. Qëllimi i luftës sonë është një botë në të cilën Ati ynë atje Poshtë t'i përthithë të gjitha qeniet e tjera te vetvetja; Armiku do një botë plot me qenie të bashkuara me Të, por në të njëjtën kohë të dallueshme.

Dhe këtu hyjnë në punë gropat. Besoj se mund ta kesh pyetur shpesh veten pse vallë Armiku nuk e përdor më tepër fuqinë e Tij për t'u shfaqur para njerëzve në masën dhe në momentin që Ai do, siç është e logjikshme. Por, siç

mund ta kesh vënë re, në skemën e Tij, e Parezistueshmja dhe e Padiskutueshmja janë pikërisht dy armët që Ai nuk ia lejon vetes t'i përdorë. Hedhja poshtë e vullnetit të njeriut (që do të ishte me siguri pasoja e shfaqjes së Tij, qoftë edhe në masën më të vogël dhe më të lehtë), do të ishte për Të diçka e padobishme. Ai nuk mund të dhunojë. Ai mund të përpiqet vetëm të fitojë vullnetin e njeriut. Kjo ndodh për shkak të idesë së tij të turpshme për të pasur edhe mish edhe peshk; që krijesat të jenë një me të, por ende vetvetja. Për Të nuk ka dobi thjesht ta neglizhojë vullnetin e tyre, apo ta anulojë atë. Ai është i gatshëm të bëjë pak ndërhyrje në fillim. Ai fillon me shfaqje të pranishë së Tij të cilat, ndonëse të zbehta, duken madhështore për ta, me ëmbëlsi emocionale dhe fitore të lehta mbi tundimin. Por Ai, në asnjë rast nuk e lejon këtë fazë të zgjasë shumë. Herët a vonë Ai tërheq, edhe pse jo realisht, së paku kështu u duket atyre, gjithë mbështetjet dhe stimujt e Tij. Ai e lë krijesën të ecë me këmbët e veta – t'i kryejë vetëm përmes vullnetit detyrat për të cilat e ka humbur entuziazmin. Më shumë sesa gjatë kulmeve, gjatë periudhave të gropave të tilla, ata bëhen ajo lloj krijese që Ai dëshiron të jenë. Pra, lutjet

e ofruara në një gjendje thatësie janë ato që e kënaqin Atë më tepër. Ne i zvarritim pacientët me tundime të vazhdueshme sepse qëllimi ynë është vetëm t'i kemi si ushqim për në tryezë; dhe sa më tepër të ndërhyjmë në vullnetin e tyre, aq më mirë për ne. Por Ai nuk mund t'i "tundojë" për virtyte siç tundojmë ne për vese. Ai do që ata të mësojnë të ecin përpara, prandaj duhet ta tërheqë dorën e Tij; dhe vetëm nëse ata kanë vullnetin për të ecur, Ai është i kënaqur, edhe sikur të pengohen duke ecur. Mos u gënje, Krimbaq. Nuk ka rrezik më të madh për çështjen tonë sesa një njeri, i cili edhe pse nuk ka më dëshirë, ende ecën me qëllimin për të kryer vullnetin e Armikut; një njeri që shikon rreth e qark një univers prej të cilit çdo gjurmë e Tij duket se është zhdukur, që pyet pse është braktisur dhe përsëri vazhdon të bindet.

Por, sigurisht, gropat paraqesin mundësi edhe për krahun tonë. Javës tjetër do të të jap disa këshilla për mënyrën se si duhen shfrytëzuar

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Shpresoj se letra ime e fundit të ka bindur që gropa e plogështisë ose “thatësirës” që po kalon pacienti yt nuk do të ta japë, në pjetë të argjenditë shpirtin e tij; kjo periudhë duhet shfrytëzuar në mënyrën e duhur. Çfarë formash duhet të marrë ky shfrytëzim, po ta trajtoj më poshtë.

Në radhë të parë, unë gjithnjë kam vënë re se periudhat e gropave të valëzimit njerëzor paraqesin mundësi të shkëlqyer për të gjitha tundimet sensuale, veçanërisht ato të seksit. Mund të habitesh për këtë, pasi dihet se te kulmi ka më shumë energji fizike dhe, rrjedhimisht, edhe më shumë oreks të mundshëm; por duhet të kesh parasysh se gjatë kësaj kohe edhe fuqitë për të rezistuar janë gjithashtu në pikën më të lartë. Shëndeti dhe humori që dëshiron të përdorësh për të krijuar epsh tek ai, për fat të keq, mund të përdoren lehtësisht edhe për punë,

lojë, mendim, ose kënaqësi të pafajshme. Sulmi ka më tepër mundësi të ketë sukses atëherë kur e gjithë bota e brendshme e njeriut është e zbehtë, e ftohtë dhe boshe. Dhe duhet pasur parasysh gjithashtu, se gjatë gropave, seksualiteti ndryshon në mënyrë të fshehtë në cilësi nga ai i periudhës së kulmeve – ka më pak gjasa që të ndodhë fenomeni i dobësisë njerëzore që ata e quajnë “të rënit në dashuri”. Por mund të priret më lehtë drejt shthurjes sepse në këtë mënyrë është më pak i prekshëm nga ato ndodhi shoqëruese bujarie dhe krijueshmërie e madje shpirtërore, që shpesh e bëjnë seksualitetin njerëzor aq zhgënjyes. E njëjta gjë ndodh edhe me dëshirat e tjera të mishit. Ti ke më tepër mundësi ta bësh njeriun tënd alkoolik duke e shtyrë ta përdorë pijen si qetësues kur ndihet i lodhur dhe i plogësht, sesa ta inkurajosh që ta përdorë si mjet gëzimi mes miqsh kur ndihet i lumtur dhe euforik. Mos e harro kurrë se, kur merremi me ndonjë kënaqësi në gjendjen e saj normale, të shëndetshme dhe plotësuese, jemi, në njëfarë mënyre, në territorin e Armikut. E di që kemi fituar shumë shpirta përmes kënaqësisë. Megjithatë, kënaqësia është shpikja e Tij, jo e jona. Ai i krijoi kënaqësitë: me gjithë punën tonë

kërkimore nuk ia kemi dalë deri tani të krijojmë as edhe një. Çfarë mund të bëjmë, është t'i inkurajojmë njerëzit që kënaqësitë që Armiku ka prodhuar, t'i realizojnë në çastet, në mënyrat dhe në masën e ndaluar prej Tij. Prandaj përpiqemi gjithmonë të punojmë duke i larguar nga kënaqësitë në mjedisin e tyre natyror e duke i drejtuar në drejtim të asaj që është më pak e natyrshme, më pak e ngjashme me Krijuesin dhe më pak e kënaqshme. Suksesi qëndron tek formula: një etje gjithnjë në rritje për një kënaqësi gjithnjë e më të vogël. Kjo sjell siguri më të madhe; dhe është më me stil. Të fitosh një shpirt njerëzor dhe të mos i japësh *asgjë* në këmbim – kjo është ajo që ia gëzon vërtet zemrën Atit tonë. Dhe gropat janë koha kur duhet filluar ky proces.

Por, ka një mënyrë edhe më të mirë për t'i shfrytëzuar gropat; është përmes mendimeve që ka vetë pacienti për to. Si gjithmonë, hapi i parë është ta mbash njohurinë larg mendjes së tij. Mos e lër të dyshojë për ligjin e valëzimit. Lëre të mendojë se zelli i parë i kthimit në besim pritej të vazhdonte, dhe duhet të vazhdonte përjetë dhe se thatësira e tij e tanishme është një gjendje po aq e përhershme. Në momentin kur do t'ia fiksosh mirë këtë keqkuptim në

kokë, do të jesh i lirë të vazhdosh punën në mënyra të ndryshme. Gjithçka ndryshon në varësi të tipit të njeriut: nëse njeriu yt është tip depresiv, mund ta tundosh të dëshpërohet, nëse është tip që jeton në një botë iluzionesh, mund ta sigurosh se gjithçka po i shkon mirë. Tipi i parë po bëhet më i rrallë për t'u hasur mes njerëzve. Nëse ndodh që pacienti yt t'i përkasë këtij tipi, atëherë gjithçka bëhet e lehtë. Do të të duhet vetëm ta mbash larg të krishterëve me përvojë (në ditët e sotme, kjo është një detyrë fare e lehtë), t'ia drejtosh vëmendjen te vargjet e duhura në shkrime, pastaj ta shtysh të punojë me synimin e pashpresë për t'i rikthyer ndjenjat e mëparshme vetëm nëpërmjet forcës së vullnetit dhe e ke të fituar lojën. Nëse ai është tip më optimist, detyra jote është ta bësh t'i nënshtrohet temperaturës së ulët momentale të shpirtit, gradualisht të mësohet me të dhe të bindë veten se kjo, në fund të fundit, nuk është edhe aq e keqe. Pas një ose dy javësh, do ta bësh të dyshojë se ditët e para të kthimit të tij në krishtërim kanë qenë, ndoshta, paksa të ekzagjeruara. Foli atij dhe binde se “çdo gjë ka një masë”. Nëse do të arrish ta çosh në pikën ku do të mendojë se “feja është diçka shumë e mirë, deri në një pikë të caktuar”, atëherë

mund të fillosh të bësh festë për gjendjen e shpirtit të tij. Feja e cunguar është po aq e mirë për ne sa edhe mungesa e fesë – madje, edhe më argëtuese.

Një tjetër mundësi është sulmi i drejtpërdrejtë kundër besimit të tij. Pasi ta bësh të mendojë se periudha e gropës është e përhershme, a nuk mund ta bindësh se “fazës së tij fetare” do i vijë fundi njësoj si të gjitha fazave të tij të mëparshme? Sigurisht, nuk ka asnjë rrugë logjike për të kaluar nga pohimi “Po më humbet interesi për këtë gjë” te pohimi tjetër “Kjo gjë është e rreme”. Por, siç ta kam thënë më parë, duhet të mbështetesh te përdorimi i fjalëve të kota, jo tek arsyeja. Vetëm përdorimi i fjalës *fazë* me shumë mundësi do të jetë dobiprurës. Besoj se ajo krijesë ka kaluar shumë faza më parë – të gjitha kalojnë – dhe gjithmonë është ndierë superior, madje ka përbuzje ndaj tyre, jo se i ka kritikuar vërtet, por thjesht ngaqë janë pjesë e të shkuarës. (Shpresoj se po e mban të ushqyer mirë me idetë e vagullta të Zhvillimit, Progresit dhe të Këndvështrimit Historik të gjërave, dhe po i jep të lexojë shumë Biografi moderne, apo jo? Personazhet e tyre janë duke ia dalë mbanë gjithmonë nëpër të gjitha fazat që po kalojnë, apo jo?)

E kupton tani idenë? Mbaja mendjen larg nga antiteza e njohur midis të Vërtetës dhe Gënjeshtërs, përdori shpesh shprehjet e papërcaktuara – “Ishte thjesht një fazë” – “E kam kaluar një herë këtë” – dhe mos harro fjalën e bekuar “Adoleshent”.

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

U gëzova shumë kur dëgjova nga Stërkëmbëshi se pacienti yt ka pasur disa njohje të reja shumë të mira dhe se ti e ke përdorur këtë ngjarje në një mënyrë vërtet premtuese. Kam dëgjuar se çifti i martuar i moshës së mesme, që i shkoi në zyrë, janë pikërisht ai lloj njerëzish që duam të njohë ai – të pasur, të zgjuar, në dukje intelektualë dhe skeptikë të mprehtë ndaj gjithçkaje në botë. Dëgjova madje se janë disi pacifistë, jo për arsye morale, por nga zakoni i rrënjosur që kanë për të përçmuar çdo gjë që lidhet me masën e gjerë të njerëzve, dhe nga një prirje drejt komunizmit krejtësisht letrar për shkak se është në modë. Shkëlqyeshëm! Dhe duket se ti po e përdor mirë krenarinë e tij të kotë sociale, seksuale dhe intelektuale. Më trego më tepër. A ishte shumë i përkushtuar? Nuk po flas vetëm për çfarë shprehu me gojë. Ka një lojë të fshehur vështtrimesh,

tonesh zëri dhe të qeshurash, nëpërmjet të cilave njeriu vdekatar mund të nënkuptojë se është pjesë e së njëjtës partie me ata që po flet. Këtë lloj tradhtie duhet ta inkurajosh në mënyrë të veçantë sepse njeriu vetë e ka të vështirë ta kuptojë plotësisht se ç'po bën; dhe në momentin kur e kupton, ti do t'ia kesh bërë të vështirë kthimin pas.

Pa dyshim që ai shumë shpejt do ta kuptojë se besimi i vet është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me idetë që përmenden në të gjitha bisedat që ka me miqtë e tij të rinj. Nuk mendoj se kjo do të ketë shumë rëndësi, me kusht që ti t'ia mbushësh mendjen të vonojë çdo pranim haptazi të besimit të tij, çka do ta kesh të lehtë ta bësh me anë të turpit, krenarisë, modestisë dhe mendjelehtësisë. Për aq sa do të zgjasë kjo vonesë, ai do të ndodhet në një pozicion ku do i duhet të gënjejë. Do të heshtë kur duhet të flasë dhe do të qeshë kur duhet të heshtë. Do të fillojë të përvetësojë, në fillim vetëm nëpërmjet sjelljes, por pastaj dhe nëpërmjet fjalëve, gjithfarëlloj qëndrimesh cinike dhe skeptike të cilat, në fakt, nuk janë të tijat. Por, nëse ti vepron si duhet, ato do të bëhen të tijat. Të gjithë të vdekshmit priren të bëhen si ata që pretendojnë se

janë. Kjo është diçka elementare. Pyetja e vërtetë është si të përgatitesh për kundërsulmet e Armikut.

Gjëja kryesore është ta shtysh sa më shumë që të jetë e mundur çastin kur ai ta kuptojë se kjo kënaqësi e re është një tundim. Shtyrja në kohë mund të duket e vështirë përderisa shërbëtorët e Armikut kanë predikuar për dy mijë vjet se ‘Bota’ është një nga tundimet e mëdha, por në dekadat e fundit, fatmirësisht, ata kanë folur shumë pak për këtë temë. Në shkrimet e sotme të krishtera, ndonëse shoh të flitet shumë (në fakt, më tepër se ç’më pëlqen) për Mamonin, rrallë shoh të përmenden paralajmërimet e vjetra mbi Kotësitë e Botës, mbi Përzgjedhjen e Miqve dhe mbi Vlerën e Kohës. Këto të gjitha, pacienti yt ndoshta i klasifikon si ‘Puritanizëm’ – dhe nuk e di a mund ta theksoj mjaftueshëm se vlera që ne i kemi dhënë kësaj fjale është një nga triumfet më të mëdha tonat në njëqind vitet e fundit? Nëpërmjet saj ne shpëtojmë mijëra njerëz çdo vit nga zakonet e këqija të vetëkontrollit, dëlirësisë dhe vigjilencës së jetës.

Megjithatë, herët a vonë, natyra e vërtetë e miqve të rinj do t’i bëhet e qartë dhe pastaj taktikat e tua do të varen nga intelijenca e pacientit. Nëse është

mjaftueshëm mendjeshkurtër, mund të bësh që ta kuptojë karakterin e tyre vetëm kur janë larg tij; pastaj, kur ata janë të pranishëm, çdo lloj kritike bie poshtë. Nëse ia del me këtë, mund ta shtysh të jetojë dy jetë paralele (siç kam parë të ndodhë me shumë njerëz të tjerë) për periudha shumë të gjata; jo vetëm që do të duket, por do të bëhet një njeri i ndryshëm në secilin prej qarqeve që frekuenton. Nëse kjo dështon, ka dhe një rrugë tjetër më të fshehtë dhe më argëtuese. Mund ta bësh të kënaqet së tepërmi me mendimin se të dyja anët e jetës së tij janë në mospërputhje me njëra-tjetrën. Kjo arrihet nëse shfrytëzon mendjelehtësinë e pacientit. Mund ta mësosh t'i pëlqejë të gjunjëzohet në kishë të dielën, ngjitur me dyqanxhiun e lagjes, vetëm sepse mendon se ai nuk mund ta marrë me mend se ku kishte qenë ai të shtunën në darkë, në një botë të qytetëruar dhe ironike; dhe anasjelltas, t'i pëlqejnë sharjet dhe blasfemitë kur pi kafe me këta miq të admirueshëm edhe më tepër për shkak se ata nuk mund ta kuptojnë dot botën 'më të thellë', 'shpirtërore' brenda tij. E kape idenë? Miqtë e botës gjenden në njërën anë dhe dyqanxhiu në anën tjetër, ndërsa pacienti yt është njeriu i plotë, i balancuar

dhe kompleks, që i kupton të gjithë së bashku. Kështu, ndonëse tregohet përherë mashtrues ndaj të paktën dy grupe njerëzish, në vend të turpit ai do të ndiejë një rrymë të fshehtë vetëkënaqësie. Përfundimisht, nëse gjithçka tjetër dështon, mund ta bindësh, kundër ndërgjegjes, që ta vazhdojë miqësinë e re për arsyen se, në një mënyrë të papërcaktuar, po u bën ‘mirë’ këtyre njerëzve thjesht nga fakti se pi uiski bashkë me ta dhe qesh me shakatë e tyre, dhe se, nëse nuk do vepronte më kështu, do të ishte njeri ‘i zymtë’, ‘jotolerant’ dhe (sigurisht) ‘puritan’.

Ndërkohë, duhet patjetër të kujdesesh që ky zhvillim i ri ngjarjesh ta shtyjë të shpenzojë më tepër sesa e ka mundësinë dhe të lërë pas dore punën dhe nënën e tij. Xhelozia e saj dhe alarmi, si dhe ashpërsia dhe shmangia e tij në rritje, do të na vlejnë jashtëzakonisht për të përkeqësuar tensionin në familje.

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Mesa duket gjithçka po shkon vaj. U gëzova veçanërisht kur dëgjova se dy miqtë e rinj e kanë prezantuar tashmë pacientin tënd me gjithë shoqërinë e tyre. Të gjithë ata, mesa kam parë nga dosjet në zyrën e regjistrave, janë njerëz krejtësisht të besueshëm; tallës dhe mëkatarë të qëndrueshëm dhe të pandryshueshëm, të cilët, edhe pa kryer ndonjë krim spektakolar, po përparojnë qetësisht dhe pa kokëçarje drejt shtëpisë së Atit tonë. Ti më the edhe se qeshin shumë. Shpresoj se kjo nuk do të thotë që ke përshtypjen se e qeshura, në vetvete, është gjithmonë në favorin tonë. Ia vlen të kalojmë pak kohë mbi këtë temë.

Unë i ndaj shkaqet e të qeshurës njerëzore në: Gëzim, Qejf, Shaka e Pastër, dhe Tallje. Të parën e ndeshim mes miqsh dhe të dashurish kur bashkohen për ndonjë festë. Mes të rriturve gjendet gjithmonë ndonjë pretekst për

të qeshur me Shakatë. Megjithatë, lehtësia me të cilën shkaktojnë të qeshura edhe batutat më të vogla, në momente të tilla, tregon se ato nuk janë shkak i vërtetë i të qeshurës. Ne nuk e dimë se cili është shkak i vërtetë. Diçka e tillë shprehet edhe në një pjesë të madhe të atij arti të pështirë që njerëzit e quajnë Muzikë, dhe diçka e ngjashme ndodh edhe në Qiell – një përshpejtim i pakuptimtë i ritmit të përjetimit të qiellores që për ne është shumë i pakuptueshëm. E qeshura e këtij lloji nuk na ndihmon aspak dhe duhet dekurajuar gjithmonë. Përveç kësaj, ky fenomen, në vetvete, është i pështirë dhe një fyerje direkte kundër realizmit, dinjitetit dhe rreptësisë së Ferrit.

Qejfi lidhet ngushtë me Gëzimin – është një lloj bulëze emocionale që ka lidhje me lëvizjen e instinktit. Ai nuk na sjell ndonjë dobi të madhe. Sigurisht që ndonjëherë mund të përdoret për të larguar vëmendjen e njerëzve nga diçka tjetër që Armiku do të donte të bënin apo ndjenin; gjithsesi, në vetvete, Qejfi shkakton ndjenja të padëshirueshme për ne; ai nxit dashurinë, kurajën, kënaqësinë dhe shumë të këqija të tjera.

Shakaja e Pastër, e cila mund të perceptohet papritur

si ofendim, është një fushë shumë më premtuese. Nuk e kam fjalën dhe aq për humorin e pistë ose të pahijshëm, i cili, ndonëse përdoret shpesh si mbështetje nga tunduesit e dorës së dytë, nuk na sjell ndonjë rezultat. E vërteta është se në lidhje me këtë çështje, njerëzit ndahen mjaft qartë, në dy grupe. Ka njerëz që mendojnë se ‘asnjë pasion nuk është aq serioz sa epshi’. Për ta, një histori e pahijshme pushon së nxituri epsh pikërisht kur ai trajtohet si qesharak: ka të tjerë njerëz tek të cilët e qeshura dhe epshi nxiten njëkohësisht nga të njëjtat gjëra. Të parët bëjnë shaka për seksin duke e parë thjesht si një temë e cila nxit të qeshura: grupi i dytë përpiqet me çdo mënyrë të sigurojë një pretekst për të folur për seksin. Nëse pacienti yt i përket grupit të parë, nuk ka për të sjellë dobi humorin e pistë – nuk kam për t’i harruar kurrë orët që harxhova më kot (orë që, për mua, ishin një mërzi e pashoqe) me njërin nga pacientët e mi të parë nëpër bare dhe vende ku pihej duhani, derisa e mësova këtë rregull. Gjeje se cilit grup i përket pacienti – dhe kujdesu që ai vetë të mos e zbulojë.

Dobia e vërtetë e Shakave ose Humorit gjendet në një drejtim krejt të ndryshëm, çka është veçanërisht

premtuese tek anglezët të cilët e marrin ‘sensin e tyre të humorit’ kaq seriozisht saqë, për ta, nëse humori që bëjnë ka qoftë edhe një mangësi, kjo është pothuajse e vetmja mangësi për të cilën ndiejnë turp. Për ta, humori është hiri gjithë-ngushëllues dhe (mos e harro këtë), gjithë-shfajësues në jetë. Nëse dikush i lë të tjerët që të paguajnë për pijen e tij, konsiderohet ‘koprac’; nëse mburret për këtë gjë në mënyrë hokatare dhe i ngacmon miqtë duke u thënë se ua hodhi, ai nuk konsiderohet më ‘koprac’, por një njeri me humor. Të qenit frikacak është diçka e turpshme; por nëse frika vishet me ekzagjerime humoristike dhe gjeste groteske mund të paraqitet si diçka qesharake. Mizoria është diçka e turpshme – por jo kur njeriu mizor arrin ta paraqesë si një shaka praktike. As njëmijë shaka të pista, apo blasfemuese, nuk do të sillnin dënimin e përjetshëm të njeriut, aq sa mendimi se mund të bëjë pothuajse gjithçka që do, jo vetëm pa u qortuar prej shokëve, por madje duke fituar dhe admirimin e tyre; mjafton që ta trajtojë në formë Shakaje. Dhe mund të bëhen përpjekje që ky tundim të fshihet në mendjen e pacientit pas seriozitetit anglez në lidhje me Humorin. Çdo sugjerim se mos e tepron me Humorin mund t’i

paraqitet atij si ‘puritan’ dhe si tregues i mungesës së ‘sensit të humorit.’

Megjithatë, më e mira nga të gjitha mbetet tallja. Në radhë të parë, ajo është shumë ekonomike. Vetëm një njeri i zgjuar mund të bëjë Shaka të vërteta me virtytin dhe me çdo gjë tjetër në fakt; të gjithë njerëzit mund të stërviten për të folur për virtytin *si* të ishte diçka qesharake. Mes njerëzve tallës, gjithmonë supozohet se është bërë Shaka. Askush, në fakt, nuk bën shaka; por çdo temë serioze trajtohet në një mënyrë që tregon qartë se i kanë gjetur tashmë një anë qesharake. Nëse vazhdon gjatë, zakoni i talljes ndërton rreth njeriut parzmoren më të shkëlqyer që njoh kundër Armikut dhe nuk ka rreziqe që gjenden tek burimet e tjera të të qeshurës. Tallja është njëmijë kilometra larg gëzimit: në vend që ta mprehë intelektin, e çon drejt asgjësimit; dhe nuk nxit asnjë ndjenjë dashurie mes atyre që e praktikojnë.

Khaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Duket qartë se po përparon në mënyrë të shkëlqyer. E vetmja frikë që kam është se, në përpjekjen për ta afruar sa më parë pacientin me ne, mund ta zgjosh për të kuptuar pozicionin e tij të vërtetë. Sepse ne të dy që e shohim këtë pozicion siç është në të vërtetë, nuk duhet të harrojmë kurrë se sa ndryshe duhet t'i duket atij. Ne e dimë se kemi ndryshuar drejtimin e orientimit të tij, gjë e cila tashmë po e çon jashtë orbitës së tij rreth Armikut; por ai duhet të mendojë se të gjitha zgjedhjet që e kanë shkaktuar këtë ndryshim orientimi janë rastësore dhe të kthyeshme. Ai nuk duhet lënë të dyshojë se tani, ndonëse shumë ngadalë, është duke i kthyer plotësisht shpinën diellit dhe po shkon në një drejtim që do ta çojë në ftohtësinë dhe errësirën e cepit më të thellë të hapësirës.

Për këtë arsye, nuk e kam problem të marr vesh se ai ende shkon në kishë dhe merr darkën e Zotit. E di që

kjo gjë ka rreziqet e veta; por të gjitha këto janë më mirë sesa të ndërjegjësohet për ndryshimin e madh që ka nga muajt e tij të parë të jetës së krishterë. Për aq kohë sa i mban vetëm së jashtmi zakonet e një jete të krishterë, ke ende mundësi ta bësh të besojë se thjesht ka fituar disa miq dhe argëtime të reja dhe gjendja e tij shpirtërore është plotësisht e njëjtë me atë që ishte gjashtë javë më parë. Teksa ai vazhdon të mendojë kështu, neve nuk do të na duhet të luftojmë me pendimin e thellë për ndonjë mëkat të caktuar, të pranuar plotësisht, por vetëm me ndjesinë e vagullt, ndonëse shqetësuese, se kohët e fundit nuk po ecën dhe aq mirë.

Kjo trazirë e mjegullt duhet trajtuar me shumë kujdes. Nëse bëhet shumë e fortë, mund ta zgjojë dhe të na prishë gjithë planin. Nga ana tjetër, nëse ti e shtyp plotësisht – gjë të cilën Armiku ndoshta nuk do të ta lejojë – ne humbasim një element të situatës që mund ta kthenim në favorin tonë. Nëse e lejon një ndjenjë të tillë duke u kujdesur që të mos bëhet e parezistueshme aq sa të lulëzojë në pendim të vërtetë, atëherë kjo sjell një dobi të shkëlqyer. Ajo nxit pasigurinë e pacientit për të menduar për Armikun. Të gjithë njerëzit e kanë pothuajse gjatë gjithë kohës një lloj

ngurrimi; por, kur çmimi për të menduar për Armikun përfshin përballjen dhe zmadhimin e një reje të mjegullt plot me faj gjysmë të vetëdijshëm, ky ngurrim rritet dhjetëfish. Ata nuk e durojnë dot asnjë ide që u kujton Armikun, ashtu si njerëzit që kanë probleme financiare nuk durojnë dot t'u nxjerrësh librezën e kursimit. Në këtë gjendje, pacienti yt nuk do të heqë dorë plotësisht, por do t'i pëlqejnë gjithmonë e më pak detyrat e veta fetare. Ai do të mendojë për to sa më pak të jetë e mundur pa u ndier në faj dhe do t'i harrojë sa më shpejt të jetë e mundur pasi t'i ketë kryer ato. Disa javë më parë, ty të duhej ta *tundoje* që të shpërqendrohej dhe të mendonte për gjëra joreale në lutje: kurse tani e gjen atë duke të hapur krahët, pothuajse duke t'u lutur që t'ia heqësh vëmendjen nga qëllimi i tij dhe t'ia mpish zemrën. Ai do të *dojë* që lutjet të jenë joreale, sepse asgjëje nuk i druhet më tepër sesa përballjes së vërtetë me Armikun. Ai preferon më tepër ta lërë në gjumë ndërgjegjen që mund ta brejë si krimbi mollën.

Kur kjo gjendje të hedhë rrënjë edhe më thellë, gradualisht do të çlirohesh nga detyra e lodhshme e krijimit të Kënaqësive si tundime. Mungesa e qetësisë dhe ngurrimi

për t'u përballuar me Atë, e ndajnë pacientin tënd gjithnjë e më tepër nga lumturia reale. Nga ana tjetër, me t'u bërë zakon, kënaqësia e kotë, ngazëllimi nga shakatë pa kripë nuk do të jenë më aq tërheqëse, megjithëse do ta ketë të vështirë të heqë dorë (fatmirësisht, kjo është ajo që zakoni u bën kënaqësive). Pas kësaj, ke për të parë se gjithçka, madje dhe asgjëja do të mjaftojë për ta tërhequr vëmendjen e shpërqendruar të pacientit. Nuk do të kesh më nevojë për ndonjë libër të mirë, të cilin e pëlqen vërtet, për ta mbajtur larg lutjeve, punës, ose gjumit; një paragraf reklamash nga gazeta e djeshme do të mjaftojë. Ti mund ta bësh ta harxhojë kohën jo vetëm në biseda të këndshme me njerëz që i pëlqejnë, por edhe në biseda me njerëz që nuk i interesojnë dhe për tema që e mërzhisin. Mund ta bësh të rrijë pa bërë asgjë për një kohë të gjatë. Mund ta mbash zgjuar deri natën vonë, jo për qejf, por thjesht duke i fiksuar sytë mbi një zjarr të fikur në një dhomë të ftohtë. Të gjitha veprimtaritë e shëndetshme dhe shoqërore të cilat duam që ai t'i shmangë mund të pengohen pa i dhënë *asgjë* si shpërblim, e kështu, të paktën mund të thotë, siç tha një nga pacientët e mi kur arriti këtu poshtë: "Tani e shoh se pjesën më të madhe të jetës e kam kaluar duke

mos bërë *as* atë që duhej, *as* atë që doja”. Të krishterët e përshkruajnë Armikun si dikush “pa të cilin Asgjëja bëhet e fortë”. Dhe, vërtet, Asgjëja është shumë e fortë: aq e fortë sa t’ia vjedhë njeriut edhe vitet më të mira, jo duke kryer mëkate të ëmbla, por duke e lënë në një gjendje të tmerrshme trazire në mendje pa e ditur çfarë po ndodh dhe pse. Ai kënaqet me kureshtje kaq të kota saqë as nuk është i ndërgjegjshëm për to, troket gishtat mbi tavolinë ose tund këmbën, ose vërshtëllen melodi që nuk i pëlqejnë, ose zhytet në labirintin e gjatë dhe të mjegullt të mendimeve që nuk ndjellin as epsh e as ambicie për të qenë sadopak entuziaste. Megjithatë, në momentin kur diçka rastësore i nxit, krijesa hutohet dhe nuk ka fuqi për t’i larguar nga mendja.

Ty mund të të duken shumë të vogla këto mëkate ; dhe pa dyshim, si gjithë tunduesit e rinj, mezi po pret momentin kur do të mund të më raportosh ndonjë ligësi spektakolare. Por, mbaje mend mirë, e vetmja gjë që ka rëndësi është distanca që do të nxitësh mes njeriut dhe Armikut. Nuk ka rëndësi sa të vogla janë mëkatet, me kusht që pasoja e tyre në fund ta largojë njeriun nga Drita dhe ta çojë drejt Asgjësë. Një vrasje nuk është më e mirë

se loja me letra, nëse loja me letra arrin të sjellë sukses. Me të vërtetë, rruga më e sigurt për në Ferr është ajo graduale – e tatëpjeta e ëmbël, rënia e butë, pa kthesa të papritura, pa gurë kilometrikë dhe pa tabela qarkullimi.

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Më krijohet përshtypja sikur t'u deshën faqe të tëra për të treguar një ndodhi shumë të thjeshtë. Me pak fjalë, e ke lënë njeriun të të rrëskiste nga duart. Kjo situatë është shumë e rëndë dhe nuk shoh asnjë arsye se pse duhet të përpiqem të të mbroj nga pasojat e paaftësisë sate. Pendimi dhe ripërtëritja e asaj të cilën pala tjetër e quan 'hir', në mënyrën që e ke përshkruar ti, është një goditje fatale. Ajo vlen sa një kthim i dytë në besim – dhe mbase në një nivel më të thellë se i pari.

Siç duhet ta kishe ditur, aroma mbytëse e shenjtërisë që të pengoi ta sulmoje pacientin teksa kthehej nga mulliri i vjetër, është një fenomen i njohur tashmë. Është arma më barbare e Armikut që shfaqet përgjithësisht kur Ai është drejtpërdrejt i pranishëm te pacienti në disa mënyra të veçanta ende të paklasifikuara. Disa njerëz janë gjithnjë të rrethuar prej kësaj arome dhe, si rrjedhojë, nuk mund t'i prekim dot.

Le t'u kthehemi tani gafave të tua. Siç e ke pohuar edhe vetë, së pari ti e lejove pacientin të lexonte një libër që i pëlqen vërtet, thjesht sepse i pëlqen, jo me qëllim që të kishte material për të hapur biseda me miqtë e tij të rinj. Së dyti, e lejove të ecte deri te mulliri i vjetër dhe të pinte çaj atje – ecje që atij i pëlqen shumë dhe të cilën e bëri i vetëm. Me fjalë të tjera, i lejove të përjetonte dy Kënaqësi të mira. Kaq injorant u tregove sa nuk e kuptove rrezikun që qëndron pas kësaj? Veçoria e Dhimbjeve dhe Kënaqësive është se nuk mund të gabohesh mbi vërtetësinë e tyre dhe, për pasojë, në një masë të caktuar, ato i japin njeriut që i ndjen një referencë të prekshme të realitetit. Kështu, nëse do të përpiqeshe ta dënoje njeriun tënd me mallkimin e përjetshëm të metodës Romantike – duke e kthyer në një lloj Çajld Haroldi ose Verteri, të zhytur në keqardhje për veten, kapur pas trishtimesh imagjinare – atëherë do të duhej të përpiqeshe ta mbroje me çdo kusht nga çdo dhimbje e vërtetë; sepse, pa diskutim, edhe pesë minuta dhimbje e vërtetë dhëmbi do ta bënë të vetëdijshëm se vuajtjet romantike janë marrëzi dhe do t'ia çirrnin maskën gjithë strategjisë sate. Ti po përpiqeshe ta dënoje pacientin tënd përmes Botës, pra, duke ia shitur kotësitë, zhurmat,

ironinë dhe melankolinë si kënaqësi të vërteta? Si është e mundur që nuk e kuptove se një kënaqësi *e vërtetë* është gjëja e fundit që duhet ta lejoje të provonte? A nuk të shkoi mendja, se përmes kontrastit, Kënaqësia e vërtetë do të shkatërronte gjithë gënjeshtren e madhe të cilën je përpjekur me aq mund ta mësosh ta çmojë? Dhe se ai lloj kënaqësie që i dhanë libri dhe shëtitja ishte më i rrezikshmi nga të gjithë? Se kjo do t'ia hiqte koren që ti kishe formuar rreth ndjeshmërisë së tij dhe do ta bënte të ndihej se po kthehej në shtëpi, për të marrë veten? Si masë paraprake për ta ndarë nga Armiku, ti doje që ta ndaje nga vetvetja dhe kishe bërë njëfarë përparimi në këtë drejtim. Tani, gjithçka shkoi kot.

Sigurisht, unë e di se edhe Armiku do që t'i shkëputë njerëzit nga vetja e tyre, por në një mënyrë tjetër. Mos harro se Ai e do vërtet krimbin e vogël dhe e vlerëson në mënyrë absurde veçantinë e secilit prej tyre. Kur u kërkon që ta harrojnë vetveten, Ai e ka fjalën vetëm për braktisjen e zërit të egos; në çastin kur veprojnë kështu, Ai vërtet i lë të lirë të shpalosin gjithë personalitetin, dhe krenohet (fatkeqësisht, me sinjeritet) se, kur janë plotësisht të Tijtë, ata do të jenë vetvetja më tepër se

kurrë. Prandaj, ndonëse i pëlqen kur i sheh të heqin dorë edhe nga dëshirat e tyre më të pafajshme për hir të vullnetit të Tij, Atij nuk i pëlqen t'i shohë të largohen nga natyra e tyre për ndonjë lloj arsyeje tjetër. Ndaj ne duhet t'i inkurajojmë ata gjithmonë që të veprojnë në këtë mënyrë. Themelin e qenies së njeriut Armiku e ka pajisur me dëshira të thella dhe impulse. Prandaj, ia vlen gjithmonë të përpiqemi ta largojmë prej tyre; edhe në gjërat e parëndësishme është gjithmonë dobiprurëse t'i zëvendësojmë pëlqimet apo mospëlqimet e njeriut me modën, me standardet e Botës, ose me rregullat e shoqërisë. Unë vetë do të shkoja edhe më larg. Do ta bëja ligj çrrënjosjen nga pacienti im të çdo shijeje të fortë personale që nuk është mëkat, edhe sikur ajo të jetë diçka e parëndësishme si kënaqësia e lojës së kriketit, e koleksionimit të pullave apo e pirjes së kakaos. Jam plotësisht dakord me ty kur thua se gjëra të tilla nuk kanë asnjë lloj virtyti në vetvete; por në to ka një lloj pafajësie, përulësie dhe harrese të vetes që unë e shoh me shumë dyshim. Njeriu që pëlqen me të vërtetë dhe pa interes çfarëdolloj gjëje në botë, thjesht sepse i pëlqen dhe nuk e vret mendjen çfarë thonë të tjerët për këtë, është për

këtë shkak i parapërgatitur kundër disa prej sulmeve tona më dinake. Ti duhet të përpiqesh vazhdimisht ta bësh pacientin t'i braktisë njerëzit, ushqimet ose librat që pëlqen vërtet, në këmbim të njerëzve “më të mirë”, ushqimeve “më të përshtatshme”, dhe librave “më të rëndësishëm”. Kam njohur një njeri i cili ishte i mbrojtur nga tundimet më të forta për ambicie shoqërore për shkak se preferenca e tij për qepët dhe kukurecin e mbante larg nga tundimi.

Mbetet për t'u parë se si mund ta marrim veten nga kjo fatkeqësi. E mira është të mos e lejosh të kryejë asnjë lloj veprimi. Për sa kohë që ai nuk e kthen mendimin në veprim, nuk ka rëndësi se sa shumë mendon për këtë pendim të ri. Lëre këtë shtazë të vogël që të zhgërryhet në të. Nëse ka ndonjë prirje për të shkruar, le të shkruajë edhe ndonjë libër për pendimin; kjo është shpesh një mënyrë e shkëlqyer për të mos lejuar të mbijnë farat që Armiku hedh në shpirtin njerëzor. Le të bëjë gjithçka përveç veprimit. Asnjë masë përshpirtjeje në imagjinatën dhe ndjenjat e tij nuk na dëmton nëse mund ta mbajmë larg nga vullneti i tij. Siç është shprehur një nga qeniet njerëzore, zakonet aktive forcohen nga përsëritja kur

zakonet pasive dobësohen prej saj. Sa më tepër të përqendrohet tek ndjenjat, pa kaluar në veprim, aq më pak do të jetë në gjendje të veprojë dhe, me kalimin e kohës, pak nga pak nuk do të jetë në gjendje as të ndiejë.

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Gjëja më shqetësuese ndër ato që më tregove së fundmi për pacientin, është se ai nuk po merr asnjë nga ato vendimet plot vetëbesim që e karakterizonin kur u kthye për herë të parë në besim. Nuk ka më premtime madhështore për virtyt të përhershëm, mesa shoh; madje nuk pret as që t'i jepet 'hir' i përjetshëm, por vetëm shpreson për mëshirë të përditshme për të përballuar tundimet e ditës! Shumë keq.

Vetëm një gjë mund të bëhet për momentin, nga çfarë shoh unë. Pacienti yt është bërë i përulur; a ia ke sjellë në mendje këtë fakt? Të gjitha virtytet bëhen më pak të frikshme sapo njerëzit bëhen të vetëdijsëm se i kanë, por kjo është veçanërisht e vërtetë për përulësinë. Kape në momentin kur është vërtet i varfër në frymë dhe futi vjedhurazi në mendje reflektimin krenar: "Për be! Qenka i përulur!" dhe pothuajse menjëherë krenaria

– krenaria për përulësinë që ka – do të ngrejë kokë. Nëse ai e kupton këtë rrezik dhe përpiqet ta shuajë këtë lloj forme të re krenarie, bëje të ndihet krenar për këtë përpjekje – e kështu me radhë, nëpër gjithë fazat që do ti. Por mos e përdor këtë taktikë për shumë kohë, sepse mund t’i zgjosh ndjenjën e humorit dhe të masës, dhe kështu thjesht do të qeshë me ty dhe do të shkojë të flejë.

Por ka dhe të tjera mënyra fitimprurëse për t’ia fiksuar vëmendjen te virtyti i Përulësisë. Përmes këtij virtyti, ashtu si përmes të tjerëve, Armiku ynë dëshiron t’ia largojë njeriut vëmendjen nga vetja për t’ia kthyer drejt Tij dhe drejt të afërmeve të vet. Kundër kësaj, jo më kot, në fund të fundit, është projektuar dëshpërimi dhe mohimi i vetes; nëse nuk e arrijnë këtë qëllim, ata nuk na dëmtojnë. Madje ata mund edhe të na ndihmojnë, nëse e mbajnë njeriun të zënë me veten dhe, mbi të gjitha, nëse përçmimi i vetes mund të kthehet në pikën fillestare për të përçmuar të tjerët, duke çuar në zymtësi, cinizëm dhe mungesë mëshire.

Prandaj, pacientit, duhet t’ia mbash të fshehtë qëllimin e vërtetë të Përulësisë. Le ta mendojë atë, jo si mohim të unit, por si një lloj opinionioni (pra, një opinion

i ulët) për dhuntitë dhe karakterin e vet. Besoj se i ka disa dhunti. Fikso në mendjen e tij idenë se përulësia ka të bëjë me përpjekjen për të besuar se këto dhunti janë më pak të vlefshme nga sa mendon ai. Pa dyshim që ato vërtet janë më pak të vlefshme nga sa mendon ai, por nuk është kjo më e rëndësishmja. Më e mira do të ishte ta bëje pacientin ta vlerësojë një opinion në bazë të një kriteri të ndryshëm nga vërtetësia, duke futur kështu një element pandershmërie dhe imagjinate në thelb të asaj që, në të kundërt, mund të kthehej në virtyt. Me këtë metodë kemi bërë mijëra njerëz të mendojnë se përulësi është kur gratë e bukura përpiqen të besojnë se janë të shëmtuara dhe burrat e zgjuar përpiqen të besojnë se janë mendjeshkurtër. Dhe meqë ajo që ata përpiqen të besojnë mund të jetë, në disa raste, një marrëzi e dukshme, ata nuk mund të arrijnë ta besojnë vërtet e këtu ne kemi rastin t'ua mbajmë mendjen të përqendruar vetëm te vetja, në një përpjekje për të arritur të pamundurën. Për t'i paraprirë strategjisë së Armikut, duhet të marrim parasysht armët e Tij. Armiku dëshiron që njeriu të arrijë në atë mendësi ku pasi ai të jetë i aftë të skicojë katedralen më të bukur në botë,

ta dijë se është më e bukura dhe të gëzohet prej këtij fakti, të jetë i lumtur duke ditur që e ka bërë ai, por të ndiejë po atë lumturi edhe nëse e ka bërë dikush tjetër. Armiku do që në fund ai të jetë aq i çliruar nga çdo anësi në favorin e vet, sa që të mund të gëzohet për talentet e veta me po aq sinqeritet dhe mirënjohje sa do të gëzohej për talentet e fqinjit të tij – ose për lindjen e diellit, për elefantët, apo për një ujëvarë. Ai do që çdo njeri, me kalimin e kohës, të arrijë t’i vlerësojë të gjitha krijesat (përfshi dhe veten) si të lavdishme dhe të mira. Ai do që t’i japë fund dashurisë së tyre egoiste për veten sa më shpejt të jetë e mundur; por në politikën e Tij afatgjatë, fatkeqësisht, Ai dëshiron të krijojë në ta një lloj të ri dashurie për veten – një dashuri dhe mirënjohje për të gjitha qeniet, përfshirë edhe vetveten; pasi të kenë mësuar vërtet t’i duan të afërmit si veten, do t’u lejohej që ta duan vetveten siç duan të afërmit. Sepse nuk duhet ta harrojmë kurrë tiparin më të neveritshëm dhe më të pashpjegueshëm të Armikut; Ai i do *vërtet* dykëmbëshat pa qime që ka krijuar dhe gjithmonë ua kthen me dorën e djathtë atë që ka marrë me të majtën.

Për këtë arsye, i gjithë qëllimi i tij është ta largojë fare

mendjen e njeriut nga vlerat e veta. Atij do t'i pëlqente më tepër nëse njeriu do ta shikonte veten si arkitekt i mirë, apo poet i madh e më pas ta harronte këtë gjë, sesa të harxhonte kohë dhe përpjekje për ta menduar veten të paaftë në këto drejtime. Për pasojë, përpjekjeve të tua për të futur krenari ose përlësi të rreme te pacienti, do t'u përgjigjet Armiku, i cili thekson se nuk është detyra e njeriut të ketë një opinion për talentin e vet, përderisa talentin mund ta përmirësojë fare mirë edhe pa e vendosur më parë se cili është pikërisht vendi i tij në tempullin e Famës. Duhet të përpiqesh ta përjashtosh këtë vërejtje nga vetëdija e pacientit, me çdo kusht. Armiku do të përpiqet gjithashtu ta bëjë reale në mendjen e pacientit atë doktrinë të cilën të gjithë ata e rrëfejnë me gojë, por jo gjithmonë ecën paralelisht me ndjenjat e tyre – doktrinën që nuk e krijuan njerëzit veten, që talentet e tyre ua ka dhënë Armiku dhe të krenohesh për këtë është njëlloj si të jesh krenar për ngjyrën e flokut. Gjithsesi, gjithmonë dhe me çdo kusht, qëllimi i Armikut do të jetë t'ia largojë pacientit mendjen nga këto çështje, ndërsa qëllimi yt është t'ia fiksosh mendjen në to. Madje, as për mëkatet, Armiku nuk do që njeriu të mendojë së tepërmi; në çastin

që pendohet, sa më shpejt njeriu ta kthejë vëmendjen
jashtë vetes, aq më tepër kënaqet Armiku.

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Sigurisht që e kam vënë re se njerëzit po kalojnë një periudhë qetësie përse i përket luftës së tyre Europiane – të cilën, në mënyrë naive, ata e quajnë ‘Lufta e Madhe’. Dhe nuk habitem që kjo situatë ka tulatur disi edhe shqetësimet e pacientit. Tani, si të bëjmë, ta inkurajojmë këtë gjë, apo të vazhdojmë ta mbajmë të shqetësuar? Si tortura dhe frika, ashtu edhe vetëbesimi mendjeshkurtër janë të dyja gjendje mendore të cilat na intereson t’i inkurajojmë. Zgjedhja jonë mes njërës apo tjetrës, u lë hapësirë pyetjeve të rëndësishme.

Njerëzit jetojnë në kohë, por Armiku ynë ka plane për ta në përjetësi. Besoj se për këtë arsye ai kërkon që ata të merren kryesisht me dy gjëra: me vetë përjetësinë dhe me atë pikë në kohë të cilën njerëzit e quajnë e Tashme. Sepse e Tashmja është pika në të cilën koha prek përjetësinë. Vetëm në momentin e tashëm, dhe

vetëm në të, njerëzit kanë një përjetim të ngjashëm me përjetimin që Armiku ynë ka për realitetin në tërësi; vetëm në të tashmen njerëzit mund të përjetojnë lirinë dhe aktualitetin. Prandaj, Ai dëshiron t'i mbajë të zënë vazhdimisht, ose me përjetësinë (që do të thotë me Të), ose me të Tashmen – ose të meditojnë për bashkimin (ose ndarjen) e tyre të përjetshme me Të, ose t'i binden zërit të ndërgjegjes tani, të mbajnë kryqin e tyre tani, të marrin hirin e tanishëm, të jenë mirënjohës për kënaqësinë e tanishme.

Detyra jonë është t'i largojmë nga e përjetshmja dhe e Tashmja. Me këtë qëllim në mendje, ndonjëherë e tundojmë një njeri (për shembull, një të ve ose një studiues) që të jetojë në të Kaluarën. Por, vlera e kësaj përpjekjeje është e kufizuar, pasi ata e kanë njëfarë njohurie reale të së kaluarës, e dinë që ajo ka një natyrë të përcaktuar e, në këtë drejtim, i ngjan përjetësisë. Do të ishte shumë më mirë nëse arrijmë t'i bëjmë të jetojnë në të Ardhmen. Nevoja biologjike bën që t'i drejtojnë të gjitha pasionet e tyre që tani në këtë drejtim, prandaj mendimi për të Ardhmen shkakton frikë dhe shpresë. Gjithashtu, ajo është e panjohur për ta, kështu që duke

i bërë të mendojnë për të, ne i bëjmë të mendojnë për gjëra joreale. Me një fjalë, nga gjithë të tjerat, e Ardhmja është ajo që i ngjan *më pak* Përjetësisë. Është pjesa më e përkohshme e kohës – sepse e Kaluara është e ngrirë e nuk rrjedh më, ndërsa e Tashmja është e ndriçuar e gjitha me rreze të përjetshme. Kjo është arsyeja pse i kemi inkurajuar gjithë ato lloj skemash mendimi si Evolucioni Krijues, Humanizmi Shkencor apo Komunizmi, të cilat i fiksojnë dëshirat e njerëzve tek e Ardhmja, te vetë thelbi i të përkohshmes. Për rrjedhojë, gati të gjitha veset i kanë rrënjët tek e ardhmja. Mirënjohja shikon nga e kaluara, ndërsa dashuria tek e tashmja; frika, lakmia, epshi dhe ambicia shikojnë drejt së ardhmes. Mos mendo se epshi bën përjashtim. Kur arrihet kënaqësia e tashme, mëkati (e vetmja gjë që na intereson), tashmë ka mbaruar. Kënaqësia është thjesht pjesa e procesit për të cilën na vjen keq dhe që do ta përjashtonim po ta bënim dot pa humbur mëkatin; ajo është pjesa ku kontribuon Armiku dhe, si rrjedhojë, përjetohet në një të Tashme. Mëkati, i cili është kontributi ynë, shikon përpara drejt të ardhmes.

Sigurisht, Armiku do që njerëzit të mendojnë edhe për të Ardhmen – aq sa është e nevojshme për të planifikuar

në të tashmen veprat e drejtësisë, apo dhembshurisë që mund t'i kenë si detyrë t'i kryejnë të nesërmen. Planifikimi i punës së nesërme është detyrë e të *sotmes*; ndonëse realizimi i saj i përket të ardhmes, kjo detyrë, si gjithë të tjerat, është në të Tashmen. T'i ndash këto, është njëlloj si të ndash fijen e flokut në mes. Ai nuk do që njerëzit t'ia japin zemrën të Ardhmes, ta vendosin tek ajo thesarin e tyre. Por nga ana tjetër, kjo është ajo që ne duam. Idealja për Të është njeriu i cili, pasi ka punuar gjithë ditën për të mirën e brezave të ardhshëm (nëse profesioni i tij është i tillë), e pastron mendjen nga e gjithë kjo çështje, ia përkushton atë Qiellit dhe kthehet menjëherë te durimi ose mirënjohja që i nevojiten për të vazhduar. Ndërsa ne duam një njeri të torturuar me makthe për të Ardhmen – të përndjekur nga vizione të një qielli, apo ferri të pashmangshëm mbi tokë – të gatshëm t'i shkelë urdhrat e Armikut në të tashmen nëse e bëjmë të mendojë se, duke vepruar kështu, mund të fitojë njërën dhe ta shmangë tjetrën – besimi i tij varet nga suksesi ose dështimi i skemave, fundin e të cilave ai nuk do të mund ta shohë sepse nuk do jetojë dot aq gjatë. Ne duam një racë njerëzore përherë në ndjekje të ylberit,

të pandershme, pa mirësi, pa lumturi *tani*, por gjithmonë duke i përdorur thjesht si lëndë djegëse për altarin e së ardhmes dhuratat e vërteta që i ofrohen në të Tashmen.

Si rrjedhojë, nëse i lëmë gjërat siç janë, përgjithësisht është më mirë që pacienti yt të mbushet me ankth ose shpresë (nuk ka rëndësi se cila) për këtë luftë, sesa të vazhdojë të jetojë në të tashmen. Por fraza ‘të jetojë në të tashmen’ është me kuptim të dyfishtë. Ajo mund të përshkruajë një proces në të cilin pacienti në fakt është kaq i preokupuar për të Ardhmen, sa mund të quhet edhe ankth. Pacienti yt mund të mos jetë i shqetësuar për të Ardhmen, jo sepse është i përqendruar tek e Tashmja, por sepse e ka bindur veten se e Ardhmja do të jetë e pranueshme. Për aq kohë sa kjo është arsyeja e vërtetë e qetësisë së tij, kjo do të na vlejë shumë, sepse vetëm shton zhgënjimet dhe, për rrjedhojë, edhe padurimin e tij kur shpresat e rreme t’i shkatërrohen. Por, nga ana tjetër, nëse ai është i vetëdijshëm që mund t’i ndodhin gjëra të tmerrshme dhe po lutet për virtyte për t’i përballuar ato, e ndërkohë përqendrohet tek e Tashmja sepse atje, dhe vetëm atje, qëndron gjithë misioni, gjithë hiri, gjithë njohuria dhe gjithë kënaqësia, atëherë gjendja e tij është

shumë e padëshirueshme dhe duhet sulmuar menjëherë. Por edhe këtu, Krahun ynë Filologjik ka bërë një punë të mirë; provo fjalën “vetëkënaqësi” në këtë rast. Gjithsesi, sigurisht, me shumë gjasë ai po “jeton në të Tashmen” jo për ndonjë arsye tjetër, por thjesht sepse po i shkon shumë mirë shëndeti dhe po i pëlqen puna që bën. Ky fenomen duket thjesht i natyrshëm. Gjithsesi, unë do ta ndërprisja po të isha në vendin tënd. Asnjë fenomen i natyrshëm nuk është vërtet në favorin tonë. Dhe, në fund të fundit, pse *duhet* ta lëmë krijesën të jetë e lumtur?

Khaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Më përmende shkarazi në letrën e fundit se pacienti ka vazhduar gjithë kohën të ndjekë një kishë dhe vetëm një, që kur është bërë besimtar edhe pse nuk është plotësisht i kënaqur me të. Mund të të pyes se me çfarë je duke u marrë? Pse nuk kam asnjë raport në lidhje me shkaqet e besnikërisë së tij ndaj kishës së lagjes? A e kupton se nëse nuk është për shkak të indiferencës, atëherë kjo është diçka shumë e keqe? Ti sigurisht e di se nëse nuk e kuron dot njeriun nga të shkuarit në kishë, gjëja më e mirë që mund të bësh është ta dërgosh nëpër qytet për të kërkuar kishën që “i përshtatet”, derisa të kthehet në një shëtitës kishash.

Arsyet janë të qarta. Së pari, kishat që organizohen në bazë lagjesh duhen sulmuar gjithmonë, sepse, për arsye se i bashkojnë njerëzit në bazë të afërsisë gjeografike dhe jo sipas preferencave, bëjnë bashkë njerëz nga klasa të

ndryshme shoqërore dhe me psikologji të ndryshme në atë lloj bashkësie që kërkon Armiku. Ndërsa, nga ana tjetër, parimi i organizimit në bazë të bindjeve të caktuara, e bën kishën si një lloj klubi dhe, përfundimisht, nëse gjithçka shkon mirë, si një fraksion ose klan. Së dyti, kërkimi për një kishë ‘të përshtatshme’ e kthen njeriun në kritik ndërkohë që Armiku do që ai të jetë nxënës. Ajo që Ai do nga një anëtar i kishës është një qëndrim që, vërtet, mund të jetë kritik në kuptimin e refuzimit të asaj që është e rreme dhe e padobishme, por që është plotësisht pranues në kuptimin që nuk fokusohet te kritika – nuk e harxhon kohën duke menduar për atë që nuk pranon, por e mban veten të hapur, pa komente dhe në mënyrë të përvuilur, ndaj çdo ushqimi të mirë që i ofrohet. (E sheh sa servil, sa joshpirtëror dhe sa vulgar i pariparueshëm është Ai!) Ky qëndrim, sidomos gjatë predikimeve, krijon kushtet (shumë armiqësore ndaj gjithë politikës sonë) që një e vërtetë e thjeshtë të bëhet vërtet e pranueshme për një shpirt njerëzor. Nuk ka asnjë predikim, apo asnjë libër, që mund të mos përbëjë rrezik për ne nëse merret me këtë lloj qëndrimi. Prandaj, të lutem shumë, ngrihu dhe dërgoje këtë budalla rreth e

përqark kishave të qytetit sa më parë që të jetë e mundur. Deri tani raporti yt lë shumë për të dëshiruar.

Kërkova informacion në zyrë për dy kishat që ndodhen më pranë tij. Në secilën prej tyre ka hapësirë ku mund të ndërhyjmë ne. Në kishën e parë, prifti është marrë kaq gjatë me hollimin e mesazhit për ta bërë më të lehtë shërbimin ndaj bashkësisë, e cila në dukje është jobesimtare dhe kokëfortë, sa që tani është ai që po i trondit anëtarët e kishës me mosbesimin e tij, jo *anasjellas*. Ai po minon krishtërimin e shumë njerëzve. Edhe sjellja e tij në shërbesa është e admirueshme. Për t’ia kursyer kishës gjithë “telashet”, ai e ka lënë mënjanë si planin e leximit të përgjithshëm, ashtu edhe psalme të caktuara, duke u marrë gjithë kohën me rreth pesëmbëdhjetë psalme dhe njëzet mësimet e tij të preferuara. Kështu, nuk ekziston rreziku që ndonjë e vërtetë që nuk e njeh ai apo tufa e tij, të arrijë t’i prekë përmes Shkrimeve. Por ndoshta pacienti yt nuk është aq teveqel sa të shkojë në këtë kishë – ose, akoma jo?

Te kisha tjetër kemi Atë Spajkun. Njerëzit shpesh e kanë shumë të vështirë t’i kuptojnë të gjitha opinionet e tij – pse një ditë ai është pothuajse komunist dhe ditën tjetër

i afrohet shumë një lloj teokracie fashiste – një ditë sillet si skolastik, ditën tjetër është gati ta mohojë plotësisht arsyen njerëzore – një ditë zhytet në politikë dhe ditën tjetër deklaron se të gjitha shtetet e botës janë *njësoj* “nën ndëshkim”. Ne, sigurisht, e shohim se lidhja që i bashkon këto opinione është Urrejtja. Në çdo predikim të tijin ai ka si synim që t’i tronditë, trishtojë, hutojë, apo poshtërojë prindërit e tij dhe miqtë e tyre. Një predikim që do të ishte i pranueshëm për ta, do të ishte për të aq pa shije sa një poemë të cilës nuk i hidhen sytë. Gjithashtu, tek ai gjendet një tipar premtues: pandershmëria; ne po e mësojmë të thotë “Mësimi i Kishës është ...” kur në fakt nënkupton: “Jam pothuajse i sigurt se kam lexuar kohët e fundit nga Maritain¹, ose nga dikush tjetër”. Por duhet të të paralajmëroj se ai ka një të metë fatale: ai beson vërtet. Dhe kjo mund t’i vërë kazmën punës sonë.

Megjithatë, ka një pikë pozitive, të cilën e kanë të përbashkët të dyja kishat – ato janë të dyja kisha të përçara. Besoj se të kam paralajmëruar që më parë se nëse nuk mund ta detyrosh dot pacientin tënd që të mos

1 Jacques Maritain, filozof francez dhe politikan i shekullit XX. (Shënim i redaktorit)

shkojë në Kishë, të paktën duhet të bësh që të lidhet fort me ndonjë grupim brenda saj. Nuk e kam fjalën për çështje doktrimore; në lidhje me to, sa më i vakët të jetë, aq më mirë është. Dhe neve nuk na shërben thjesht ndarja doktrimore për të prodhuar ligësi. Argëtimi i vërtetë është kur ushqejmë urrejtje mes atyre që thonë “meshë” dhe atyre që thonë “kungim i shenjtë”, edhe pse asnjëri prej këtyre dy grupeve nuk mund të bëjë dallimin mes, fjala bie, doktrinës së Hooker-it dhe asaj të Thoma Akuinit. Ky debat nuk mund të rezistojë as edhe vetëm për pesë minuta. Dhe të gjitha gjërat krejt të parëndësishme – qirinjtë, veshjet, e kështu me radhë – janë një terren i admirueshëm për veprimtaritë tona. E kemi larguar shumë nga mendjet e njerëzve atë që ai tipi i bezdisshëm, Pali, mësonte në lidhje me ushqimet dhe gjërat e tjera të parëndësishme – domethënë, që njeriu pa skrupuj duhet të dorëzohet para njeriut me skrupuj. Ndoshta ke menduar se ata duhet të jenë në gjendje ta kuptojnë zbatimin e këtij mësimi. Mund të kesh menduar se anëtari “i vogël” i kishës duhet të përulet dhe të mënjanojë veten me qëllim që ndërgjegjja e vëllait “të madh” të mos bëhet përçmuese, ndërsa “i

madhi” të heqë dorë nga këto praktika që të mos e shtyjë ndërgjegjen e vëllait “të vogël” drejt idhujtarisë. Dhe kështu do të ndodhte vërtet pa punën tonë të palodhur. Pa ndikimin tonë, larmia e ndryshimeve brenda Kishës në Angli mund të ishte kthyer në një vatër të ngrohtë dashurie dhe përvulësie.

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Përçmimi që ke shprehur në letrën tënde të fundit në lidhje me grykësinë si mjet për të kapur shpirtrat njerëzore, tregon vetëm një gjë: që je injorant. Një nga arritjet më të mëdha në njëqind vitet e fundit ka qenë mpirja e ndërgjegjes njerëzore përsa i përket kësaj teme, aq sa tani rrallëherë dëgjohet ndonjë predikim mbi këtë çështje, apo shqetësohet ndonjë ndërgjegje për të në gjithë hapësirën e Europës. Këtu kanë ndikuar kryesisht të gjitha përpjekjet tona për të veçuar grykësinë e Cilësisë nga grykësia e Sasisë. Nëna e pacientit tënd, siç e lexova nëpër dosje dhe siç mund ta kesh mësuar nga Jargaveci, është një shembull i shkëlqyer. Ajo do të habitej – një ditë, shpresoj, se do të habitet *vërtet* – nëse do të mësonte se e gjithë jeta e saj është nën skllavërinë e këtij lloj mëkati, çka ajo e ka të vështirë ta kuptojë për faktin se bëhet fjalë për sasi të vogla. Po ç' rëndësi ka sasia, nëse

ne mund ta përdorim stomakun dhe qiellzën njerëzore për të prodhuar pakënaqësi, padurim, mosdashje dhe shqetësim për vetveten? Jargaveci e ka shtënë në dorë si jo më mirë plakën. Ajo është një tmerr i vërtetë për miqtë dhe shërbyesit e saj. Ajo refuzon gjithmonë atë që i ofrohet duke psherëtirë e trishtuar dhe me një buzëqeshje në fytyrë: “Oh, ju lutem, ju lutem... nuk dua asgjë, vetëm një filxhan çaj, të fortë, por jo shumë dhe një copëz të vogël buke sa më të thekur.” E sheh? Për shkak se ajo që dëshiron është më e vogël dhe më pak e kushtueshme sesa ajo që i vihet përpara, plaka nuk e konsideron si grykësi vendosmërinë për të marrë atë që do, sado telashe që mund të shkaktojë kjo për të tjerët. Ndërsa është duke kënaqur oreksin e vet, ajo beson se po praktikon vetëpërmbajtjen. Në një restorant plot me njerëz, ajo lëshon një klithmë të lehtë mbi pjatën që ia ka vënë përpara një kamarierë tejet e lodhur nga puna dhe thotë : “Oh, kjo është vërtet tepër! Hiqe këtë dhe më sill vetëm çerekun e saj”. Nëse përpiqesh ta ndërjegjësosh për këtë, do të të përgjigjej se e bën për të shmangur harxhimin e kotë; në të vërtetë, ajo vepron kështu për shkak të imazhit të veçantë të Cilësisë me të cilin ne e

kemi skllavëruar, çka e bën të ndihet e fyer kur i vihet përpara më tepër ushqim sesa dëshiron në atë moment.

Punës së heshtur dhe të padukshme që Jargaveci ka bërë prej vitesh te kjo grua e moshuar mund t'i duken frytet teksa sheh se tani stomaku ia dominon gjithë jetën. Plaka është në një gjendje të tillë mendore që mund të titullohej “E vetmja gjë që dua”. *E vetmja gjë* që ajo do është vetëm një filxhan çaj i përgatitur si duhet, ose një vezë e zier aq sa duhet, ose një fetë bukë e thekur aq sa duhet. Por kurrë nuk mund të gjesh një shërbëtore ose shoqe që mund t'i bëjë këto gjëra të thjeshta “si duhet” – sepse kriteri “si duhet” i saj fsheh në vetvete një kërkesë të pamundur për t'u plotësuar, shumë të veçantë dhe pothuajse të pamundur për të kënaqur qiellzën e saj. Në imagjinatën e saj, këto kënaqësi, i mban mend nga e kaluara; kur, siç shprehet ajo, ishin “kohë kur mund të gjeje vërtet shërbëtorë të mirë”, por që ne e dimë shumë mirë se ato ishin kohë kur shijet e saj ishin më të lehta për t'u kënaqur dhe ajo kishte të tjera lloje kënaqësish, që e bënë më pak të varur nga kënaqësitë e tryezës. Në të njëjtën kohë, zhgënjimi i përditshëm krijon prishje terezie të përditshme: kuzhinierët largohen dhe miqësitë

ftohen. Nëse Armiku përpiqet t'i fusë në mendje plakës edhe dyshimin më të vogël se po i kushton më tepër rëndësi se sa duhet ushqimit, Jargaveci i kundërpërgjigjet duke i shtënë në mendje asaj se ajo nuk po shqetësohet për atë që ha vetë, por se “i pëlqen të ketë ushqime të shijshme për djalin e saj”. Natyrisht që lakmia e saj ka qenë në fakt një nga burimet kryesore të pakënaqësisë së tij në atë familje prej vitesh.

Tani pacienti yt është i biri i nënës së vet. Duke vazhduar të punosh me gjithë fuqinë tënde, dhe me të drejtë, edhe në fronte të tjera, mos neglizho as edhe ndonjë ndërhyrje të vogël e të heshtur në fushën e grykësisë. Si mashkull që është, nuk besoj se ai do ta hajë karremin e kamuflazhit “*E vetmja gjë që dua*”. Meshkujt kthehen më lehtë në grykës përmes krenarisë së tyre të kotë. Ata duhen nxitur të mendojnë se i njohin shumë mirë ushqimet, të mburren se kanë gjetur të vetmin restorant në qytet ku bëhen “siç duhet” biftekët. Ajo që nis si mburrje e kotë mund të kthehet gradualisht në një zakon. Megjithatë, sido që ta trajtosh këtë çështje, gjëja më e bukur është ta sjellësh atë në një gjendje ku, nëse i mohohet ndonjë kënaqësi – nuk ka rëndësi cila,

shampanjë apo çaj, gatim francez apo cigare, – ai “del jashtë kontrollit”, pasi atëherë, dashuria, drejtësia dhe bindja e tij, mbeten plotësisht në mëshirën tënde.

Teprimi në ushqim nuk ka aq shumë ndikim sa të qenit sqimatar në lidhje me të. Frytet e tij duken kryesisht në sulmet kundër dëlirësisë. Mbi këtë çështje, ashtu si në çështjet e tjera, mbaje pacientin në një formë të rreme të të ashtuquajturit shpirtëror. Mos e lejo kurrë të kuptojë aspektin mjekësor. Bëj që të pyesë veten vazhdimisht se çfarë krenarie ose mungese besimi e ka hedhur në duart e tua, kur një shqyrtim i thjeshtë i asaj që ka ngrënë dhe pirë në njëzetekatër orët e fundit do t’ia bënin të qartë nga vjen municioni yt dhe kështu do të mundte, me pak vetëpërmbajtje, t’i vinte në rrezik linjat e tua të komunikimit. Nëse *nuk mund të mos mendojë* për anën mjekësore të dëlirësisë, ushqeje me gënjeshtër e madhe të cilën, falë nesh, gjithë anglezët e besojnë, se ky virtyt përforcohet nga ushtrimi i tepërt fizik dhe lodhja që pason. Si arrijnë ta besojnë këtë, kur shohin epshin aq me nam të marinarëve dhe ushtarëve, as unë nuk e kuptoj. Por ne përdorëm drejtorët e shkollave për ta ndryshuar historinë – njerëz që ishin vërtet të interesuar

për ta përdorur dëlirësinë si justifikim për lojërat dhe, si rrjedhojë, i rekomanduan lojërat si ndihmë për dëlirësinë. Por e gjithë kjo çështje është tepër e gjerë për t'u trajtuar në fund të një letre.

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Edhe pse nën drejtimin e Gojëlëmshit, kolegji duhet t'ju ketë mësuar teknikën rutinë të tundimit seksual dhe, meqë për ne shpirtrat, e gjithë kjo temë shkakton një mërzi të madhe (ndonëse është pjesë e nevojshme e trajnimit), nuk do ta trajtoj më tej. Por për çështje më të rëndësishme në lidhje me të, mendoj se ke shumë për të mësuar.

Armiku kërkon që njerëzit të mbajnë njërin prej qëndrimeve; *ose* dorëheqje e plotë, *ose* monogami e padiskutueshme. Që nga fitorja e parë e madhe e Atit tonë, të parën e kemi bërë tejet të vështirë për ta. Të dytën, gjatë shekujve të fundit, e kemi mbyllur si rrugë shpëtimi. Këtë e kemi bërë përmes poetëve dhe romancierëve, të cilët i bindin njerëzit se ajo përvojë e çuditshme, zakonisht jetëshkurtër, që ata e quajnë 'të rënit në dashuri' është e vetmja bazë e vlefshme për martesën; se martesë mundet, dhe duhet ta bëjë të përjetshëm këtë lloj emocioni;

dhe se martesja që nuk e bën dot këtë, nuk është më e detyrueshme të ruhet. Në fakt, në këtë mënyrë, ne kemi parodizuar një ide që e ka origjinën nga Armiku.

E gjithë filozofia e Ferrit mbështetet te pranimi i aksiomës për të ndarë gjërat e ndryshme nga njëra-tjetra dhe, mbi të gjitha, për të ndarë njerëzit nga njëri-tjetri, për të mos i përzier. E mira ime është e imja, kurse e mira jote është e jotja. Ajo që fiton njëri, e humbet tjetri. Edhe një objekt jofrymor është ai që është, për shkak se i përjashton të gjitha objektet e tjera në hapësirën që zë; nëse zgjerohet njëri objekt, këtë gjë e bën duke i mënjeluar objektet e tjera, ose duke i thithur në vetvete. Edhe shpirti bën të njëjtën gjë. Për kafshët, thithja merr formën e të ngrënit; për ne, kjo do të thotë të thithim vullnetin dhe lirinë e një shpirti më të dobët për një më të fortë. “Të jesh” *do të thotë* “të jesh në konkurrencë”.

Tani, filozofia e Armikut është, as më shumë, as më pak, por një përpjekje e vazhdueshme për ta shmangur këtë të vërtetë të qartë. Ai synon kontradiktën. Gjërat duhet të jenë të veçuara, e megjithatë, në njëfarë mënyre, të jenë një. E mira për një person duhet të jetë edhe e mira e tjetrit. Dhe këtë gjë të pamundur, Ai e quan *dashuri*;

monotonia e këtij ilaçi mrekullibërës mund të shihet tek gjithçka që Ai bën, madje në gjithçka që Ai është – ose pretendon se është. Kështu, Ai nuk është i kënaqur, as të jetë Vetë thjesht një unitet aritmetik; Ai pretendon se është tre, por edhe një, me qëllim që gjithë kjo marrëzi për Dashurinë të mund të gjejë bazë edhe në vetë natyrën e Tij. Nga ana tjetër, Ai ka bërë edhe atë shpikje të turpshme të organizmit, ku pjesët nuk janë në rivalitet me njëra-tjetrën, por janë krijuar për të bashkëpunuar.

Motivi i Tij i vërtetë për krijimin e seksit si metodë e riprodhimit mes njerëzve duket mjaft qartë nga qëllimi se përse e përdor. Seksi, nga pikëpamja jonë, mund të kishte qenë tepër i pafajshëm. Mund të kishte qenë thjesht një mënyrë tjetër me të cilën një qenie më e fortë do ta kapte pre më të dobëtën – siç ndodh, në fakt, me merimangat, ku nusja e përfundon natën e parë të martesës duke e ngrënë dhëndrin. Por te njerëzit, Armiku e ka shoqëruar bujarisht dëshirën seksuale me dashurinë midis palëve. Gjithashtu, Ai ka bërë që të pjellët e tyre të jenë të varur nga prindërit dhe u ka dhënë prindërve impulsin për t'i mbështetur ata – duke prodhuar në këtë mënyrë Familjen, e cila është si organizmi, por shumë më e

keqe; sepse anëtarët e saj janë të ndryshëm, e megjithatë janë të bashkuar në një mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme. Në fakt, e gjitha kjo në fund të fundit duket se është thjesht një mënyrë tjetër për të futur në lojë Dashurinë.

Por ka edhe diçka krejt qesharake këtu. Armiku e përshkroi çiftin e martuar si “një mish i vetëm”. Ai nuk tha “një çift i lumtur të martuarish” ose “një çift që u martuan sepse kishin rënë në dashuri”, por ti mund t’i bësh njerëzit që ta anashkalojnë këtë fakt. Mund t’i bësh edhe që ta harrojnë se ai burri që quhet Pal nuk e kufizoi këtë përshkrim vetëm për çiftet *e martuara*. Për Palin, thjesht çiftëzimi bën që dy njerëz të bëhen ‘një mish i vetëm’. Kështu, mund t’i bësh njerëzit t’i pranojnë si eulogji retorike të ‘të qenit të dashuruar’ ato që, në fakt, janë përshkrime të domethënies reale të marrëdhënies seksuale. E vërteta është se nëse një burrë fle me një grua, u pëlqen apo jo atyre, atje vendoset një marrëdhënie e përtejme, e cila duhet të shijohet përjetësisht, ose të durohet përjetësisht. Nga pohimi i vërtetë se kjo lidhje përfshirëse është krijuar për të prodhuar dhe, nëse hyhet në të me bindje, do të prodhojë *patjetër* dashuri dhe

familje, mund t'i shtyjme njerëzit të krijojnë besimin e rremë se kjo përzierje afrimiteti, frike dhe dëshire, që ata e quajnë “të rënit në dashuri”, është e vetmja gjë që e bën martesën të lumtur ose të shenjtë. Gabimi lind lehtësisht pasi, “të rënit në dashuri” shpesh, në Europën Perëndimore, u paraprin martesave, të cilat bëhen në bindje ndaj planeve të Armikut, domethënë, me qëllimin e besnikërisë, pjellorisë dhe vullnetit të mirë; ashtu si emocionet fetare, të cilat mjaft shpesh, por jo gjithmonë, e shoqërojnë kthimin në besim. Me fjalë të tjera, njerëzit duhen inkurajuar ta konsiderojnë si kusht për martesën një version tepër të sheqerosur dhe të shtrembëruar të asaj që Armiku e premtoi në fakt si rezultat. Nga kjo kemi dy avantazhe. Së pari, njerëzit që nuk e kanë dhuntinë e vetëkontrollit mund t'i bëjmë që të mos e shikojnë martesën si zgjidhje të mirë, pasi nuk e konsiderojnë veten se kanë ‘rënë në dashuri’ dhe, falë nesh, ideja e martesës për çdo lloj motivi tjetër, atyre u duket e ulët dhe cinike. Po, kështu mendojnë. Ata e konsiderojnë qëllimin e besnikërisë në një lidhje martesore për ndihmë reciproke, për ruajtjen e dëlirësisë dhe për transmetimin e jetës, si diçka më të ulët se një furtunë emocionesh.

(Mos harro ta bësh pacientin që ta mendojë shërbesën e martesës si tepër fyese). Së dyti, çfarëdolloj tërheqjeje seksuale, për aq kohë sa synon të shkojë drejt martesës, do të konsiderohet si “dashuri” dhe “dashuria” do të mbahet si justifikim për ta shfajësuar njeriun nga i gjithë faji, si dhe do ta mbrojë nga të gjitha llojet e pasojave e të martuarit me një pagane, një mendjelehtë apo një të përdalë. Por, më tepër në lidhje me këtë, do të shkruaj në letrën tjetër.

Xhaxhai yt i dashur,

HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

E kam vrarë shumë mendjen për pyetjen që më ke bërë në letrën e fundit. Tani, siç ta kam treguar qartë, të gjitha qeniet janë në konkurrencë nga vetë natyra e tyre dhe ideja që ka Armiku për Dashurinë është një kontradiktë në terma. Atëherë, a e ke marrë ti parasysh paralajmërimin tim të përsëritur se Ai e do vërtet krimbin njerëzor dhe se vërtet dëshiron që ai të jetë i lirë dhe të vazhdojë të ekzistojë? Shpresoj fort, djalosh i dashur, që të mos ia kesh treguar ndokujt tjetër letrat e mia. Jo se kushedi çfarëdo të ndodhë, në fund të fundit, aq më bën. Çdokush do ta kuptonte se herezia në dukje në të cilën kam rënë në këto letra, është thjesht aksidentale. Meqë ra fjala, shpresoj gjithashtu se e ke kuptuar se disa nga referencat në dukje negative për Gojëlëmshin ishin thjesht shaka. Në fakt, unë kam shumë respekt për të. Dhe, sigurisht, edhe kur të kam

thënë ndonjëherë se nuk do të të mbroj nga autoritetet, nuk e kam pasur seriozisht. Mund të jesh i sigurt se do të kujdesem gjithmonë për ty e nuk do të lë në baltë. Por të gjitha këto duhet t'i mbash për vete, të mbyllura me kyç.

E vërteta është se, nga pakujdesia, shkava duke thënë se Armiku i do vërtet njerëzit. Patjetër që kjo është diçka e pamundur. Ai është një qenie më vete, njerëzit janë të veçuar prej Tij. E mira e tyre nuk mund të jetë edhe e mira e Tij. Gjithçka që thotë Ai për Dashurinë duhet të jetë maskë për ndonjë gjë tjetër – Ai duhet të ketë ndonjë motiv *real* për të cilin i krijoi dhe prandaj merret kaq shumë me ta. Arsyeja pse ndonjëherë flasim sikur Ai e ka vërtet këtë Dashuri të pamundur, vjen nga dështimi ynë i plotë për të gjetur motivin e vërtetë. Çfarë kërkon të bëjë ai me ta? Kjo është një pyetje të cilës nuk ia kemi gjetur ende përgjigjen. Nuk më duket gabim të të tregoj se pikërisht ky problem ka qenë një nga shkaqet kryesore të grindjes së Atit tonë me Armikun. Kur u diskutua për herë të parë krijimi i njeriut dhe, që në atë fazë, Armiku rrëfeu hapur se parashikonte njëfarë episodi që kishte të bënte me një kryq, Ati ynë, natyrshëm, kërkoi të bënte një

bisedë me Të dhe donte të kishte shpjegime. Armiku nuk i dha asnjë përgjigje tjetër veç gënjeshtërs foshnjarake se kishte një dashuri pa interes për njerëzit, e cila vazhdon të qarkullojë edhe sot. Natyrisht, këtë Ati ynë nuk mund ta pranonte dot. Ai iu lut Armikut t'i hapte të gjitha kartat, duke i vënë përpara çdo lloj mundësie. E pranoi se ndiente një ankth të vërtetë që ta merrte vesh sekretin; Armiku iu përgjigj: “Me gjithë zemër, do të doja shumë që ta kuptojë vërtetë”. Mendoj se ky ishte momenti i bisedës kur neveria që ndjeu Ati ynë nga kjo mungesë besimi e pa bazuar, e bëri që të tërhiqej në një distancë të pafundme nga Prania me një shpejtësi aq të madhe, sa që kjo u bë shkas për krijimin e historisë qesharake të Armikut se gjoja Ai e dëboi me forcë nga Qielli. Qysh atëherë, ne kemi filluar ta kuptojmë se përse Shtypësi ynë ishte kaq i fshehtë. Froni i Tij varet nga ky sekret. Anëtarët e palës së tij kanë supozuar shpesh se nëse ne do ta kuptonim vërtetë se çfarë Ai nënkupton me dashurinë, atëherë lufta do të merrte fund dhe ne do të mund të hynim sërish në Qiell. Dhe pikërisht kjo është detyra jonë e madhe. Ne e dimë se Ai nuk mund të dashurojë vërtetë: askush nuk mund ta bëjë këtë: nuk ka kuptim. Sikur të mundnim ta

gjenim se ku qëndron *në të vërtetë* qëllimi i Tij! Kemi provuar hipoteza nga më të ndryshmet, por ende nuk e kemi gjetur. Megjithatë, nuk duhet ta humbasim kurrë shpresën; teori gjithmonë e më të ndërlikuara, plotësim mbledhjesh të dhënash, shpërblime më të majme për kërkues që bëjnë përparime në këtë drejtim, ndëshkime gjithmonë e më të tmerrshme për ata që dështojnë – e gjitha kjo, nëse i vihemi pas dhe me shpejtësi deri në fund të kohës, sigurisht që nuk ka për të dështuar.

Ti ankohesh se letra ime e fundit nuk e bën të qartë nëse e konsideroj *të rënit në dashuri* si gjendje të dëshirueshme për një njeri apo jo. Por seriozisht, Krimbaq, kjo pyetje u takon *atyre* ta bëjnë! Lëri të diskutojnë nëse “Dashuria”, apo patriotizmi, apo beqaria, apo qirinjtë në altarë, apo monizmi, apo arsimi, janë “të mira” ose “të këqija”. Nuk e kupton që nuk ka përgjigje për këto? Ajo që ka rëndësi është prirja drejt një gjendjeje të caktuar mendore, në rrethana të caktuara, për ta shtyrë një pacient më pranë Armikut, apo më pranë nesh. Kështu, do të ishte një gjë vërtet e mirë ta bënim pacientin të vendoste nëse “Dashuria” është diçka “e mirë”, apo “e keqe”. Nëse është njeri arrogant që e përçmon trupin, bazuar

në fakt te shijet, por që gabimisht këtë e merr për pastërti – që i pëlqen të kundërshtojë atë që besojnë shumica e qenieve si ai – atëherë, patjetër, le ta shtyjme të vendosë se Dashuria është e keqe. Nxit brenda tij një asketizëm të plotë dhe pastaj, kur ta kesh ndarë seksualitetin e tij nga gjithçka që mund ta bënte sërish human, shtyje më tej duke i dhënë një formë shumë më cinike dhe brutale. Nëse, nga ana tjetër, ai është njeri emocional dhe i lehtë për t’u mashtruar, ushqeje me poetë të parëndësishëm dhe me romancierë të dorës së pestë të shkollës së vjetër, derisa ta bësh të besojë se “Dashuria” është njëherësh edhe e parezistueshme, edhe e merituar. Ky besim, e pranoj, nuk të ndihmon për të prodhuar papastërti të çastit; por është një recetë e pakrahasueshme për të krijuar kurorëshkelje tragjike, të zgjatura, “fisnike” dhe romantike të cilat përfundojnë, nëse gjithçka shkon mirë, në vrasje dhe vetëvrasje. Nëse kjo dështon, sërish mund të përdoret për ta drejtuar pacientin drejt një martese të dobishme. Sepse martesa, ndonëse shpikje e Armikut, ka dobite e veta për ne. Në lagjen e pacientit tënd duhet të ketë shumë vajza të reja që do t’ia bënin tepër të vështirë të jetuarit si i krishterë nëse do të arrije ta bindje që të

martohej me njërën prej tyre. Të lutem më dërgo një raport mbi këtë çështje kur të më shkruash herën tjetër. Ndërkohë, duhet ta kesh të qartë në mendje se kjo gjendje e të rënit në dashuri, nuk është me patjetër e favorshme për ne, apo për palën tjetër. Ajo është thjesht një rast të cilin po përpiqemi ta shfrytëzojmë si ne, ashtu dhe Armiku. Si shumica e gjërave të tjera për të cilat njerëzit emocionohen, siç janë shëndeti apo sëmundja, plakja apo rinia, lufta apo paqja, edhe ajo është, nga pikëpamja e jetës shpirtërore, thjesht lëndë e parë.

Khaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Po vërej me pakënaqësi të madhe se, për momentin, Armiku u ka dhënë një goditje të fortë sulmeve të tua direkte mbi dëlirësinë e pacientit. Duhet ta kishe ditur se Ai gjithnjë vepron kështu në fund dhe duhet ta kishe ndaluar përpara se të vinte kjo fazë. Sepse, kështu si erdhën punët, pacienti yt tani ka zbuluar të vërtetën e rrezikshme se këto sulme nuk do të zgjasin përjetë. Si pasojë, nuk mund ta përdorësh sërish atë që, në fund, është arma jonë më e mirë: besimi i njerëzve të paditur se ne nuk do i lëmë rehat, nëse nuk na binden. A kam të drejtë të besoj se edhe ti je përpjekur ta bindësh se dëlirësia është diçka e pashëndetshme?

Ende nuk ma ke dërguar raportin në lidhje me vajzat e reja në lagjen e tij. Pres të ma dërgosh menjëherë, pasi nëse nuk mund ta përdorim seksualitetin e tij për ta bërë të papastër, duhet të përpiqemi ta përdorim për t'i bërë

reklamë një martesë të leverdisshme. Ndërkohë, dua të të jap disa sugjerime për tipin e gruas – e kam fjalën për anën fizike të saj – që duhet ta inkurajosh pacientin të dashurojë, nëse ‘të rënit në dashuri’ na shërben për të arritur diçka.

Sigurisht, në përgjithësi kësaj pyetjeje i është dhënë përgjigja nga shpirtra që ndodhen shumë më poshtë në shkallët e Ferrit sesa unë dhe ti. Këta mjeshtrë të mëdhenj e kanë për detyrë në çdo epokë të prodhojnë një çorientim të përgjithshëm të të ashtuquajturës “shije” seksuale. Këtë e bëjnë duke punuar me një rreth të vogël artistësh, stilistësh, aktorësh dhe reklamuesish të njohur të cilët përcaktojnë tipin në modë. Qëllimi është që ta largojmë secilin prej sekseve nga anëtarët e seksit tjetër me të cilët mund të krijojnë martesë shpirtërisht të dobishme, të lumtura dhe pjellore. Kështu, ne kemi triumfuar mbi natyrën për shekuj me radhë deri në atë pikë sa që kemi bërë që disa karakteristika dytësore të mashkullit (si p.sh., mjekra), të jenë të papranueshme për pothuajse të gjitha femrat – dhe këtu ka shumë më tepër material për ne sesa mund ta marrësh me mend. Përsa i përket shijes së mashkullit, taktikat kanë qenë nga më të ndryshmet. Kohë më

parë e drejtuam drejt tipit aristokrat, gra të ngjashme me statuja bukurie, duke vënë kështu në kontradiktë krenarinë e kotë të meshkujve me dëshirat e tyre. Në këtë mënyrë bëme që raca njerëzore të shumohej kryesisht përmes femrave tepër arrogante dhe pa asnjë vlerë. Më pas, ne zgjodhëm një tip femëror të ekzagjeruar, të dobët dhe të përlur, në mënyrë të tillë që marrëzia dhe burracakëria mashkullore, me gjithë falsitetin e përgjithshëm dhe mendjelehtësinë që i shoqërojnë, të mos binin në sy. Për momentin, kemi zgjedhur një rrugë plotësisht të kundërt. Epoka e xhazit ka pasuar epokën e valsit, dhe tani i nxitim burrat të pëlqejnë gra me trup pothuajse të njëjtë me atë të djemve. Meqë bukuria fizike është një lloj më kalimtar krahasuar me shumicën e bukurive të tjera, duke vepruar në mënyra të ndryshme, ne e acarojmë tmerrin kronik të femrës që po plaket (me shumë rezultate të shkëlqyera) dhe e bëjmë më pak të gatshme dhe më pak të aftë të rritë fëmijë. Dhe nuk mbaron këtu. Ne kemi projektuar një rritje të lartë të legjitimitetit me qëllim që shoqëria të lejojë të përfaqësohet ajo që duket gati lakuriq (jo lakuriqësinë e vërtetë) me anë të artit dhe një shfaqje të saj në skenë ose në plazh. Kuptohet, e gjitha kjo është diçka e rreme;

figurat e artit modern janë të rreme; gratë e vërteta me rroba plazhi ose të brendshme, faktikisht nxiten të shfaqen në mënyrë të tillë që të duken më të forta, më elegante dhe më djaloshare sesa ia lejon natyra një gruaje në moshë të rritur. Madje tashmë, bota moderne ka rënë në kurthin e të besuarit se po tregohet “e sinqertë” dhe “e shëndetshme” dhe se po i kthehet natyrës. Si rezultat, ne po i drejtojmë dëshirat e meshkujve gjithmonë e më tepër te diçka që nuk ekziston – duke e bërë rolin e syrit gjithnjë e më ndikues për sa i përket seksualitetit dhe në të njëjtën kohë duke i bërë kërkesat e tij gjithnjë e më të pamundura. Pasojat mund t’i parashikosh lehtë!

Për momentin kjo është strategjia në vija të trasha. Por brenda këtij kuadri, ke për ta parë se është e mundur t’i drejtosh dëshirat e pacientit tënd në njërin prej dy drejtimeve. Do të shohësh, nëse e shqyrton me kujdes zemrën e çdo burri, se ai është i përndjekur nga të paktën dy gra imagjinare – njëra është Afërdita tokësore dhe tjetra Afërdita e ferrit, dhe se dëshira e tij ndryshon në cilësi në varësi të objektit. Dëshira e tij për njërin prej llojeve të grave është natyrshëm e pëlqyeshme për Armikun – ajo përzihet lehtësisht me afrimitetin, gati për

t'u bindur për martesë, e ngjyrosur në çdo anë me dritën e artë të nderimit dhe natyrshmërisë që ne e urrejmë kaq shumë; ka edhe një lloj tjetër, të cilin ai e dëshiron në mënyrë brutale, madje ai do ta dëshirojë në mënyrë brutale. Ky lloj mund të përdoret më së miri për ta larguar fare nga martesa, por edhe nëse shkon drejt martesës, ai do ta trajtonte si një skllave, një idhull ose një bashkautore në krim. Dashuria e tij për llojin e parë mund edhe të përfshijë ndonjë gjë që Armiku e quan të keqe, por kjo mund të ndodhë vetëm rastësisht; mashkulli do të donte që ajo të mos ishte gruaja e dikujt tjetër dhe mund t'i vijë keq që nuk mund ta dojë në mënyrë të ligjshme. Por me llojin e dytë, lëkura i bëhet shajak dhe ai kërkon pikërisht ligësinë e dukshme; është pikërisht shija e saj 'pikante' që ai kërkon me ngulm. Në fytyrën e saj, është kafshëria e dukshme, apo marrëzia, dinakëria, apo mizoria që atij i pëlqen dhe, në trup, diçka mjaft e ndryshme nga ajo që ai e quan zakonisht Bukuri, diçka që ai mund ta quajë madje shëmti në momentet kur është esëll, por që, përmes artit tonë, mund të bëjmë që t'ia prekë edhe nervin më të dobët të fiksimit të tij të fshehtë.

Dobia e vërtetë e Afërditës së Ferrit pa dyshim ndihet

kur përdoret si prostitutë ose dashnore. Por, nëse pacienti yt është i krishterë, dhe nëse është trajnuar në mënyrë të tillë që të mos besojë budallallëqet e pakuptimta si ‘Dashuria’ e parezistueshme dhe që fal gjithçka, ndoshta mund të nxitet të martohet me të. Dhe kjo ka shumë leverdi për ne nëse realizohet. Do të kishe dështuar përse i përket kurvërisë ose mëkateve të kryera vetëm; por ka metoda të tjera, më të tërthorta, për ta përdorur seksualitetin e njeriut në dëm të tij. Dhe ato, meqë ra fjala, nuk janë vetëm të frytshme, por edhe argëtuese; mungesa e lumturisë që shkaktojnë është e një lloji që zgjat dhe shijon shumë.

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Po, periudhat e tundimit seksual janë një kohë e shkëlqyer për të filluar një sulm të dorë së dytë duke shkaktuar acarimin e pacientit. Madje ky mund të jetë dhe sulmi kryesor, mjaft që ai vetë ta mendojë si jo shumë të rëndësishëm. Por këtu, si dhe në gjithçka tjetër, duhet ta përgatitësh rrugën për sulmin moral duke ia errësuar intelektin.

Burrat nuk zemërohen thjesht nga fatkeqësitë, por atëherë kur fatkeqësia konsiderohet si lëndim. Dhe ndjenja e lëndimit vjen nga bindja se një pretendim legjitim u është mohuar. Prandaj, sa më tepër pretendime për jetën të ngrejë pacienti yt, aq më shpesh do të ndihet i lënduar dhe, si rezultat, do të jetë shpesh i acaruar. Tani, do ta kesh vënë re se asgjë nuk e acaron më tepër atë sesa kur mendon se është privuar papritur nga një pjesë kohe të cilën mendonte se e kishte në dispozicion të tij. Një

vizitor i papritur (atëherë kur priste të kishte një mbrëmje të qetë), ose gruaja llafazane e ndonjë miku (që vjen në shtëpi kur ai priste të kishte një takim *kokë më kokë* me mikun e tij) e bëjnë të dalë nga binarët. Nuk është për shkak se ai është i pasjellshëm, apo përtac që këto gjëra të vogla i duken *në vetvete* të tepërta. Ato e acarojnë ngaqë pacienti yt e konsideron kohën si të tijën dhe ndihet se po i vidhet. Prandaj, puno fort që t’ia ngulitësh mirë në mendje idenë e çuditshme: “Koha ime më përket mua”. Le të mendojë se çdo ditë fillon duke qenë ai zotërues i ligjshëm i njëzet e katër orëve. Le ta konsiderojë si taksë të rëndë atë pjesë nga prona e tij që i duhet t’ua japë punëdhënësve dhe si dhuratë bujare atë pjesë që ua lë detyrave fetare. Por, duhet ta mbash vazhdimisht duke menduar në mënyrë të gabuar se, e gjithë shuma e kohës prej të cilës bëhen të gjitha këto zbritje, në njëfarë kuptimi misterioz, janë e drejta e tij personale që prej lindjes.

Këtu i vjen radha një detyre shumë delikate. Ideja që duhet ta nxitësh të ketë vazhdimisht është kaq absurde saqë, nëse shtrohet njëherë një pyetje mbi të, as ne nuk do të jemi në gjendje të gjejmë qoftë edhe një argument për ta mbrojtur. Njeriu nuk mund as të krijojë, as të

mbajë për vete as edhe një moment të kohës; gjithçka i vjen si dhuratë; përndryshe, i bie që edhe diellin dhe hënën t’i konsideronte si të tijat. Gjithashtu, teorikisht, ai është përkushtuar në shërbim të plotë ndaj Armikut. Nëse Armiku do t’i shfaqej me trup njerëzor dhe do t’i kërkonte shërbim njëzetekatërorësh për një ditë të vetme, ai nuk do ta refuzonte. Pacienti yt do të ndihej shumë i lehtësuar sikur atë ditë t’i duhej të duronte pikërisht fjalët e ndonjë gruaje budallaqe; dhe do të ndihej i parëndësishëm, madje do të zhgënjehej sikur për gjysmë ore gjatë asaj dite Armiku t’i thoshte “Tani mund të shkosh dhe të argëtohesh”. Në fakt, nëse ai do i kushtonte vëmendje idesë së vet për një çast, ai do të ishte i detyruar ta pranonte se, në këtë lloj situatë gjendet çdo ditë. Prandaj, kur të kërkoj që t’ia ngulitësh këtë ide në mendje, nuk e kam aspak fjalën që ta furnizosh me argumente në mbrojtje të saj. Nuk ka argumente. Detyra jote është thjesht negative. Mos e lër t’i afrohet aspak reflektimit mbi këtë ide. Rrethoje me errësirë dhe, në qendër të kësaj errësire, bëj që ndjesia se Koha është pronë e tij, të mbetet në heshtje, pa u vënë re, por në veprim.

Ndjesia e pronësisë duhet inkurajuar në përgjithësi

gjithmonë. Njerëzit ngrenë gjithmonë pretendime për pronësi të ndryshme, gjë që tingëllon po aq qesharake në Qiell sa edhe në Ferr dhe neve na duhet të vazhdojmë t'i nxitim që të veprojnë kështu. Një pjesë e madhe e rezistencës moderne kundër dëlirësisë vjen nga besimi i njerëzve se trupi është “pronë e tyre” – një pronë e madhe dhe e rrezikshme, që pulson nga energjia që krijoi botët, trupi në të cilin e gjejnë veten pa dëshirën e tyre dhe prej të cilit dalin sipas planit të një Tjetri! Është njësoj sikur fëmija i mbretit, të cilin i ati e vendos në krye të një province të madhe për hir të dashurisë që ka, duke lënë në drejtim disa këshilltarë të urtë, të fillojë të mendojë se qytetet janë pronë e tij bashkë me pyjet, grurin, ashtu siç janë të tijat tullat në murin e kuzhinës dhe mund të bëjë me to çfarë të dojë.

Këtë ndjesi pronësie ne e prodhojmë jo vetëm nëpërmjet krenarisë, por edhe nëpërmjet konfuzionit. Ne i mësojmë që të mos i vënë re domethëniet e ndryshme të përemrit pronor – ndryshimet e shkallëzuara në mënyrë të sofistikuar, që fillojnë me ‘këpucët e mia’ dhe pastaj vazhdojnë me ‘qeni im’, ‘shërbëtori im’, ‘gruaja ime’, ‘im atë’, ‘zotëria im’ dhe ‘vendi im’, deri te ‘Perëndia im’. Ne

mund t'i mësojmë njerëzit që të gjitha këto domethënie t'i reduktojnë te nocioni “këpucët e mia”, pra tek “imja” e pronësisë. Që në çerdhe mund ta mësosh fëmijën që me fjalën “arushi im prej pelushi” të *mos* nënkuptojë objektin e tij të dashur me të cilin ai ka një marrëdhënie të veçantë (sepse, nëse nuk jemi të kujdesshëm, kështu do t'ia mësojë Armiku), por të nënkuptojë “ariun që mund ta bëj copash po të dua”. Dhe nga ana tjetër, ne i kemi mësuar njerëzit të thonë “Zoti im” me një ndjesi jo aq të ndryshme nga termi “këpucët e mia”, që do të thotë “Perëndia që pretendoj se është i imi për shkak se i kam shërbyer në mënyrë të shkëlqyer dhe të cilin e thërras nga foltorja e kishës – Perëndia të cilin e kam nën kontroll”.

Dhe në gjithë këtë histori, ajo që të bën të shkrihesh së qeshuri me ta është se në të vërtetë fjala “e Imja” në kuptimin e saj plotësisht pronor nuk mund të shprehet nga qenia njerëzore në lidhje me asnjë gjë. Në fund, vetëm Ati ynë ose Armiku do të thonë ‘e Imja’ për çdo gjë që ekziston, dhe në mënyrë të veçantë për çdo njeri. Mos u shqetëso, në fund ata kanë për ta kuptuar medoemos se kujt i përket vërtet koha, shpirti dhe trupi i tyre –

nuk u përkasin *aspak* atyre, çfarëdo që të ndodhë. Për momentin, Armiku thotë ‘e Imja’ për gjithçka, vetëm me argumentin pedant dhe legalist se ishte Ai që e krijoi. Ati ynë shpreson që në fund të thotë ‘e Imja’ për të gjitha gjërat nga një arsye më realiste dhe më dinamike: pushtimi.

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Domethënë, njeriu yt paska rënë në dashuri – dhe në llojin më të keq të mundshëm – me një vajzë e cila as përmendet në raportin që më ke dërguar. Meqë ra fjala, mund të të interesojë ta dish se e sqarova atë keqkuptimin e vogël me Policinë Sekrete, të cilin ti u mundove ta bëje tërkuzë në lidhje me disa shprehje të miat, që i thashë pa kujdes, në një nga letrat e mia. Nëse prisje që me këtë gjë të më zije vendin në zyrën time të mirë, do ta marrësh vesh që të ka gënjyer mendja. Do të paguash për këtë, si dhe për gafat e tjera që ke bërë. Ndërkohë, po të dërgoj bashkë me letrën edhe një libërth të vogël, të botuar së fundmi, mbi Institutin e ri të Riedukimit për Tunduesit e Paaftë. Ai është i ilustruar mirë dhe është aq i nevojshëm për ty sa nuk do ta lëshosh dot nga dora.

E lexova dosjen e vajzës në fjalë dhe u tmerrova nga ajo që pashë. Jo thjesht e krishterë, por çfarë e krishtere –

një zonjushë e pështirë, tinëzare, e buzëqeshur, modeste, fjalëpakë, miushe, e butë, e parëndësishme, e virgjër dhe tepër e zakonshme. Qelbësira e vogël! Më vjen për të vjellë. Ajo vjen erë dhe më përvëlojnë sytë që nga faqet e dosjes që lexova. Më vjen të pëlças kur shoh sa është prishur kjo botë. Nëse kjo do të kishte ndodhur vite më parë, do ta kishim dërguar në arenë këtë vajzë. Se për këtë punë janë soji i saj. Se mos do arrinte ndonjë gjë të madhe edhe aty! Ajo është një mashtruese me shumë fytyra (ia njoh mirë unë sojin), që duket sikur do t'i bjerë të fikët sapo të shohë gjak, dhe pastaj vdes nga të qeshurat. Mashtruese në çdo drejtim. Duket sikur nuk është në gjendje as të vrasë një mizë, por nga ana tjetër gjuhën e ka shpatë. Kësaj krijese edhe *unë* do i dukesh qesharak! Një puritane e ndyrë dhe pa shije – dhe prapë gati t'i hidhej në krahë këtij torollaku si të gjitha llojet e tjera të kafshëve që çiftohen. Pse nuk e mallkon Armiku për këtë gjë, nëse e ka kaq për zemër virgjërinë – po rri atje pa bërë asgjë, duke u zgërdhirë?

Në thellësi të zemrës së Tij, Ai është i dhënë pas kënaqësive. Të gjitha agjërimet, vigjiljet, turrat e druve, apo kryqet janë vetëm fasada. Ose janë si shkuma në breg

të detit. Brenda në det, në detin e Tij, ka kënaqësi pas kënaqësish. Madje, Ai nuk e fsheh këtë gjë; në dorën e Tij të djathtë ka “kënaqësi përjetë”. Ma shpif! Unë besoj se Ai nuk ka as idenë më të vogël për atë mister të lartë dhe të ashpër mbi të cilin ne ngremë Vizionin e Mjeranit. Ai është vulgar, Krimbaq. Ka një mendje prej borgjezi. E ka mbushur botën e Tij plot me kënaqësi. Ka gjëra që njerëzit mund t’i bëjnë gjithë ditën pa ndikuar Ai – të paktën gjumin, të larit, të ngrënit, të pirit, të bërit dashuri, lojën, lutjen, punën. Kurse neve na duhet që gjithçka ta *shtrembërojmë* që të na vlejë për ndonjë gjë. Lufta jonë është e pabarabartë dhe e pamëshirshme. Asgjë nuk ndodh natyrshëm në krahun tonë. (Jo se kjo të justifikon ty. Edhe me ty do merrem së shpejti. Ti më ke urryer gjithmonë dhe ke hedhur baltë mbi mua sa herë të është dhënë mundësia.)

Pastaj, sigurisht që ai njihet me familjen dhe mbarë rrethin shoqëror të kësaj vajze. Si nuk e kuptove se në shtëpinë ku jeton ajo, ai nuk duhej lënë kurrë, as të shkelte? I gjithë ambienti atje qelbet nga një erë vdekjeprurëse. Madje edhe kopshtari, ndonëse ka vetëm pesë vite që jeton atje, po fillon të infektohet prej tyre. Edhe qeni dhe macja janë njollosur. Dhe shtëpia vetë është

e mbushur me një mister të padepërtueshëm. Ne jemi të sigurt (si dy dhe dy që bëjnë katër) se secili anëtar i asaj familjeje po përfiton me patjetër disi prej anëtarëve të tjerë – por nuk e kemi kuptuar ende si. Ata e ruajnë me po aq xhelozsi sa dhe Armiku sekretin e asaj që gjendet pas këtij pretendimi të rremë për dashuri pa interes. E gjithë shtëpia dhe kopshti janë thjesht një papastërti e madhe. Ajo i ngjan në mënyrë të pështirë përshkrimit që një shkrimtar njerëzor i bëri Qiellit: “Fusha ku ka vetëm jetë, prandaj ka vetëm muzikë dhe heshtje”.

Muzikë dhe heshtje – sa i urrej të dyja këto! Sa mirë-njohës duhet të jemi që, nga çasti kur Ati ynë hyri në Ferr – ndonëse aq kohë më parë sa njerëzit nuk mund ta shprehin edhe me vite drite – asnjë centimetër katror i hapësirës së ferrit dhe asnjë çast i kohës në ferr nuk i është dorëzuar këtyre dy forcave të neveritshme, por gjithçka mbytet nga Zhurma – Zhurma, dinamizmi i madh, shprehja me zë të lartë e asaj që është ngazëllyese, e pamëshirshme, dhe e fuqishme – Zhurma, e cila është e vetmja që na mbron nga brejtjet e kota të ndërjegjes, nga skrupujt dëshpërues dhe nga dëshirat e parealizueshme. Në fund do ta mbushim të gjithë universin me zhurmë. Kemi bërë tashmë shumë

hapa gjigantë në këtë drejtim përsa i përket Tokës. Meloditë dhe heshtja e Qiellit, në fund, do të mposhten nga zhurma jonë. Por, e pranoj se nuk jemi ende aq të zhurmshëm sa duhet, madje jemi akoma shumë larg. Puna kërkimore po vazhdon. Sa për *ty*, more qelbësirë e ndyrë...

*[Këtu dorëshkrimi ndërpritet
dhe vazhdohet nga një dorë tjetër.]*

Në zjarrin e hartimit të letrës pashë se, pa dashur, e lejova veten të merrja formën e një shumëkëmbëshi gjigant. Për këtë arsye, pjesën tjetër të letrës po ia diktoj sekretarit tim. Tani që jam shndërruar plotësisht, e kuptoj se ky është fenomen periodik. Disa thashetheme për këtë gjë u kanë arritur edhe njerëzve në vesh, madje poeti i tyre, Miltoni, paraqet edhe një rrëfim të shtrembëruar të këtij fenomeni, bashkë me mendimin qesharak se këto ndryshime në formë janë një “ndëshkim” që na është imponuar nga Armiku. Por, të vërtetën e ka kapur një shkrimtar më modern — njëfarë Bosh-i¹, a diçka e tillë.

¹ Pshaw: Autori ironizon me emrin e poetit irlandez Bernard Shaw, (Pshaw = mosbesim.)
(Shënim i redaktorit)

Shndërrimi fillon nga brenda dhe është një manifestim i lavdishëm i asaj Force Jetësore të cilën do ta adhuronte edhe Ati ynë, nëse do të bënte vaki të adhuronte diçka tjetër veç Vetes. Në pozitën që kam tani dua me patjetër të takohem me ty, që të bashkohem me ty në një përqafim të pandashëm.

(firmosi) BISHTSERVILI

Për Ultësinë e tij Sublime, Nënsekretarin Hirzi, TE, BS, etj.

I dashuri im Krimbaq,

Falë kësaj vajze dhe familjes së saj të pështirë, pacienti tani po fillon të njihet me më tepër të krishterë çdo ditë, madje me të krishterë shumë inteligjentë. Për një kohë të gjatë do të jetë e pamundur ta *largosh* jetën e tij nga shpirtërorja. Por mund të bëjmë diçka tjetër; t'ia *korruptojmë* jetën. S'ka dyshim se edhe ti vetë je shndërruar në engjëll drite si në një paradë tokësore. Tani është koha ta bësh përsëri këtë përpara hundës së Armi-kut. Bota dhe Mishi nuk na vlejten për asgjë; mbetet dhe një Fuqi e tretë. Dhe suktesi i këtij lloji të tretë është më i lavdishmi nga të gjithë. Ferri kënaqet më tepër me një shenjtor të rënë, një farise, një inkuizitor, apo një magjistar, sesa thjesht me një tiran apo një të shthurur të zakonshëm.

Nga shqyrtimi që u bëra miqve të rinj të pacientit, vura re se pika më e mirë e sulmit është kufiri midis teologjisë dhe politikës. Disa prej miqve të tij të rinj janë

shumë të ndërgjegjshëm për ndikimet shoqërore të fesë së tyre. Në vetvete, kjo gjë është e keqe; por ne mund ta shfrytëzojmë për mirë.

Mund të gjesësh shumë shkrimtarë politikë të krishterë që mendojnë se krishtërimi filloi të ecë në drejtim të gabuar dhe se e braktisi doktrinën e Themeluesit të vet, që herët. Tani, këtë ide duhet ta përdorim për të inkurajuar sërish konceptin e një “Jezui historik” që mund të dalë në pah duke pastruar “shtesat dhe shtrembërimet” e mëvonshme dhe pastaj t’i kundërvihet gjithë traditës së krishterë. Tek brezi paraardhës, ne përkrahëm fuqimisht ndërtimin e një “Jezui historik” të tillë, mbi linja liberale dhe humaniste; ndërsa tani po paraqesim një “Jezu historik” të ri mbi linja marksiste, katastrofike dhe revolucionare. Avantazhet e këtyre lëvizjeve, të cilat synojmë t’i ndërrojmë çdo tridhjetë vjet afërsisht, janë të shumëfishta. Së pari, të gjitha prirën që t’ua orientojnë njerëzve përkushtimin drejt diçkaje që nuk ekziston, sepse asnjë “Jezu historik” nuk është aspak historik. Dokumentet janë ato që janë dhe nuk mund t’u shtohet gjë. Prandaj, çdo “Jezu historik” i ri, duhet të dalë prej tyre duke e fshehur të kuptuarit e tyre në një pikë dhe duke e ekzagjeruar në një tjetër. Ky lloj

hamendësimi (*brilant*, siç i mësojmë njerëzit ta quajnë), për të cilin askush nuk do të ofronte as dhjetë shilinga në jetën e zakonshme, është i mjaftueshëm për të prodhuar një sërë Napoleonësh të rinj, Shekspirësh të rinj dhe Suiftësh të rinj, në listën e çdo botuesi. Së dyti, të gjitha këto lloj lëvizjesh e vendosin rëndësinë e Jezuit historik të tyre në ndonjërin nga teoritë e veçanta që besohet se Ai i ka shpallur. Ai *duhet* të jetë një “njeri i madh” në kuptimin modern të fjalës – i cili qëndron pas ndonjë lloj të menduari centrifugal dhe të pabalancuar – një maniak që shet një ilaç që shëron çdo sëmundje. Në këtë mënyrë, ne ua largojmë njerëzve mendjen nga ajo që Ai është në të vërtetë dhe nga çfarë Ai bëri në të vërtetë. Fillimisht e quajmë thjesht mësues, pastaj fshehim çdo lloj lidhjeje tepër të rëndësishme mes mësimave të Tij dhe atyre të të gjithë mësuesve të mëdhenj të moralit. Sepse njerëzit nuk duhet lënë të kuptojnë se të gjithë moralistët e mëdhenj janë dërguar prej Armikut jo për t’i informuar ata, por për t’i kujtuar, për të ritheksuar faktet e lashta morale, të cilat ne përpiqemi t’i fshehim vazhdimisht. Ne krijojmë Sofistët: Ai ngre një Sokrat për t’u kundërpërgjigjur. Qëllimi ynë i tretë, përmes këtyre lëvizjeve, është që ta shkatërrojmë

jetën e devotshme. Kështu, praninë reale të Armikut, të përjetuar nga njerëzit që luten dhe u binden urdhërimeve, ne e zëvendësojmë me një figurë të mundshme, të largët, të errët, të fshehur dhe të vështirë për t'u kuptuar, i cili ka folur një gjuhë të çuditshme dhe ka vdekur shumë kohë më parë. Një objekt i tillë, në fakt, nuk mund të adhurohet. Në vend të Krijuesit që adhurohet prej krijesës së tij, shumë shpejt do të kesh thjesht një udhëheqës që lavdërohet nga ndjekësit dhe, përfundimisht, një personazh të veçantë që bëhet i njohur nga ndonjë historian i mençur. Dhe së katërti, përveç faktit që është johistorike për sa i përket Jezuit që përshkruan, feja e këtij lloji është e rreme nga pikëpamja historike edhe në një kuptim tjetër. Asnjë komb apo grup i madh individësh nuk kalon realisht në krahun e Armikut thjesht duke studiuar historinë e biografisë së Jezuit, vetëm si biografi. Në të vërtetë, materialet për një biografi të plotë të tij nuk u janë zbuluar njerëzve. Besimtarët e hershëm u kthyen në besim nga një fakt i vetëm historik (Ringjallja) dhe nga një doktrinë e vetme teologjike (Shpengimi), të cilat ndikuan mbi ndjeshmërinë për mëkatin që ata e kishin pasur që më parë – dhe ky mëkat nuk kishte të bënte me ndonjë kundërshti të ligjit

të ri të kohës së fundit nxjerrë nga ndonjë ‘njeri i madh’, por ishte kundër ligjit të vjetër, të pandryshueshëm, universal, moral të cilin e kishin mësuar nga nënat dhe kujdestaret që fëmijë. “Ungjijtë” erdhën më vonë dhe u shkruan, jo për të bërë të krishterë, por për t’i shenjtëruar të krishterët që tashmë ishin të tillë.

Prandaj “Jezui historik”, sado i rrezikshëm që duket se mund të jetë për ne në çaste të caktuara, duhet inkurajuar gjithmonë. Përsa i përket lidhjes mes krishtërimin dhe politikës në përgjithësi, pozicioni ynë është më delikat. Sigurisht, ne nuk duam që njerëzit ta lejojnë krishtërimin e tyre të mbushë edhe jetën e tyre politike, sepse themelimi i diçkaje që mund t’i ngjajë një shoqërie vërtet të drejtë, do të ishte një katastrofë për ne. Nga ana tjetër, ne duam me gjithë zemër t’i nxitim njerëzit ta trajtojnë krishtërimin si një mjet; sigurisht, nëse është e mundur, si mjet për përparimin e tyre vetjak, por, nëse nuk ia dalim dot në këtë formë, si mjet për të arritur çfarëdo qoftë – madje edhe drejtësi sociale. Gjëja e duhur është të bësh që njeriu, pikësëpari, të vlerësojë drejtësinë sociale si diçka që Armiku e kërkon, e pastaj ta çosh deri në fazën ku ta vlerësojë krishtërimin pikërisht për shkak se mund të prodhojë drejtësi sociale.

Sepse Armiku nuk dëshiron të përdoret si vegël. Njerëzit ose kombet që mendojnë se mund ta rigjallërojnë Besimin me qëllim që të krijojnë një shoqëri të mirë, janë si ai që mendon të përdorë shkallët e Qiellit si rrugën e shkurtër për te farmacia e lagjes. Fatmirësisht, është shumë e lehtë t'i joshësh njerëzit për t'i futur në një qorrsoak. Pikërisht sot hasa një pasazh të një shkrimtari të krishterë ku rekomandonte versionin e tij të krishtërit, bazuar mbi idenë se “vetëm një besim i tillë mund t'i mbijetojë vdekjes së kulturave të vjetra dhe lindjes së qytetërimeve të reja”. E shikon çarjen e vogël? “Besoje këtë, jo sepse është e vërtetë, por për një arsye tjetër”. Kjo është loja.

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Pas letërkëmbimit me Kokëteneqenë, i cili është përgjegjës për të dashurën e pacientit tënd, po filloj ta kuptoj se ku është pika e dobët në parzmoren e saj. Ka një ves të vogël të padukshëm që e kanë të përbashkët pothuajse të gjitha gratë e rritura në një rreth njerëzish inteligjentë, të bashkuar nga një besim i përcaktuar qartë. Ky ves konsiston në supozimin e shkujdesur se të jashtmit, që nuk e kanë këtë besim, janë në fakt tepër budallenj dhe qesharakë. Meshkujt, të cilët takohen më shpesh me këta njerëz të jashtëm, nuk mendojnë kështu; bindja e tyre, nëse e kanë, është i një lloji mjaft të ndryshëm. Ndërsa bindja e saj, të cilën mendon se e ka për shkak të Besimit, është në realitet thjesht rezultat i ngjyrimit që ka marrë nga mjedisi që e rrethon. Në fakt, kjo është e ngjashme me bindjen që ajo kishte në moshën dhjetëvjeçare se lloji i thikave që përdornin në shtëpinë

e të atit për të ngrënë peshkun, ishte i duhuri, normal, ose “i vërteti”, ndërsa thikat e fqinjëve nuk ishin aspak “thika të vërteta” peshku. Tani, injoranca dhe naiviteti në gjithë këtë çështje janë kaq të dukshëm, ndërsa ai i krenarisë shpirtërore kaq i parëndësishëm, saqë nuk na jep shumë shpresë për të fituar vajzën vetë. Por, a e ke menduar se si mund të përdoret kjo situatë për të ndikuar tek pacienti yt?

Ai që e ekzagjeron, është gjithmonë fillestari. Njeriu i rritur në shoqëri është tepër i rafinuar, ndërsa studiuesi i ri është pedant. Në këtë rreth të ri, pacienti yt është fillestar. Ai atje përballët përditë me një jetë të krishterë, të një cilësie që nuk e kishte imagjinuar kurrë më parë dhe e shikon gjithçka pas xhamit, i magjepsur, sepse ka rënë në dashuri. Ai mezi po pret (në fakt, këtë i urdhëron dhe Armiku) që ta imitojë këtë cilësi. A mund të bësh që ta imitojë edhe këtë *defekt* të dashnores së tij dhe ta çojë edhe më tej, derisa ky ves, që tek vajza nuk zë ndonjë vend shumë të madh, tek ai të kthehet në vesin më të fortë dhe më të bukur – Krenarinë Shpirtërore?

Kushtet duket se janë të favorshme, madje ideale. Rrethi i ri ku po e gjen veten pacienti, është i një lloji të

tillë ai mund të tundohet të jetë krenar për shumë arsye të tjera veç krishterimit të tij. Ky është rrethi shoqëror më i edukuar, më inteligjent, dhe më i lezetshëm se çdo rreth tjetër me të cilin ka pasur të bëjë deri tani. Po ashtu, ai është deri diku duke thurur iluzione në lidhje me vendin e tij në të. Nën ndikimin e “dashurisë”, ai mund ta shohë veten ende si të padenjë për vajzën, por, me shumë shpejtësi, nuk po e sheh më veten si të padenjë për të tjerët. Ai nuk e ka idenë se sa shumë e falin ata ngaqë janë të hirshëm dhe bëjnë gjithçka që munden sepse tani ai është pjesë e familjes. As që e merr dot me mend se sa shumë prej bisedave të tij, sa shumë prej mendimeve që ai shpreh, shihen prej tyre thjesht si imitim të mendimeve të tyre. Madje, as nuk i shkon në mendje se një pjesë e gëzimit që ka kur qëndron me këta njerëz është për shkak të ndjenjës erotike që ndjen ai kudo ku vajza është. Ai mendon se i pëlqejnë bisedat dhe mënyra e tyre e jetesës për shkak të barazisë së gjendjes së tyre shpirtërore me të tijën, kur në fakt ata janë aq lart krahasuar me të saqë, po të mos ishte i dashuruar, do të ishte habitur dhe indinjuar nga shumë prej gjërave që tani i pranon. Ai është si qeni që mendon se di gjithçka për armët e zjarrit, vetëm sepse

instinkti i tij prej gjahtari dhe dashuria për të zotin i dhanë mundësi të shijonte një ditë gjuetie!

Këtë moment mund ta kapësh për të ndërhyrë. Ndërsa Armiku, përmes dashurisë seksuale dhe njerëzve shumë socialë që kanë përparuar në shërbim të Tij, po e afron barbarin e ri në nivele që nuk do t'i arrinte kurrë me ndonjë mënyrë tjetër, ti duhet ta bësh të ndihet se po gjen nivelin *e vet* – se këta njerëz janë “lloji i tij” dhe se, duke ardhur mes tyre, ka mbërritur në shtëpi. Kur është në ndonjë shoqëri tjetër, jo mes tyre, gjithçka do t'i duket pa shije; pjesërisht ngaqë gati çdo shoqëri tjetër rreth tij është, në fakt, shumë më pak argëtuese, por mbi të gjitha për shkak se do i mungojë magjepsja e të dashurës. Duhet ta mësosh ta ngatërrojë këtë kontrast mes rrethit shoqëror që i pëlqen dhe atij që e mërzit, me kontrastin midis të krishterëve dhe jobesimtarëve. Duhet ta bësh të ndiejë (më mirë pa arritur ta formulojë me fjalë) “sa të ndryshëm që jemi ne të krishterët”; dhe me “ne të krishterët”, pa e ditur, ai duhet të nënkuptojë në fakt “grupi im”; dhe me “grupi im” duhet të nënkuptojë jo “Njerëzit të cilët, në dashurinë dhe përvetësimin e tyre, më kanë pranuar”, por “Njerëzit me të cilët shoqërohem sepse e meritoj”.

Për të pasur sukses në këtë pikë, duhet ta hutosh atë. Nëse përpiqesh ta bësh qartazi dhe haptazi krenar që është i krishterë, me shumë mundësi do të dështosh; paralajmërimet e Armikut dihen qartë. Por, nga ana tjetër, nëse e lë idenë e “ne të krishterëve” të bjerë plotësisht dhe e bën të mbetet thjesht i kënaqur me “grupin e tij”, ke për të prodhuar, jo krenari të vërtetë shpirtërore, por një krenari të kotë sociale e cila, në krahasim me të parën, është vetëm një mëkat i vogël dhe i pavlerë. Ajo që duhet të bësh është që në të gjitha mendimet e tij të futësh një lloj vetëmburrjeje dinake dhe të mos e lejosh kurrë të bëjë pyetjen: “Për çfarë saktësisht po e mburr veten?”. Ideja se i përket një rrethi të brendshëm, se është pjesë e një sekreti, është diçka shumë e ëmbël për të. Këtu ke mundësi ta zësh mat. Nxite pacientin, duke përdorur momentet e ndonjë mendjelehtësie të vajzës, që të ndiejë një lloj *argëtimi* në gjërat që thonë jobesimtarët. Disa teori që mund t’i ndeshë në qarqe moderne të krishtera mund të ndihmojnë në këtë drejtim; e kam fjalën për ato teori që i bazojnë shpresat për ndryshimin e shoqërisë tek ndonjë rreth i ngushtë “klerikësh”, një pakicë e trajnuar teokratësh. Nuk ke pse të shqetësohesh nëse ato teori

janë të vërteta apo të rreme; gjëja e mirë është ta bësh krishtërimin një fe të mistershme, tek e cila pacienti ta ndiejë veten si një prej të brendshmëve.

Të lutem mos i mbush më letrat e tua me gjepura për luftën europiane. Pa dyshim, përfundimi i saj është i rëndësishëm, por kjo është një çështje që i përket Komandës së Lartë. Nuk më intereson aspak të di se sa njerëz në Angli janë vrarë nga bombat. Përsa i përket gjendjes së tyre mendore në çastin e vdekjes, këtë mund ta mësoj nga zyra. Dihej që një ditë do të vdisnin. Të lutem përqendrohu te detyra jote.

Khaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Problemi që kam në të vërtetë me grupin ku është përfshirë pacienti, është se janë *thjesht* të krishterë. Sigurisht, të gjithë ata kanë këndvështrime të ndryshme personale, por lidhja mes tyre mbetet thjesht krishtërimi. Ajo që duam ne, nëse njerëzit bëhen të krishterë, është t'i mbajmë në një gjendje mendore që unë e quaj “Krishtërimi Dhe ...”. Pra, e kupton – krishtërimi dhe kriza, krishtërimi dhe Psikologjia e Re, krishtërimi dhe Rendi i Ri, krishtërimi dhe shërimi nëpërmjet besimit, krishtërimi dhe puna kërkimore Psikike, krishtërimi dhe vegjetarianizmi, krishtërimi dhe reforma në shqiptim. Nëse duhet të jenë të krishterë, të paktën të jenë të krishterë me një dallim. Zëvendësoje besimin në vetvete me ndonjë Stil tjetër që mjafton të ketë ngjyra të krishtera. Shfrytëzoje neverinë që kanë njerëzit nga “gjithnjë e njëjta gjë”.

Neveria nga “gjithnjë e njëjta gjë” është një nga pasio-

net më të vyera që kemi prodhuar në zemrën njerëzore – një burim i pashtershëm herezie fetare, marrëzie në këshilla, pabesie në martesë dhe paqëndrueshmërie në miqësi. Njerëzit jetojnë në kohë dhe e përjetojnë realitetin në mënyrë të njëpasnjëshme. Prandaj, për të pasur sa më tepër përjetime, ata duhet të provojnë shumë gjëra të ndryshme; pra, duhet të përjetojnë ndryshim. Dhe meqë kanë nevojë për ndryshim, Armiku (duke qenë qejfli në thellësi të zemrës) e ka bërë ndryshimin diçka të pëlqyeshme për ta, ashtu siç e ka bërë të ngrënit diçka të pëlqyeshme. Por, ngaqë nuk do që ndryshimi apo e ngrëna të kthehen në qëllimin e tyre përfundimtar, Ai ka vendosur një ekuilibër mes nevojës për ndryshim dhe nevojës për të përhershmen. Është përpjekur t'i kënaqë të dyja këto shije në botën që krijoi, përmes bashkimit të ndryshimit me të përhershmen duke krijuar atë që ne e quajmë Ritëm. Ai u dha stinët, secila prej tyre është e ndryshme e megjithatë përsëritet çdo vit, kështu që pranvera është gjithmonë diçka e re, e prapëseprapë gjithmonë përsëritje e së njëjtës ide, që në lashtësi. Edhe në Kishën e Tij, Ai u jep një vit kalendarik shpirtëror; ata kalojnë nga agjërimi në festë dhe festat përsëriten çdo vit.

Tani, ashtu siç e shfrytëzojmë kënaqësinë e të ngrënit përmes ekzagjerimit për të prodhuar grykësinë, kështu duhet ta marrim edhe këtë kënaqësi të natyrshme për ndryshim dhe ta shtrembërojmë duke e kthyer në një kërkesë për risi absolute. Kjo detyrë është mjeshtëria jonë. Nëse e lëmë mënjane detyrën tonë, njerëzit jo vetëm që do të kënaqen, por do të ekzaltohen nga përzierja e risisë dhe kujtimit të flokëve të borës *këtë* janar, nga lindja e diellit *këtë* mëngjes dhe nga pudingu me kumbulla *këtë* Krishtlindje. Në qoftë se nuk i mësojmë, fëmijët do të jenë përsosmërisht të lumtur me një ndryshim sezonal lojërash, ku lojërat me gështenja do të ndjekin ato me plloça, ashtu si vjeshta ndjek verën. Vetëm përmes përpjekjeve tona të pashtershme, kërkesa për ndryshim të pafund, apo joritmik, mbahet gjallë.

Kjo kërkesë na sjell dobi në shumë mënyra. Së pari, e pakëson kënaqësinë duke shtuar dëshirën. Kërkesa për risi, nga vetë natyra, ka kosto të lartë krahasuar me fitimin që sjell. Risia e vazhdueshme është e kushtueshme, prandaj kjo dëshirë shkakton lakmi, ose mungesë lumturie, ose të dyja bashkë. Gjithsesi, sa më e pangopur të jetë kjo dëshirë, aq më shpejt do t'i konsumojë të gjitha

burimet e pastra të kënaqësisë dhe do të kalojë tek ato që Armiku i ndalon. Kështu, duke nxitur neverinë nga “gjithnjë e njëjta gjë”, kohët e fundit i kemi bërë, për shembull, Artet, më pak të rrezikshme për ne se ndoshta kurrë më parë. Ne kemi bërë që artistët, si ata “që nuk vlejnë asnjë grosh” ashtu edhe ata “ballëllartët” të tërhiqen gjithnjë e më shumë drejt teprimeve të reja dhe përherë të freskëta të epsheve, mungesës së arsyes, barbarizmit dhe krenarisë. Përfundimisht, dëshira për risi është e patjetërsueshme për ne për të na ndihmuar të prodhojmë Modë dhe Trende.

Përdorimi i Modës në fushën e mendimit na ndihmon t’ua heqim njerëzve vëmendjen nga rreziqet e saj të vërteta. Ne e drejtojmë thirrjen e modës të secilit brez kundër veseve prej të cilave rrezikohet më pak dhe e fiksojmë miratimin e saj te virtyti që gjendet më pranë vesit të cilin po përpiqemi të përhapim. Qëllimi i lojës është t’i bëjmë të vrapojnë sa andej-këtej me fikëse zjarri sa herë që ka përmbytje dhe të grumbullohen të gjithë në atë anë të varkës që është gati të përmbysset. Kështu, e kthejmë në modë luftën ndaj entuziazmit duke theksuar rreziqet e tij, pikërisht në çastin kur ata janë në të vërtetë të gjithë

të vakët dhe materialistë; sot, pas një shekulli, ndërsa po i kthejmë të gjithë në Bajronë, të dehur nga emocionet, zëri i modës drejtohet kundër rreziqeve të “arsyes” së thjeshtë. Gjatë periudhave gjakatare bëhet thirrje kundër Sentimentalizmit, periudhat e plogështa, pa asnjë ngjarje, i kundërvihen të respektueshmes, ato ku epshi bëhet mbizotërues ne vihem i kundër Puritanizmit; dhe sa herë që gjithë njerëzit nxitojnë të bëhen skllëvër ose tiranë, ne e kthejmë Liberalizmin në një përbindësh të vërtetë.

Por, triumfi më i madh është kthimi i neverisë nga “gjithnjë e njëjta gjë” në rangun e një filozofie, në mënyrë që dokrrat intelektuale të mund ta justifikojnë korruptimin e vullnetit. Këtu na hyn shumë në punë karakteri Evolucionar ose Historik i mendimit modern European (pjesërisht vepër e jona). Armikut i pëlqen thjeshtësia. Sa herë që njerëzit duan të vënë në veprim ndonjë plan, me sa kam parë, Ai dëshiron që të bëjnë pyetje shumë të thjeshta: A është e drejtë? A është gjëja e duhur? A është e mundur? Tani, nëse mund t’i mbajmë vazhdimisht duke pyetur: “A është në përputhje me lëvizjen e përgjithshme të kohës sonë? A është progresive apo reaksionare? A është ky drejtimi në të cilin po shkon

Historia?”, ata do t’i harrojnë pyetjet e rëndësishme. Dhe pyetjet që ata bëjnë, *në të vërtetë* janë, sigurisht, pa përgjigje; sepse ata nuk e njohin të ardhmen dhe ajo do të varet shumë nga pikërisht ato zgjedhje për të cilat tani njerëzit i drejtohen të ardhmes për t’i ndihmuar t’i bëjnë. Si rezultat, ndërsa mendjet u gumëzhijnë në këtë boshllëk, kemi rastin e duhur për të ndërhyrë dhe për t’i shtyrë të veprojnë ashtu siç duam *ne*. Një punë shumë e mirë është kryer tashmë. Më parë, njerëzit e dinin se disa ndryshime ishin për mirë, disa të tjera për keq, dhe disa të tjera as kishin rëndësi fare. Ne e kemi asgjësuar një pjesë të mirë të kësaj njohurie. Mbiemrin përshkrues “i pandryshuar” e kemi zëvendësuar me mbiemrin emocional “i ndenjur”. I kemi trajnuar që ta mendojnë të Ardhmen si një tokë të premtuar të cilën e arrijnë heronjtë e talentuar – jo si diçka që preket në hapësirën e gjashtëdhjetë minutave nga kushdo, pavarësisht kush është apo çfarë ka bërë.

Khaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Po, periudha e lidhjes në një marrëdhënie dashurie është e përshtatshme për të mbjellë ato farëra që, pas dhjetë vitesh, do të rriten duke shkaktuar urrejtje në familje. Magjepsja e dëshirës së papërmbushur prodhon fryte të cilat njerëzit mund t'i ngatërrojnë me fryte të dashurisë. Përdore sa më tepër mjegullën e fjalës “Dashuri”: le të mendojnë se përmes Dashurisë i kanë zgjidhur problemet kur, në fakt, thjesht i kanë anashkaluar ose vonuar nën ndikimin e magjepsjes. Për aq kohë sa kjo zgjat, ke rastin që t'i frysh problemet sa më tepër fshehtazi dhe t'i kthesh ato në kronike.

Problemi madhor është ai i “Vetëmohimit”. Por, ke rastin të shohësh sërish veprën e admirueshme që ka kryer Krahunë Filologjik duke e zëvendësuar fjalën pozitive “altruizëm” të Armikut tonë me negativën “vetëmohim”. Falë kësaj ti mundesh që nga fillimi ta mësosh njeriun të heqë

dorë nga gjëra të mira, jo për t'i bërë të tjerët të lumtur kur të përfitojnë prej tyre, por që ai të tregohet vetëmohues kur heq dorë prej tyre. Nëse arrijmë në këtë pikë, kemi arritur shumë. Një tjetër ndihmesë e madhe, nëse palët në fjalë janë femër dhe mashkull, është ndryshimi në pikëpamje që kemi ndërtuar mes dy gjinive mbi vetëmohimin. Për femrat, fjala vetëmohim nënkupton kryesisht të mundohesh për të mirën e të tjerëve; për meshkujt nënkupton të mos u bësh keq të tjerëve. Si rezultat, gratë që kanë përparuar në shërbimin ndaj Armikut do bëhen shumë më acaruese sesa meshkujt, përveç atyre që Ati ynë i ka dominuar plotësisht; dhe, anasjelltas, burrat duhet të kalojnë një kohë të gjatë në kampin e Armikut përpara se të ndërmarrin vepra aq spontane për të arritur masën që një grua e zakonshme bën përditë. Kështu, ndërsa gruaja mendon të bëjë vepra të mira dhe burri të respektojë të drejtat e të tjerëve, secili prej sekseve, pa ndonjë arsye të dukshme, mundet dhe e konsideron vërtet tjetrin si egoist të shkallës më të lartë.

Pas këtyre pështjellimeve, mund të vazhdosh edhe me disa të tjera. Magjepsja erotike prodhon një dëshirë reciproke ku secili gjen *vërtet* kënaqësi në nënshtrimin ndaj dëshirave të tjetrit. Ata e dinë, gjithashtu, se shkalla e

vetëmohimit që u kërkon Armiku, nëse arrihet, do të çojë në të njëjtin rezultat. Duhet t'i bësh që ta vendosin si Ligj për gjithë jetën e tyre martesore atë shkallë vetë-sakrifikimi reciproke e cila, për momentin, po rritet natyrshëm nga magjepsja, por që kur kjo të venitet, nuk do të kenë aq vetëmohim sa të mund të veprojnë. Ata nuk kanë për ta vënë re kurthin, sepse janë në një verbëri të dyfishtë duke menduar nga njëra anë se emocionet seksuale janë dashuri dhe nga ana tjetër se ato do të zgjasin përgjithmonë.

Pasi të kesh vendosur si rregull një lloj vetëmohimi zyrtar, ligjor ose thjesht të ashtuquajtur – për ruajtjen e të cilit burimet emocionale kanë shteruar tashmë, ndërsa burimet shpirtërore nuk janë shtuar ende, – ke për të pasur rezultate shumë të kënaqshme. Kur të jenë duke diskutuar për diçka që duhet të bëjnë së bashku, duhet patjetër që A-ja të argumentojë në favor të dëshirave të supozuara të B-së dhe kundër dëshirave të veta, ndërsa B-ja të bëjë të kundërtën. Shpesh është e pamundur që palët të kuptojnë dëshirat e vërteta të njëra-tjetrës; me pak fat, ata do të përfundojnë duke bërë diçka që asnjëri prej tyre nuk e do, ndërkohë që secili do ta shikojë veten me një aureolë vetëdrejtësie dhe do të pretendojë fshehtazi se

e ka hak një trajtim të veçantë për vetëmohimin e treguar, dhe ka të drejtë të lëndohet së brendshmi për faktin se tjetri e pranoi shumë lehtë sakrificën e bërë. Më vonë, mund të vazhdosh me atë që quhet Iluzioni i Konfliktëve Bujare. Kjo lojë mund të luhet më mirë me më tepër se dy lojtarë, në një familje me fëmijë të rritur, për shembull. Në fillim propozohet diçka e parëndësishme, për shembull, të pinë çaj në kopsht. Njëri nga pjesëtarët mundohet ta bëjë të qartë (ndonëse me pak fjalë) se nuk do t'i pëlqente, megjithatë është gati ta bëjë për shkak të “vetëmohimit”. Të tjerët e tërheqin menjëherë propozimin, duke menduar se e bëjnë për shkak të “vetëmohimit”, por në fakt e bëjnë sepse nuk duan të përdoren si një manekinë përmes të cilës folësi i parë i bën reklamë vetes për sakrificat të vockla. Por, edhe ai nuk lejon aq lehtë që t'ia heqin kënaqësinë e Altruizmit. Ai këmbëngul të bëjë “atë që duan të tjerët”. Ata këmbëngulin të bëjnë çfarë do ai. Emocionet fillojnë të ndizen. Pas pak dikush thotë: “Epo, mirë, unë s'dua të pi fare çaj!”, dhe kështu fillon një sherr i vërtetë, ku të dyja palët mbeten të lënduara. E kupton, pra, si ndodh? Secila palë, po të kishte luftuar në fakt për dëshirën e saj të vërtetë, do t'u ishte përmbajtur lehtësisht kufijve të

arsyes dhe mirësjelljes; por meqë grindja kthehet nga ana e kundërt dhe secila palë po lufton për krahun e tjetrit, i gjithë lëndimi, që rrjedh realisht nga prishja e planeve për vetëdrejtësi dhe kokëfortësi dhe nga zemërimi i mbledhur gjatë dhjetë viteve të fundit, fshihet prej tyre prapa “vetëmohimit” zyrtar, i ashtuquajtur i tillë, për atë që po bëjnë (ose të paktën, shfaqësohen prej tij). Secila palë e kupton vërtet mirë cilësinë e ulët të vetëmohimit të kundërshtarit dhe pozitën e rreme që ai po përpiket t’u imponojë atyre; por nga ana tjetër, secila palë ia del të ndihet e pafajshme dhe e keqpërdorur, në pandershmërinë e natyrshme të qenieve njerëzore.

Një njeri me mend tha dikur: “Sikur ta dinin njerëzit se sa ndjenja të këqija ndjell i ashtuquajturi vetëmohim, nuk do ta rekomandonin aq shpesh nga foltoret e kishës”; dhe një tjetër: “Ajo është lloji i gruas që jeton për të tjerët – mund ta njohësh tjetrin lehtësisht nga shprehja e fytyrës kur përballet me rrethana të vështira”. E gjitha kjo mund të fillojë edhe në periudhën e lidhjes. Pak egoizëm *real* nga ana e pacientit tënd më vonë nuk ka vlerë, nëse nuk ndodh që në hapat e parë, kur pritet ai lloj vetëmohimi i detajuar dhe i ndërgjegjshëm për veten

që një ditë mund të lulëzojë dhe të sjellë rezultatet që të përshkrova e kështu të sigurohemi se do të jetë i yni. Një masë falsiteti reciprok, pak habi për faktin se vajza nuk e vë re gjithmonë se sa vetëmohues po tregohet ai, mund të futet që tani. Përdori mirë këto gjëra dhe, mbi të gjitha, kurrë mos i lër dy torollakët t'u bien në sy. Nëse i vënë re, atëherë do të zbulojnë se “Dashuria” nuk mjafton, se kanë nevojë për altruizmin, të cilin nuk e kanë arritur ende dhe i cili nuk mund të sigurohet nga asnjë ligj i jashtëm. Shpresoj edhe që Kokëteneqeja të bëjë diçka për t'ia hequr asaj zonjushës aftësinë për të dalluar absurden.

Khaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Më duket se po fle mbi dafina për momentin. Sigurisht, është e qartë se po përpiqesh t'ia largosh mendjen nga Armiku duke përdorur 'dashurinë' e tij, por e marr me mend sesa keq po e përdor atë kur më thua në letër se e gjithë çështja e shpërqendrimit dhe endjes së mendjes është bërë një nga temat kryesore të lutjeve të pacientit. Kjo do të thotë se, në përgjithësi, ke dështuar. Kur kjo, ose ndonjë shpërqendrim tjetër, i vjen në mendje, ti duhet ta nxitësh ta hedhë tej vetëm përmes forcës së vullnetit dhe të përpiqet të vazhdojë lutjet normale sikur të mos kishte ndodhur asgjë; në momentin kur e pranon shpërqendrimin si problemin e tij të tanishëm dhe ia parashtron atë Armikut duke e kthyer në temën kryesore të lutjeve dhe përpjekjeve të tij, atëherë, na polli belaja. Çdo gjë, madje edhe një mëkat, që si pasojë sjell afrimin e pacientit me Armikun, do të na lërë me gisht në gojë.

Një metodë premtuese është kjo që do të të tregoj tani. Tani që ai ka rënë në dashuri, në mendje ka një ide të re për lumturinë *tokësore* dhe rrjedhimisht edhe një kërkesë të re në lutjet e tij ndërmjetësuese – në lidhje me luftën dhe çështje të tjera si këto. Tani është koha të krijojmë vështirësi intelektuale për lutje të këtij lloji. Sjellja shpirtërore e rremë duhet inkurajuar gjithmonë. Duke fiksuar mendimin në dukje të devotshëm se “lavdërimi dhe bashkësia me Perëndinë është lutja e vërtetë”, shpesh njerëzit mund të joshen për një mosbindje të drejtpërdrejtë ndaj Armikut, i cili (në mënyrë të përsëritur, bezdisëse dhe pa qenë fare interesant) u ka thënë atyre që të luten patjetër për bukën e përditshme dhe shërimin e të sëmurëve. Sigurisht, ti duhet t’ia fshehësh atij faktin se lutja për bukën e përditshme, e interpretuar në “kuptimin shpirtëror”, është ndërmjetësim dhe ka të njëjtën vlerë si çdo lutje, për çdo aspekt tjetër të jetës.

Por, meqë pacienti yt është infektuar nga zakoni i tmerrshëm i bindjes, me siguri do të vazhdojë t’i bëjë këto lutje “të pagdhendura”, çfarëdo që të bësh ti. Gjithsesi mund ta shqetësosh me dyshimin e vazhdueshëm se kjo praktikë është absurde dhe se nuk mund të ketë rezultate

objektive. Mos harro të përdorësh argumente të tipit “bie stemë fitoj unë, bie kokë humbet ti”. Nëse gjëja për të cilën ai lutet nuk ndodh, atëherë ja një provë se kërkesat nuk marrin përgjigje në lutje; nëse vërtet ndodh, ai patjetër që do të jetë në gjendje të vërejë disa shkaqe fizike që çuan në realizimin e saj, dhe “rrjedhimisht, do të kishte ndodhur gjithsesi,” e në këtë mënyrë edhe lutja që merr përgjigje kthehet në provë për të vërtetuar se lutjet nuk marrin përgjigje.

Meqë ti je shpirt, do ta kesh të vështirë ta kuptosh sesi mund të pështjellohet ai në këtë mënyrë. Por duhet të mbash mend se, për të, Koha është realiteti përfundimtar. Ai mendon se Armiku, ashtu si ai, i shikon disa gjëra si të tashme, i kujton disa të tjera si të kaluara dhe i parashikon disa të tjera si të ardhme; ose, edhe nëse beson se Armiku nuk i shikon gjërat në këtë mënyrë, prapëseprapë, në thellësi të zemrës së tij, e konsideron këtë si një veçanti të mënyrës sesi Armiku i percepton gjërat – ai nuk mendon vërtet (ndonëse e pohon me gojë) se gjërat janë ashtu siç i shikon Armiku! Nëse do të përpiqeshe t’i shpjegoje se lutjet e njerëzve sot janë një nga koordinatat e panumërta me të cilat Armiku harmonizon motin e

ditës së nesërme, ai do të përgjigjej se në këtë rast Armiku e ka ditur gjithmonë se njerëzit do t'i bënin këto lutje kështu që ata nuk u lutën me vullnet të lirë, por ishin të paracaktuar që të vepronin kështu. Dhe do të shtonte gjithashtu, se motit të një dite të caktuar mund t'ia gjesh origjinën, përmes shkaqeve të tij, deri te krijimi fillestar i vetë materies – prandaj gjithçka, si nga ana njerëzore, ashtu edhe nga ana materiale, është e paracaktuar “që nga fillimi”. Ajo që duhet të mendojë pacienti, sigurisht, për ne është e qartë; se përputhja e motit me ndonjë lutje specifike, është thjesht një dukje e jashtme, në dy pika të mënyrës së përkohshme të perceptimit të tij, lidhur me problemin e përshtatjes së plotë të gjithë universit shpirtëror me gjithë universin fizik; se krijimi, në tërësinë e tij, operon në çdo pikë të hapësirës dhe kohës, ose se lloji i vetëdijes që kanë i detyron njerëzit që të përballen me gjithë veprën krijuese, konsistente në vetvete, si me një seri ngjarjesh të njëpasnjëshme. *Përse* ky akt krijues lë hapësirë për vullnetin e tyre të lirë, ky është thelbi i problemeve: cili është sekreti që fshihet pas marrëzive të Armikut për “Dashurinë”? Nuk është aspak problem mënyra *Si* ndodh kjo gjë; sepse Armiku nuk ka nevojë

të *parashikojë* se kur do të kryejnë njerëzit veprime me vullnet të lirë në të ardhmen, pasi Ai i shikon veprimet e tyre në të Tanishmen e Tij të pakufizuar. Dhe natyrisht, të shohësh një njeri duke bërë diçka nuk është e njëjta gjë si ta detyrosh atë ta bëjë.

Dikush mund të thotë se disa shkrimtarë njerëzorë që fusin hundët kudo, në veçanti Boethius, e nxori në dritë sekretin e kësaj. Por në klimën intelektuale që ia kemi dalë, më së fundi të krijojmë në gjithë Europën perëndimore, nuk ke nevojë aspak të merakosesh për këtë. Vetëm të diturit hapin libra të vjetër dhe me të diturit ia kemi dalë kaq mirë sa, nga të gjithë njerëzit, ata kanë më pak gjasa të përfitojnë urtësi duke e bërë këtë. E kemi arritur këtë duke ngulitur në tru Këndvështrimin Historik. Këndvështrimi Historik shkurtimisht do të thotë se kur një njeri i ditur përballet me ndonjë deklaratë të ndonjë një shkrimtari të lashtë, ai nuk shtron kurrë pyetjen “A është e vërtetë kjo deklaratë?”. Ai pyet se kush e ka ndikuar shkrimtarin e lashtë dhe sa përputhet kjo deklaratë me ato që autori ka shprehur në librat e tjerë; cilën fazë të zhvillimit të shkrimtarit, ose të historisë së përgjithshme të mendimit ilustron ajo; sa shumë ka

ndikuar tek shkrimtarët e mëvonshëm dhe sa shpesh është keqkuptuar ajo (sidomos nga vetë kolegët e njeriut të ditur); cili ka qenë kursi i përgjithshëm i kritikës mbi këtë vepër gjatë dhjetë viteve të fundit dhe cila është “gjendja aktuale e çështjes”. Të konsideruarit e shkrimtarit të lashtë si një burim të mundshëm njohurie – pritshmëria se ajo që ai thotë mund të ndryshonte mendimet dhe sjelljen e tij – kjo do të ishte një mendjelehtësi që nuk duhet as të përmendet. Dhe meqë nuk mund ta mashtrojmë gjithë racën njerëzore për gjithë kohën, është shumë e rëndësishme ta shkëputim në një mënyrë të tillë njërin brez nga gjithë të tjerët; sepse atëherë kur të nxënit transmetohet lirisht nga epoka në epokë, ekziston gjithmonë rreziku që gabimet karakteristike të njëres mund të ndreqen nga të vërtetat që e karakterizojnë tjetrën. Por falë Atit tonë dhe Këndvështrimit Historik, dijetarët e rëndësishëm po ushqehen tani aq pak nga e kaluara, sa edhe mekaniku më injorant që thotë: “historia është kot”.

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Kur të këshillova të mos i mbushësh letrat me gje-pura për luftën, sigurisht që doja të thoja se nuk dua të më shkruash rapsodi fare foshnjarake për vdekjen e njerëzve dhe shkatërrimin e qyteteve. Por, nëse lufta prek gjendjen shpirtërore të pacientit, natyrisht që dua të më dërgosh raporte të plota. Dhe në këtë aspekt më dukesh veçanërisht i ngathët. Kështu, ti shprehesh me gëzim se ka shumë mundësi që mbi qytetin ku jeton kjo krijesë të ketë bombardime ajrore. Ky është një shembull i qartë i asaj për të cilën jam ankuar më parë; gatishmërinë që ke për ta harruar çështjen kryesore vetëm për të shijuar momentin e vuajtjes njerëzore. A nuk e di ti që bombat i vrasin njerëzit? Apo nuk e kupton se vdekja e pacientit tënd, në këtë moment, është pikërisht ajo gjë që duam ta shmangim? Ai i ka shpëtuar kurthit tënd për ta shoqëruar me miq jobesimtarë; ka ‘rënë në dashuri’ me

një grua të krishterë të thellë dhe ka fituar një imunitet të përkohshëm ndaj sulmeve kundër dëlirësisë së tij; ndërsa metodat e ndryshme që ke përdorur për t’ia ndikuar jetën shpirtërore nuk kanë qenë të suksesshme deri tani. Në këto çaste, me afrimin më të dukshëm të ndikimit të luftës dhe ndërsa shpresat e tij për këtë botë po zënë një vend gjithnjë e më të vogël në mendje, i zënë me detyrën për t’u vetëmbrojtur, i zënë me të dashurën, i detyruar të kujdeset për fqinjët shumë më tepër se më parë dhe i vetëdijshëm se kjo gjë i pëlqen më tepër se ç’e priste, siç thonë njerëzit “ka dalë nga vetja” ndërsa varet gjithnjë e më tepër tek Armiku, me siguri që ne do të mbetemi me gisht në gojë nëse vritet sonte. Këtë e di edhe bufi, aq sa mua po më vjen turp nga vetja që po ta shkruaj. Ndonjëherë pyes veten se mos ju tunduesit e rinj kaloni kohë më tepër se ç’duhet në detyra tunduese – saqë rrezikoni të infektoheni vetë nga ndjenjat dhe vlerat e njerëzve me të cilët punoni. Sigurisht, ata vërtet e konsiderojnë vdekjen si të keqen më të madhe, ndërsa mbijetesën si të mirën më të madhe. Por kjo ndodh vetëm sepse kështu i kemi mësuar ne. Mos përfundojmë duke u infektuar nga vetë propaganda jonë. E di që duket e çuditshme që qëllimi yt kryesor për momentin duhet të

jetë i njëjti me atë për të cilin po luten e dashura dhe nëna e tij – pra, siguria e tij trupore. Por ja që kështu është; duhet ta ruash si dritën e syve. Nëse vdes tani, kemi për ta humbur. Nëse i mbijeton luftës, ka gjithmonë shpresë. Gjatë valës së parë të madhe të tundimeve, Armiku e ka ruajtur prej teje. Por, nëse mbetet i gjallë, koha do të jetë aleatja jote. Vitet e gjata, të plogështa dhe monotone të mirëqenies së moshës së mesme, apo fatkeqësitë e kësaj moshe janë momenti i shkëlqyer për të ngritur kampin tonë. E di, këto krijesa e kanë shumë të vështirë të këmbëngulin. Rutina e fatkeqësisë, humbja graduale e dashurive rinore dhe shpresave rinore, dëshpërimi i heshtur (që nuk ndihet në formë dhimbjeje) nga fakti se vazhdimisht u duhet të mposhtin tundime kronike me të cilat i kemi mundur vazhdimisht ata, mungesa e shijes që krijojmë në jetën e tyre dhe zemërimi i pashprehur me të cilin i mësojmë që t'i përgjigjen – e gjithë kjo siguron mundësi të shkëlqyera për ta rraskapitur shpirtin njerëzor me ndjenjën e mëkatit. Nga ana tjetër, nëse ndodh që vitet e moshës së mesme të jenë të begata, pozicioni ynë forcohet edhe më tej. Begatia e lidh njeriun me Botën. Ai ndihet se “po zë vendin e tij në të”, ndonëse në të vërtetë

është bota ajo që po zë vend tek ai gjithnjë e më tepër. Nami i tij në rritje, rrethi i zgjeruar shoqëror, ndjesia e rëndësisë së tij, trysnia e madhe e punës që i pëlqen të bëjë theksojnë tek ai ndjenjën e të qenit vërtet në shtëpi ndërkohë që jeton në tokë dhe pikërisht kjo është ajo gjë që duam ne. Do të vësh re se të rinjtë në përgjithësi e kanë më pak frikë vdekjen sesa burrat e moshuar, apo ata të moshës së mesme.

E vërteta është se Armiku, ngaqë çuditërisht i ka paracaktuar këto kafshë për të jetuar në botën e Tij të përjetshme, i ka ruajtur aq fort nga rreziku i të ndjerit në shtëpi në ndonjë vend tjetër. Kjo është arsyeja se përse ne duhet t'u urojmë pacientëve jetë të gjatë; shtatëdhjetë vjet nuk janë shumë për detyrën e vështirë që t'ua rrëmbejmë shpirtin nga Qielli dhe t'i lidhim fort pas tokës. Kur janë të rinj, shohim se gjithmonë qëllojnë në mënyrë tangjente. Edhe nëse përpiqemi t'i mbajmë të paditur në lidhje me fenë e pastër, erërat e paparashikueshme të fantazisë, muzikës dhe poezisë – thjesht fytyra e një vajze, kënga e zogut, apo pamja e horizontit – na e hedhin gjithnjë në erë krejt strukturën që kemi ngritur ne. Ata nuk pranojnë të vendosin si përparësi të jetës ndjekjen e vazhdueshme

të përparimit në botë, lidhjet me mend, apo politikën e sigurisë. Kaq e pangopur është etja e tyre për Qiellin, saqë metoda më e mirë që mund të përdorim në këtë fazë, për t'i lidhur fort me tokën, mbetet t'i bëjmë të besojnë se toka mund të kthehet në Qiell në ndonjë datë të mëvonshme përmes politikës, eugjenikës, “shkencës”, psikologjisë, ose ndonjë gjëje tjetër. Konformizmi i vërtetë me botën kërkon kohë – e cila sigurisht duhet ndihmuar nga krenaria, sepse ne u mësojmë ta shikojnë shtyrjen e vdekjes si të arsyeshme, si Maturi ose si Përvojë. *Përvoja*, në kuptimin e çuditshëm që u mësojmë ta marrin, në fund të fundit, është një fjalë e dobishme. Një nga filozofët e mëdhenj njerëzorë pothuajse na e nxori sekretin në shesh kur tha se atje ku bëhet fjalë për Virtytin ‘Përvoja është nëna e iluzionit’; por, falë një ndryshimi në Modë, dhe, sigurisht, edhe përmes këndvështrimit Historik, ne e kemi bërë librin e tij të padëmshëm.

Rëndësia që ka koha për ne në të vërtetë mund të kup-tohet nga fakti se sa pak prej saj Armiku na lë neve në dispozicion. Pjesa më e madhe e racës njerëzore vdes në foshnjëri; nga të mbijetuarit, shumë vdesin të rinj. Është e qartë se, për Të, lindja e një njeriu është e rëndësishme

kryesisht si kusht që duhet të ndodhë para vdekjes, ndërsa vdekja thjesht si portë që hapet drejt një lloji tjetër jete. Neve na lejohej të punojmë vetëm me një minoritet të caktuar të kësaj race, sepse ajo që njerëzit e quajnë “jetë normale” është një përjashtim. Mesa duket, Ai do që disa (por vetëm disa) prej kafshëve njerëzore me të cilat po e popullon Qiellin, të kenë përvojën e rezistencës kundër nesh gjatë një jete tokësore prej gjashtëdhjetë ose shtatëdhjetë vitesh. Epo aty qëndron mundësia jonë. Sa më e pakët koha në dispozicion, aq më mirë duhet ta përdorim. Çfarëdo që të bësh, në çdo rast, mbaje pacientin sa më të sigurt që të mundesh.

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Tani që është e sigurt se qeniet njerëzore nga Gjermania do ta bombardojnë qytetin e pacientit tënd dhe se për shkak të detyrës që ka, ai do të jetë në mes të rrezikut, duhet ta shqyrtojmë edhe më mirë politikën tonë. Duhet të synojmë të nxitim burracakërinë – apo kurajën që sjell si pasojë krenarinë – apo urrejtjen për gjermanët?

Me sa shoh unë, kam frikë se nuk ia vlen të nxitësh trimërinë tek pacienti yt. Departamenti ynë kërkimor nuk ka zbuluar ende (ndonëse suksesi pritet nga ora në orë) si të prodhojë qoftë dhe një virtyt. Ky është një ngërç serioz. Për të qenë jashtëzakonisht i shkëlqyer dhe për të përdorur ligësinë në mënyrë efektive, njeriu ka nevojë për njëfarë virtyti. Çfarë do të ishte Atila pa kurajën e tij, apo Shylock-u pa vetëmohimin përse i përket mishit të tij? Por meqë nuk mund t'i prodhojmë vetë këto cilësi, mund t'i shfrytëzojmë vetëm siç vijnë të krijuara nga

Armiku – dhe kështu ne jemi të detyruar t'i lëmë Atij një lloj zotërimi tek ata njerëz të cilët, po të mos ishte kështu, do i kishim me siguri në anën tonë. Kush nuk e di që kjo është një ujdi që nuk na pëlqen aspak, por jam i bindur që një ditë do të mësojmë të veprojmë më mirë.

Urrejtjen mund ta menaxhojmë. Tensioni i nervave njerëzorë në mes të zhurmës, rrezikut dhe lodhjes, i bën të prirën drejt çdo emocioni të dhunshëm dhe ne duhet vetëm ta udhëheqim këtë dobësi në drejtimin e duhur. Nëse ndërgegjija reziston, pështjelloje atë. Le të thotë se ndien urrejtje, jo për veten e vet, por për hir të grave dhe fëmijëve, dhe se i krishteri është i detyruar të falë armiqtë e tij, por nuk ka si të falë armiqtë e të tjerëve. Me fjalë të tjera, le të identifikohet aq shumë me gratë dhe fëmijët, sa të ndiejë urrejtje për hir të tyre, por *jo* aq sa t'i konsiderojë armiqtë e tyre si të tijtë dhe si subjekte që duhen falur.

Mbi të gjitha është mirë që urrejtja të kombinohet me Frikën. Burracakëria, nga gjithë veset e tjera, është thjesht e dhimbshme – e tmerrshme ta presësh, e tmerrshme ta ndiesh, dhe e tmerrshme ta kujtosh; urrejtja ka kënaqësitë e veta. Prandaj, ajo shpesh është kompensimi përmes të

cilit njeriu i frikësuar e rimbursen veten për vuajtjet që i shkakton Frika. Sa më tepër frikë të ketë, aq më tepër do të urrejë. Dhe Urrejta është edhe një qetësues i madh për turpin. Nëse do ta prekësh thellë bamirësinë e pacientit, duhet që, së pari, t'ia mposhtësh kurajën.

Tani kjo është një temë paksa e vështirë. Ne i kemi bërë njerëzit krenarë për shumicën e veseve, por jo për frikën. Sa herë që ia kemi dalë mbanë në këtë drejtim, Armiku lejon një luftë, tërmet, ose ndonjë fatkeqësi tjetër dhe menjëherë kuraja bëhet kaq dukshëm e dashur dhe e rëndësishme edhe për sytë njerëzorë, saqë e gjithë puna na shkon dëm. Kështu pra, ka ende të paktën një ves për të cilin ata ndihen vërtet të turpëruar. Rreziku i nxitjes së burracakërisë te pacientët tanë, pra, është se mos shkaktojmë njohje të vërtetë të vetes dhe neveri për veten çka do të sillte si pasojë pendesë dhe përulje. Dhe, në fakt, në luftën e fundit, mijëra njerëz, duke u përballur me frikën e tyre, u ndërgjegjësuam edhe për gjithë botën morale për të parën herë. Në kohë paqeje ne mund t'i bëjmë shumë prej tyre të jenë plotësisht indiferentë ndaj të mirës dhe të keqes; në kohë rreziku, kjo çështje u imponohet në një mënyrë të tillë saqë ne nuk

mund t'i verbojmë dot. Këtu ne përballemi me një dilemë të tmerrshme. Nëse do të promovonim drejtësi dhe dashuri mes njerëzve, do të na duhej të luanim në krah të Armikut; por nëse i udhëheqim drejt sjelljes së kundërt, herët a vonë, ajo do të prodhojë (nëse e lejon Ai), një luftë ose një revolucion, ku çështja e pamaskuar e burracakërisë ose kurajës do të zgjojë mijëra njerëz nga mpirja morale.

Me të vërtetë, kjo është ndoshta një nga motivet pse Armiku ka krijuar një botë të rrezikshme – një botë ku çështjet morale dalin vërtet në pah. Ai e kupton po aq mirë sa ti se kuraja nuk është thjesht *një* nga virtytet, por është forma që merr çdo virtyt në çastin e provës, pra, në përballje me realitetin. Dëlirësia, ndershmëria, ose mëshira që dorëzohet përpara rrezikut do të jetë dëlirësi, ndershmëri ose mëshirë vetëm me kushte. Pilati ishte i mëshirshëm për aq sa mëshira nuk vinte në rrezik pozitën e tij.

Prandaj ka po aq mundësi të humbasim sa edhe të fitojmë kur e bëjmë njeriun frikacak; ai mund të mësojë më tepër sesa duhet për veten! Sigurisht, ekziston gjithmonë mundësia, jo për ta vënë turpin nën anestezi, por për ta acaruar atë dhe për të prodhuar Dëshpërim.

Ky do të ishte një triumf i madh. Do të ishte tregues se ky njeri pati besuar dhe pranuar faljen e Armikut për mëkatet e tjera vetëm ngaqë ai vetë nuk e ndiente plotësisht rëndësinë e tyre – dhe se, përsa i përket njërit ves, për të cilin ai bëhet i vetëdijshëm thellë brenda vetes se e çnderon, nuk mund të kërkojë, dhe as të meritojë Mëshirë. Por kam frikë se tashmë e ke lënë të shkojë tepër larg në shkollën e Armikut dhe ai e di se Dëshpërimi është mëkat më i madh se të gjitha mëkatet që e prodhojnë atë.

Përsa i përket teknikës reale të tundimeve për të krijuar burracakëri te njeriu, nuk kemi nevojë të flasim gjatë. Pika kryesore është se kujdesi ka tendencë ta rrisë frikën. Por kujdesi që i kërkohet publikisht pacientit tënd, shumë shpejt, bëhet çështje rutinë dhe i zhduket efekti. Ajo që duhet të bësh, është të vazhdosh t’ia kalosh gjithmonë në mendje (krah për krah me qëllimin e ndërgjegjshëm për të kryer detyrën) idenë e vagullt të një liste gjërash që ai mundet, ose nuk mundet të bëjë, *brenda* kuadrit të detyrës, të cilat duket se e bëjnë të ndihet paksa më i sigurt. Largoja mendjen nga rregulli i thjeshtë (“Duhet të qëndrosh këtu dhe të bëj këtë gjë”) dhe drejtoja tek një sërë linjash imagjinare të jetës (“Nëse do të ndodhë

A-ja – ndonëse shpresoj që të mos ndodhë – mund të bëja B-në – dhe, po të shkonte puna edhe më keq, mund të bëja C-në”). Supersticionet, nëse ende nuk njihen si të tilla, mund të zgjohen. E rëndësishme është ta mbash nën ndjesinë se ka diçka, përveç Armikut ose kurajës që jep Armiku, ku të mbështetet, kështu që, ajo që synohet të ishte një përkushtim total ndaj detyrës, sheqeroset fund e krye me pasiguri të vogla të pandërgjegjshme. Duke ngritur një sërë mbrojtjesh imagjinare për të parandaluar “që gjërat të shkojnë keq e më keq”, ti mund të prodhosh, në atë nivel të vullnetit të tij, pa u ndërgjegjësuar, një siguri se më e keqja *nuk ka* për të ndodhur. Pastaj, në momentin e tmerrit të vërtetë, nxirre frikën në pah dhe prek nervat dhe muskujt e trupit dhe kështu mund të ndodhë akti fatal përpara se pacienti ta kuptojë se çfarë po i bën. Sepse, mbaje gjithmonë mend, se veprimi i burracakërisë është ajo që ka rëndësi; emocioni i frikës, në vetvete, nuk është mëkat dhe, ndonëse na pëlqen, nuk na sjell dobi aspak.

Khaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri im Krimbaq,

Ndonjëherë më duket sikur mendon se je dërguar në botë për të bërë qejf. Me sa kuptoj, jo nga raporti yt i mjerë, por nga Policia e Ferrit, sjellja e pacientit tënd gjatë sulmit të parë ajror ka qenë më e keqja e mundshme. Ai u frikësua shumë, tani mendon se është frikacak i madh dhe, për këtë arsye, nuk ndien fare krenari; megjithëse ka bërë gjithçka sipas detyrës që i ishte caktuar, ndoshta dhe më tepër. Përpara kësaj katastrofe, gjithçka që mund të bësh është t'i krijosh ndonjë shpërthim zemërimi kundër ndonjë qeni që e pengon pa dashje në rrugë, ta shtysh të pijë më tepër cigare dhe të harrojë të bëjë ndonjë lutje. Ç'dobi ka të më qurravitesh për vështirësitë e tua? Nëse po ndikohesh nga ideja që ka Armiku për "drejtësinë" dhe po sugjeron të merren në shqyrtim mundësitë dhe qëllimet e tua, atëherë s'është çudi të akuzohesh për herezi. Sidoqoftë, shpejt ke për ta parë se drejtësia e Ferrit

është thjesht realiste dhe merret vetëm me rezultatet. Ose na sill të hamë, ose do të të hamë ty.

I vetmi paragraf konstruktiv në letrën tënde është kur më thua se ende pret rezultate të mira nga lodhja e pacientit. Mirë, dakord. Por nuk ke për t'ia dalë. Lodhja *mund* të prodhojë butësi të skajshme dhe qetësi të mendjes, madje edhe diçka si vizioni. Nëse ke parë shpesh njerëz që shtyhen nga lodhja në zemërim, ligësi dhe padurim, kjo ndodh ngaqë ata kanë pasur tundues të zotë. Paradoksi është se një lodhje jo shumë e madhe është terren më i mirë për të mbjellë ligësinë sesa rraskapitja e plotë. Kjo varet pjesërisht nga shkaqe fizike, por dhe nga diçka tjetër. Nuk është thjesht lodhja ajo që prodhon zemërim, por edhe kërkesat e papritura që i bëhen një njeriu të lodhur tashmë. Çfarëdo që njerëzit presin, pas pak kohësh mendojnë se kanë plotësisht të drejtë ta kenë: ndjenja e zhgënjimit do të kthehet në lëndim (me pak mjeshteri nga ana jonë). Vetëm pasi njerëzit dorëzohen para të pariparueshmes, kur nuk kanë më shpresë për lehtësim dhe kur nuk janë më në gjendje të mendojnë as edhe gjysmë ore për të ardhmen, atëherë fillojnë rreziqet e lodhjes mesatare dhe të butë. Pra, për të pasur rezultatet

më të mira nga lodhja e pacientit, duhet ta ushqesh me shpresë të rreme. Vendosi në mendje arsye të logjikshme që të besojë se nuk do të përsëritet më ndonjë sulm tjetër ajror. Bëje që ta ngushëllojë veten me mendimin se sa shumë do ta shijojë gjumin në shtrat të nesërmen. Ekzagjeroja lodhjen që ndjen duke e bërë të mendojë se do të marrë fund së shpejti; sepse njerëzit zakonisht ndihen sikur s'do të ishin më në gjendje ta duronin presionin po të mos merrte fund në atë moment, ose po të mos marrë fund atëherë kur e mendojnë ata se duhet. Edhe këtu, ashtu si tek problemi i burracakërisë, duhet të shmangim përkushtimin e plotë. Çfarëdo që të *thotë* ai, bëj që të ketë një vendosmëri, jo për të duruar gjithçka që do t'i dalë përpara, por që ta durojë “vetëm për një periudhë të arsyeshme” – dhe bëj që periudha e arsyeshme të jetë më e shkurtër sesa ka mundësi të zgjasë prova. Nuk ka nevojë të jetë shumë më e shkurtër; në sulmet mbi durimin, dëlirësinë dhe qëndresën, e bukura është ta bësh pacientin të dorëzohet pikërisht në çastin (ndonëse ai nuk e di), kur çlirimi ishte thuajse aty.

Nuk e di nëse ka mundësi që ta takojë të dashurën nën këto kushte shtrëngimi. Nëse po, përdore sa të mundësh

gurin që ke në dorë, se deri në njëfarë pike, lodhja i bën gratë të flasin më tepër, kurse burrat të flasin më pak. Një fyerje e brendshme, e pashprehur, mund të lindë nga kjo, edhe mes të dashuruarve.

Skenat që po përjeton pacienti tani, vështirë të sigurojnë material për një sulm *intelektual* kundër besimit të tij – për shkak të dështimeve të tua të mëparshme, nuk ke më pushtet mbi këtë gjë. Por, mund të provosh ende një lloj sulmi mbi emocionet e tij. Duhet ta bësh të ndiejë, kur të shikojë për herë të parë mbetje të trupave njerëzore të ngjitura pas mureve, se “kjo është bota *reale*” dhe se e gjithë feja e tij ka qenë një fantazi. Do të vëresh se i kemi zhytur në një mjegull të plotë për sa i përket domethënies së fjalës “reale”. Kur flasin me njëri-tjetrin për ndonjë përjetim të madh shpirtëror, ata thonë “Ajo që ndodhi *realisht* është se dëgjove tinguj muzikorë në një ndërtesë të ndriçuar”; këtu, fjala “realisht” nënkupton thjesht fakte fizike, të ndara nga elementet e tjerë që në fakt përjetuan njerëzit. Nga ana tjetër, njerëzit mund të thonë: “Duket e lehtë kur diskuton për atë hedhje nga lartësia e madhe ndërsa je ulur në karrige, por ngjitu njëherë dhe atje ke për ta parë se çfarë është *realisht*”: këtu fjala “realisht” është

përdorur në kuptimin e kundërt, për të nënkuptuar jo faktet fizike (të cilat ata i dinë tashmë që kur diskutojnë për çështjen nga karriget), por për efektin emocional të këtyre fakteve mbi ndërgjegjen njerëzore. Të dyja aplikimet e kësaj fjale mund të mbrohen; por detyra jonë është t'i mbajmë të dyja paralel në mënyrë që vlera emocionale e fjalës “reale” të mund të përdoret, herë për njërën anë të çështjes, herë për tjetrën, në varësi të interesit tonë. Rregulli i përgjithshëm, që tani e kemi përcaktuar mjaft mirë mes tyre, është se nga të gjitha përjetimet të cilat mund t'i bëjnë më të lumtur ose të ndihen më mirë, vetëm faktet fizike janë “reale”, ndërsa elementet shpirtërore janë “subjektive”; përkundrazi, në të gjitha përjetimet që mund t'i dekurajojnë ose korruptojnë, elementet shpirtërore janë realiteti kryesor dhe, nëse i anashkalon, atëherë je dezertor. Kështu, gjatë lindjes, gjaku dhe dhimbja janë “reale”, ndërsa gëzimi është thjesht një këndvështrim subjektiv; në çastin e vdekjes, tmerri dhe shëmtia nxjerrin “kuptimin real” të saj. Urrejtja kundër një njeriu të urreyer është “reale” – në urrejtje i shikon njerëzit siç janë, pa iluzione; por bukuria e një njeriu të dashur është thjesht një mjegullim subjektiv që fsheh thelbin “real” të ndonjë

oreksi seksual ose interesi ekonomik. Luftërat dhe varfëria janë “realisht” të tmerrshme; paqja dhe bollëku janë thjesht fakte fizike për të cilat njerëzit rastisin të kenë ndjenja të caktuara. Këto krijesa e akuzojnë gjithmonë njëra-tjetrën se po përpiqen “të kenë edhe mish, edhe peshk”; por falë punës sonë, ajo që ndodh më shpesh është se ata i paguajnë të dyja pa ngrënë asnjërën. Pacienti yt, nëse do ta trajtosh siç duhet, nuk do ta ketë të vështirë ta mendojë ndjenjën e tij, kur shikon trupa të gjymtuar njerëzorë, si shfaqje të Realitetit, ndërsa emocionin kur përballlet me fëmijë të lumtur, apo një ditë me mot të mirë ta konsiderojë thjesht si diçka sentimentale.

Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

I dashuri, shumë i dashuri im Krimbaq, vogëlushi im, derrkuci im,

Sa keq që, pasi ke humbur gjithçka, vjen dhe më pyet nëse ishin ndopak të vërteta të gjitha ato fjalë të ngrohta me të cilat të jam drejtuar që në fillim. Patjetër që po! Mos e vrit mendjen fare, dashuria ime për ty dhe dashuria jote për mua janë brumë nga i njëjti miell. Unë gjithmonë të kam dashur, ashtu siç më ke dashur dhe ti (o torollak i mjerë). Ndryshimi i vetëm është se unë jam më i forti. Mendoj se tani ti më përket mua, ose të paktën, një pjesë e jotja. Më pyet nëse të dua? Patjetër që po. Po aq sa dhe kafshatat e tjera të shijshme falë të cilave kam vënë dhjamë.

Ti lejove të të ikte nga duart një shpirt njerëzor. Ulërima e urisë së skajshme për këtë humbje po ushton në këto çaste në të gjitha nivelet e Mbretërisë së Zhurmës, deri në thellësinë e vetë Fronit. Thjesht kur e mendoj, tërbohem. E kam shumë të qartë se çfarë ndodhi, në

çastin kur ata ta rrëmbyen nga duart! Pati një qartësi të befasishme në sy (apo jo?) kur të pa për herë të parë, duke kuptuar ndikimin që kishe pasur në jetën e tij dhe duke ditur se tani nuk e kishe më. Thjesht mendo (dhe le të jetë ky fillimi i agonisë sate) se çfarë ndjeu ai në ato momente; sikur t'i kishte rënë korja e ndonjë plagë e vjetër, ose sikur të kishte shpëtuar nga një sëmundje lëkure, e neveritshme, si të kishte dalë prej guaskës, sikur të kishte hequr nga shpina një herë e mirë një rrobë të ndyrë, të lagur që e kishte pasur të ngjitur në trup. Për atë Ferr, unë nuk i duroj dot kur i shoh gjatë përditshmërisë së tyre në tokë kur heqin rrobat e pista dhe të parehatshme, zhyten në ujin e ngrohtë të vaskës dhe lëshojnë grahma të befta kënaqësie – duke u shtritur sa gjatë e gjerë. Si mund ta duroj këtë zhveshje të fundit, këtë pastrim të plotë?

Sa më tepër ta mendosh, aq më keq duket. Ia hodhi paq kaq lehtë! Pa asnjë brejtje graduale të ndërgjegjes, pa përballje me doktorë, pa spital, pa sallë operacioni, asnjë shpresë të rreme për jetën; një çlirim i menjëhershëm dhe i pastër. Për një moment u duk sikur bota ishte e gjitha e jona; shpërthimi i bombave, rënia e shtëpive, shija dhe

kutërbimi i eksplozivit në buzë dhe në mushkëri, këmbët që digjeshin nga lodhja, zemra që ftohej nga tmerret, truri që vinte vërdallë, këmbët që dhimbnin; dhe pas një çasti, gjithçka mbaroi, u zhduk si një ëndërr e keqe, sikur nuk ka ekzistuar kurrë. Ta hodhi, o dështak i trashë! E vure re sa natyrshëm hyri në jetën e re – sikur të ishte lindur për të – ai krimbi i lindur në tokë? E pe sesi dyshimet e tij, sa hap e mbyll sytë, iu dukën qesharake? Unë e di se ç’po thoshte ai me vete! “Po. Sigurisht. Gjithmonë kështu ka qenë. Të gjitha tmerret kanë ndjekur të njëjtën rrugë. Ato bëhen gjithnjë e më keq dhe të detyrojnë të arrish në një ngushticë të fortë dhe, pastaj, në çastin kur mendon se do të të shtypin, ja! menjëherë del nga ngushtica dhe papritmas gjithçka është mirë. Heqja e dhëmbit shkakton dhimbje derisa ai del. Makthi përfundon kur zgjohesh. Ti vdes e pastaj kalon përtej vdekjes. Si mund të kemi dyshuar për këtë vallë?”

Siç të pa ty, pa edhe Ata. E marr me mend si ndodhi. Ti u zmbropse i shtangur dhe i verbuar, i goditur më tepër prej tyre sesa ai nga bombat. Sa poshtëruese! Kjo gjë prej balte e dheu të qëndrojë drejt dhe të bisedojë me shpirtra, përpara të cilëve ty, një shpirti, t’u desh të

kërruseshe! Mbase shpresojë se frika e përzier me nderim dhe mahnitja e paprovuar e atij çasti do t'ia kishte shuar gëzimin. Por këtu qëndron i gjithë mallkimi; perënditë janë të çuditshëm për sytë e vdekatarëve, por Ata nuk janë të tillë. Deri në atë moment, ai nuk e kishte fare idenë sesi do t'i dukeshin Ata, madje dyshonte për ekzistencën e tyre. Por kur i pa me sy, e kuptoi se i kishte njohur gjithmonë dhe se ç'pjesë kishte luajtur secili prej tyre në shumë çaste të jetës, kur ai kishte menduar se ishte i vetëm. Pikërisht për këtë, tashmë ishte në gjendje t'i drejtohej secilit prej tyre, jo me “Kush je ti?”, por, “Paske qenë ti gjatë gjithë kohës!” Gjithçka pa dhe dëgjoi në atë takim, i zgjoi kujtime. Kujtimet e vagullta të miqve që i ishin gjendur pranë në çastet e vetmisë që nga fëmijëria, tani më në fund morën shpjegim; ajo muzikë që e kishte shoqëruar në çdo përjetim të pastër e që i ishte zbehur nga kujtesa, tani iu kthye sërish. Në çastin që i njohu, ai u çlirua prej pranisë së tyre, përpara se t'i binin në qetësi gjymtyrët e trupit. Vetëm ti mbete jashtë.

Ai nuk pa vetëm Ata; ai pa Atë. Kjo shtazë, kjo gjë e lindur në një shtrat, mund të vështronte Atë. Ajo që për ty është zjarr verbues dhe mbytës, për të është tani dritë

e freskët, është qartësi e plotë; dhe ka veshur formën e një Njeriu. Sikur të mundeshë, do të të pëlqente ta interpretoje gjunjëzimin e pacientit para kësaj Pranie, ndjenjën e neverisë për veten dhe njohurinë e plotë të mëkateve të tij (po, Krimbaq, një njohuri më e qartë se e jotja), duke e krahasuar me ato ndjenjat e tua mbytëse dhe paralizuese kur ndeshesh me ajrin vdekjeprurës që vjen nga zemra e Qiellit. Por e gjitha kjo është marrëzi. Edhe po t'u duhet të përballen me dhimbje, ata janë gati t'i *pranojnë* ato. Ata nuk do t'i shkëmbenin ato me asnjë kënaqësi tokësore. Të gjitha kënaqësitë e shqisave, zemrës, ose intelektit me të cilat dikur e ke tunduar njeriun, madje dhe gëzimet e vetë virtytit, tani për të janë të krahasueshme (madje edhe më pak të vlefshme) me joshjet që një prostitutë e pështirë i bën një burri në momentin kur dëgjon se e dashura e tij e vërtetë, të cilën e ka dashur gjithë jetën dhe e mendonte të vdekur, është në fakt gjallë, madje po qëndron te pragu i shtëpisë së tij. Ai tani është zhytur plotësisht në atë botë ku dhimbja dhe kënaqësia marrin vlera të pakufishme ndërsa e gjithë aritmetika jonë del e kotë. Sërish na duhet të përballemi me të pashpjegueshmen. Përveç mallkimit të tunduesve

të pavlerë si puna jote, mallkimi ynë më i madh është dështimi i Departamentit tonë të Inteligjencës. Sikur të mund ta gjenim se çfarë ka vërtet në mendje Armiku! Për fat të keq, kjo njohuri kaq e urryer dhe e pështirë në vetvete, është kaq e domosdoshme për të fituar Pushtetin! Ndonjëherë, edhe unë vetë gati dëshpërohem. Por ajo që më mban të fortë është bindja se Realizmi ynë, refuzimi ynë (në përballje me të gjitha tundimet) i çdo gjëje të marrë dhe çdo budallallëku, *duhet* të fitojë në fund patjetër. Ndërkaq, nuk kam mbaruar ende punë me ty. Me shumë sinqeritet po firmos vetë.

Me një uri të pashuar,
Xhaxhai yt i dashur,
HIRZIU

HIRZIU
NGRE NJË DOLLI

PARATHËNIE

C. S. Lewis e përfundoi mbledhjen e këtij libri pak para vdekjes së tij më 22 nëntor, 1963. Ai i kushtohet pothuajse plotësisht besimit dhe pjesët e tij janë mbledhur nga burime të ndryshme. Disa prej tyre janë botuar në *Më Kërkuan një Punim* (Geoffrey Bles, Londër 1962), një përmbledhje me tema që përfshinin letërsi, etikë dhe teologji. “Hirziu ngre një dolli” u botua fillimisht në Britaninë e Madhe, si pjesë e një libri, të titulluar *Letrat e Hirziut dhe Hirziu Ngre një Dolli* (Geoffrey Bles, Londër 1962). Ai përmbante origjinalin e “Letrat e Hirziut”, bashkë me “Dollinë”, si dhe një parathënie të re nga Lewis. Ndërkohë, “Hirziu ngre një dolli” ishte botuar më herët në Shtetet e Bashkuara, së pari si artikull te *The Saturday Evening Post* dhe, më vonë, gjatë vitit 1960, në një libër me histori, *The World's Last Night* (Harcourt Brace and the World, Nju Jork).

Në parathënien e re për *Letrat e Hirziut dhe Hirziu*

Ngre një Dollli, të cilën po e përfshijmë në këtë libër, Lewis-i shpjegon ngjizjen e idesë dhe realizimin e “Dollisë”. Do të ishte gabim i madh ta quanim këtë fjalim “një tjetër letër e Hirziut”. Ajo që ai e përshkruan si teknikë të ‘ventrilokuizmit’ djallëzor’ është në të vërtetë ende aktuale: ajo që është e bardhë për Hirziun, është e zezë për ne dhe ajo që i pëlqen atij, ne duhet të na tmerrojë. Por, ndonëse forma e atjeshme është e pranishme edhe te ky fjalim, ngjashmëria me *Letrat* përfundon këtu. Ato kishin të bënin më tepër me jetën morale të individit; ndërsa tek “Dollia”, thelbi i qëllimit të tij është nxitja për kujdes dhe vëmendje ndaj edukimit të mendjes së vajzës dhe djalit të ri.

“Më shkau goja” (predikim i mbajtur në kishëzën e Magdalen College) shfaqet në formë libri për të parën herë. “Rrethi i brendshëm” ishte një fjalim përkujtimor i mbajtur në King’s College, Universiteti i Londrës, 1944; “A është teologjia poezi?” dhe “Mbi këmbënguljen në Besim” ishin të dyja punime të lexuara para Klubit Sokratik dhe më vonë u botuan për herë të parë në ‘Socratic

1 Ventrilokuizëm: Të folurit nga stomaku (Nga latinishtja). (Shënim i redaktorit.)

Digest' më 1944 dhe pastaj më 1955. "Zhvendosja" është version paksa më i plotë i një predikimi të mbajtur në Mansfield College, Oksford; ndërsa "Pesha e Lavdisë" është një predikim i mbajtur në Kishën e Virgjërshës Shën Mari, Oksford, dhe u botua së pari nga SPCK². Të pesta këto punime u botuan me leje te *Më kërkuan një punim*. "Vepra e Mirë dhe Veprat e Mira" u botuan për të parën herë te Gazeta *The Catholic Art Quarterly* dhe pastaj te *The World's Last Night*.

Në fund të parathënies së *Më kërkuan një punim*, Lewis-i shkroi: "Meqë këto shkrime u hartuan në kohë të ndryshme gjatë njëzet viteve të fundit, pasazhet në to, të cilat disa lexuesve mund t'u kujtojnë pjesë të mëvonshme të punës sime, janë faktikisht më të hershme dhe u paraprijnë të tjerave. I lejova vetes bindjen se mbivendosje të tilla nuk mund të bëheshin pengesë për ribotimin e tyre". Ne jemi të lumtur që Lewis-i ia lejoi vetes të bindej në të njëjtën mënyrë për të përmbledhur këto punime me tematikë fetare.

J. E. G.

2 SPCK: Society for Promoting Christian Knowledge (Shoqëria për Promovimin e Njohurive të Krishtera). (Shënim i redaktorit.)

HIRZIU NGRE NJË DOLLI

Shpesh më kanë kërkuar, ose këshilluar t'i zgjeroja “Letrat” origjinale të Hirziut, por për vite të tëra nuk kam ndier as nevojën më të vogël për ta bërë këtë. Ndonëse nuk kam shkruar asgjë tjetër më lehtë, asgjë tjetër nuk e kam shkruar me aq pak kënaqësi. Pa dyshim, lehtësia vinte nga fakti se, sapo e ndan mendjen për të menduar sipas stilit të letrave djallëzore, ato shtjellohen vetvetiu spontanisht, njëllor si gjigantët ose xhuxhmaxhuxhët e Swift-it, apo filozofia etike dhe mjekësore e “Erewhon”-it, apo Garuda Stone e Anstey-it. Mjafton të fillosh, dhe mund të shkruash me mijëra faqe mbi këto çështje. Por, ndonëse ishte e lehtë të futesha përmes mendimeve në qëndrimin djallëzor, nuk ishte argëtuese, të paktën jo për një kohë të gjatë. Ky sforcim më krijoi një lloj ngërçi shpirtëror. Bota në të cilën m'u desh ta lëshoja veten teksa flisja përmes Hirziut, ishte plot pluhur, pisllëk, etje dhe zgjebe. Çdo gjurmë bukurie, freskie dhe mirëdashjeje

duhej lënë jashtë. Kjo gjë pothuajse më mbyti përpara se ta mbaroja. Po ta kisha zgjatur më tepër, do t'i kisha mbytur edhe lexuesit.

Përveç kësaj, kisha dhe një lloj inati me librin tim sepse nuk ishte një libër i veçantë të cilin askush nuk mund ta shkruante. Idealja do të kishte qenë që këshillat e Hirziut për Krimbaqin të ishin shoqëruar krah për krah me këshillat kryeengjëllore për engjëllin mbrojtës të pacientit. Pa këtë, pamja e jetës njerëzore paraqitet e njëanshme, e paplotë. Por kush do të mund ta plotësonte këtë mangësi? Edhe nëse ndokush – dhe do të kishte qenë burrë shumë më i mirë se unë – do t'ia dilte mbanë t'u ngjitej lartësive shpirtërore të nevojshme, çfarë “stili përgjigjesh” do të përdorte? Sepse stili në të vërtetë do të duhej të ishte pjesë e përmbajtjes. Thjesht këshillat nuk do të bënin punë; çdo fjali duhet të mbante erë Parajsë. Dhe, në ditët e sotme, edhe sikur të jetë dikush në gjendje të shkruajë prozë si ajo e Traherne-it, nuk do të lejohej ta bënte, sepse kanuni i “funksionalizmit” i ka gjymtuar gjysmën e funksioneve të letërsisë. (Në thelb, çdo stil ideal dikton jo vetëm mënyrën se si duhet t'i themi gjërat, por edhe çfarë gjërash duhet të themi.)

Pastaj, me kalimin e viteve dhe me venitjen në kujtesën time të përvojës mbytëse kur shkrova “Letrat”, më erdhën në mendje reflektime të ndryshme në lidhje me një kërkesë për të bërë një trajtim sipas stilit të Hirziut. E kisha ndarë mendjen të mos shkruaja kurrë më një tjetër “Letër”. Ideja e diçkaje të ngjashme me një leksion, apo “fjalim” më rrinte pezull në mendje, herë e harruar, herë e kujtuar, pa e hedhur në letër. Pastaj më erdhi një ftesë nga *The Saturday Evening Post*, dhe kjo e shkrepiti këmbëzën.

C. S. L.

Skena zhvillohet në Ferr, në darkën e përvitshme që organizon Shkolla e Trajnimit të Tunduesve për Djajtë e rinj. Drejtori, Dr. Gojëlëmshi, sapo ka ngritur një dolli për shëndetin e të ftuarve. Hirziu, i cili është i ftuar nderi, ngrihet për t'u përgjigjur:

Z. Drejtor, Poshtëmadhëria juaj, Turpmëdhenj, Gjemba, Hije dhe Djallushë: Zakoni e do që, në të tilla raste, folësi duhet t'u drejtohet kryesisht atyre që sapo janë diplomuar dhe atyre që shumë shpejt do të dërgohen me kontrata zyrtare Tundimi në Tokë. Unë do ta zbatoj me shumë kënaqësi këtë zakon. Më kujtohet mjaft mirë se me sa frikë e kam nisur detyrën time të parë. Shpresoj dhe besoj se secili prej jush ka të njëjtën trazirë në shpirt sonte. Ju e keni gjithë karrierën përpara. Ferri pret dhe kërkon që ajo të jetë – siç ishte e imja – një karrierë suksesi pa ndërprerje. Nëse nuk është e tillë, e dini se çfarë ju pret.

Nuk dua ta zvogëloj elementin realist dhe aq të dobishëm të tmerrit, ankthit të paqetësueshëm, i cili duhet të shërbejë si kamxhik dhe mamuze për përpjekjet tuaja.

Sa shpesh do t'i keni zili njerëzit, të cilët kanë mundësinë të flenë! Megjithatë, në të njëjtën kohë, dua t'ju parashtoj një pikëpamje paksa inkurajuese të situatës strategjike në përgjithësi.

Drejtori juaj i tmerrshëm përmendi në fjalimin plot me çështje të rëndësishme edhe një kërkesë faljeje për banketin që na ka shtruar. Për këtë, djallushët e mi, askush nuk e bën me faj *atë*. Veçse nuk e mohojmë dot se shpirtrat njerëzorë, me ankthin e të cilëve jemi ngopur sonte ishin të një cilësie shumë të dobët. Me gjithë zotësinë në kuzhinë, torturuesit tanë nuk ia kanë dalë t'u japin ndopak shije.

Ah, sikur të kishim mundësi t'i ngulnim dhëmbët sërish mbi ndonjë shpirt të llojit të Farinatës, Henrit VIII, apo Hitlerit! Ata po që kishin shije; kishim se çfarë të përtypnim; zemërim, egoizëm dhe mizori të cilave ua kalojnë vetëm tonat. Edhe ne vetë donim ta zgjatnim sa më tepër kullufitjen e tyre. Ta ngrohnin stomakun kur i kapërdije.

Por në vend të tyre, çfarë kemi përpara sonte? Kemi një zyrtar komune shoqëruar me salcë Ryshfetçiu. Megjithatë, unë personalisht nuk mund të gjej tek ai

shijen e kopracisë aq pasionante dhe brutale që gjenim te pasanikët e mëdhenj të shekullit të kaluar. Qofsha i gabuar, por, a nuk ishte ai një Njeri i Vockël – një krijesë nga ata që pasurohen me grabitje të vogla, që gënjehej me një kurth mjeran në rrethin shoqëror dhe që turpërohej për shkak të fjalimeve të tij të rëndomta në publik – një mosqenie e vogël, e pështirë që ra në korrupsion, dhe vonë e kuptoi që ishte i korruptuar, kryesisht ngaqë të gjithë të tjerët kishin rënë në korrupsion? Pastaj kishim për darkë edhe Tavën e vakët të Kuroreshkelësve. A gjetët vallë ndonjë thërrime epshi të ndezur plotësisht, kryeneç, provokues dhe të pashueshëm? Unë jo. Të gjithë ata m'u dukën nga shija si ca hajvanë të dhënë pas aventurave të vockla seksuale, të cilët janë endur verbërisht duke u gjendur në shtretër të gabuar si reagim i çastit ndaj reklamave seksi, ose për ta ndier veten modernë dhe të emancipuar, ose për ta siguruar veten për aftësinë seksuale, apo për "normalitetin" e tyre, ose sepse nuk kishin diçka tjetër për të bërë. Singerisht, për mua që kam shijuar Mesalinën dhe Kazanovën, ata m'u dukën fare bajatë. Ndoshta Sindikalisti me garniturë fodullëku ishte pak më i shijshëm se të tjerët. Ai kishte shkaktuar

disa dëme reale. Me vetëdije ai ka punuar për gjakderdhje, zi buke dhe mohim të lirisë. Po, në njëfarë mënyre. Dhe çfarë mënyre! Ai mendonte fare pak për këto objektiva finalë. Ato që mbizotëronin vërtet në jetën e tij ishin kujdesi për të ruajtur vijën e partisë, rëndësia e vetvetes, dhe mbi të gjitha, rutina.

Por tani vjen dhe pika më e rëndësishme. Nga ana gastronomike, e gjitha kjo është për të vënë kujen. Gjithsesi, shpresoj se asnjëri prej nesh nuk do ta vlerësojë gastronominë më tepër sesa duhet. Sepse, a nuk është darka e sotme, nga ana tjetër shumë më serioze, plot me shpresë dhe premtime?

Merrni në konsideratë, së pari, thjesht sasinë e darkës. Cilësia mund të jetë e tmerrshme; por kurrë më parë nuk kemi pasur shpirtra (nëse mund të quhen të tillë), kaq me bollëk.

Dhe pastaj vjen triumfi. Ndoshta tundohemi të themi se të tillë shpirtra – ose këto lëtyra, mbetje të asaj që më parë kishte qenë shpirt – nuk ia vlejnë as të dënohen. Po, por Armiku (për çfarëdolloj arsyeje të pashqyrtuar dhe të shthurur) i konsideroi të denjë, aq sa të përpiquej t'i shpëtonte. Më besoni, Ai vërtet mendoj kështu. Ju, të

rinjtë, që ende nuk e keni filluar shërbimin aktiv, nuk e keni idenë se me çfarë mundimesh, me çfarë mjeshtërie delikate ia dolëm ta kapnim secilën prej këtyre krijesave të mjera.

Vështirësia qëndronte në dobësinë dhe brishtësinë e tyre. Kishim të bënim me krimba kaq të pështjelluar në mendje, kaq pasivë në reagimin ndaj mjedisit, sa që ishte shumë e vështirë t'i ngrije në atë nivel qartësie dhe qëllimshmërie nga ku mund të realizohej mëkati vdekjeprurës. Detyra ishte t'i çonim aq lart sa duhet; por asnjë milimetër më tepër, çka do të ishte fatale. Sepse në atë rast, me shumë mundësi, do të kishim humbur gjithçka. Ata do t'i kishin parë gjërat siç janë dhe mund të ishin penduar. Nga ana tjetër, nëse do t'i ngrinin më pak sesa duhet, ndoshta ata do të ishin kualifikuar për të shkuar në një gjendje pasigurie, as në Qiell, as në Ferr; kështu do të konsideroheshin si krijesa që, pasi nuk e morën dot klasën, do të lejoheshin të zhyteshin në një gjysmë-humanizëm ku do të gjenin pak a shumë kënaqësi.

Në çdo zgjedhje individuale të asaj që Armiku e quan kthesë “të gabuar”, këto lloj krijesash në fillim janë fare pak, për të mos thënë aspak përgjegjëse nga ana

shpirtërore. Ata nuk e kuptojnë as burimin, as karakterin e vërtetë të shkeljeve që po kryejnë. Ndërgjegjia e tyre nuk mund të mos ndikohet nga atmosfera shoqërore që i rrethon. Dhe sigurisht, ne kemi bërë që madje edhe gjuha e tyre të jetë e turbullt dhe plot paqartësi; ajo që quhet *ryshfet* në profesionin e disave, në gjuhën e të tjerëve quhet *bakshish* ose *dhuratë*. Detyra e parë e Tunduesve të tyre ishte t'i nxitnin që këto zgjedhje të merrnin drejtimin e Ferrit derisa të ktheheshin në një zakon, përmes përsëritjeve të vazhdueshme. Por, më pas (dhe kjo është shumë e rëndësishme), duhet ta kthenin zakonin në parim – në një lloj parimi që krijesa është e përgatitur ta mbrojë. Pas kësaj, gjithçka do të shkojë mirë. Konformizmi ndaj mjedisit shoqëror, ndonëse në fillim është thjesht instiktiv ose mekanik (a nuk merr formë *xhelatina* sipas enës ku e hedh?), më vonë kthehet në një kredo, apo ideal të pashprehur të Bashkësisë, apo të të Qenit si të Tjerët. Mosnjohja e thjeshtë e ligjit që po thyejnë, shpejt kthehet në një teori të mjegullt për ligjin (mos harroni që ata nuk ia kanë fare idenë historisë). Kjo duket nga mbiemrat që i vendosin për ta përcaktuar atë si: “moral” *konvencional*,

puritan ose *borgjez*. Kështu, në qendër të krijesës fillon të formësohet gradualisht një bërthamë e fortë, e vogël dhe e qëndrueshme vendosmërie për të vazhduar ashtu siç ka qenë, dhe madje u reziston edhe atyre gjendjeve shpirtërore të cilat priren ta ndryshojnë. Kjo bërthamë është shumë e vogël; aspak e mirëmenduar (sepse ata janë trokë nga mendja), as sfiduese (varfëria e tyre në emocione dhe imagjinatë e përjashton këtë mundësi); dhe gjoja e palëvizshme dhe e përmbajtur; si një lloj guraleci, ose si një kancer i sapoformuar. Por ajo do na bëjë punë. Përfundimisht, këtu kemi një refuzim real dhe të vullnetshëm, ndonëse jo të shprehur qartë, ndaj asaj që Armiku e quan Hir.

Këto, pra, janë dy fenomene të mirëpritura. Së pari, numri i lartë i robërve tanë; sado pa shije të jenë, nuk rrezikojmë të vdesim urie. Dhe së dyti, triumfi; mjeshtëria e Tunduesve tanë nuk ka qenë kurrë më e lartë. Por ka edhe një fenomen të tretë, të cilin nuk e kam cekur ende, i cili është më i rëndësishmi nga të gjithë.

Lloji i shpitrave, me dëshpërimin dhe shkatërrimin e të cilëve jemi ushqyer sonte (nuk po them se jemi ngopur), po rritet në numër dhe do të vazhdojë të rritet.

Udhëzimet nga Komanda jonë e Ulët na sigurojnë se kështu do të ndodhë me siguri; direktivat na bëjnë thirrje t'i orientojmë të gjitha taktikat në përshtatje me këtë situatë. Mëkatarët “e mëdhenj”, pasionet e gjalla dhe të mira të të cilëve i kemi larguar përtej kufijve të arritshëm prej tyre dhe vullneti i të cilëve është përqendruar thellë tek objekte të cilat Armiku i urren, nuk do të zhduken. Por, ama, ata do të vijnë duke u pakësuar. Gjahu ynë do të jetë gjithmonë dhe më i shumtë; por do të përbëhet kryesisht prej mbeturinash – mbetje që dikur do t'ia kishim hedhur Cerberit dhe qenve të ferrit për t'i ngrënë sepse nuk mund të konsideroheshin të denjë për t'i ngrënë djajtë. Dhe ka dy gjëra që dua të kuptoni nga kjo. Së pari, sado dëshpëruese që mund t'ju duket, ky ndryshim është, në fakt, për mirë. Dhe së dyti, dua ta fiksoni vëmendjen te metodat që kemi përdorur për t'i sjellë punët deri këtu, në këtë gjendje.

Ky ndryshim është për mirë. Mëkatarët e mëdhenj (dhe të shijshëm) përbëhen nga po ai material që përbëhen edhe ato fenomene të tmerrshme që quhen Shenjtorë të mëdhenj. Zhdukja e plotë e këtij materiali do të thotë që ne do të hamë vakte bajate. Por, nga ana tjetër, a nuk do të

shkaktojë uri dhe dëshpërim për Armikun? Ai nuk i krijoi njerëzit - dhe nuk u bë vetë njeri dhe vdiq nga tortura para syve të tyre – për të prodhuar kandidatë për gjendjen e Pasigurisë; pra, që të bëhen njerëz “dështakë”. Ai dëshironte t’i kthente në Shenjtorë; perëndi; të ngjashëm me Vetën e Tij. A nuk është mungesa e shijes së ushqimit tuaj një çmim shumë i vogël për t’u paguar, krahasuar me lajmin e shijshëm se i gjithë eksperimenti i Tij i madh po merr fund? Por jo vetëm kaq. Ndërkohë që mëkatarët e mëdhenj pakësohen gjithnjë e më tepër dhe pjesa dërrmuese e njerëzve e humbet individualitetin, ata pak mëkatarë të mëdhenj bëhen agentë shumë më të frytshëm për ne. Çdo diktator, apo demagog – çdo yll kinemaje, apo këngëtar – tani mund të tërheqë me vete dhjetëra mijëra dele njerëzore. Ata ia dorëzojnë veten këtyre njerëzve (apo asaj që ka mbetur prej tyre); dhe në këtë mënyrë, na dorëzohen neve. Mund të vijë një kohë kur të mos na duhet të merremi me tundimet *individuale*, përveçse në ndonjë rast të rrallë. Kape dashin që prin kopenë dhe e gjithë tufa do të të vijë vetë pas.

Por a e kuptoni si ia kemi dalë t’i katandisim kaq keq anëtarët e racës njerëzore sa të flitet për ta vetëm në nivelin

e shifrave? Kjo nuk ndodhi rastësisht, por ka qenë përgjigja jonë (dhe ishte një përgjigje e shkëlqyer) ndaj njëres prej sfidave më serioze që na është dashur të përballojmë.

Më lejoni t’ju rikujtoj cila ishte situata njerëzore në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë – periudhë gjatë së cilës mbarova praktikën si Tundues dhe u shpërbleva me një post administrativ. Lëvizja e madhe drejt lirisë dhe barazisë njerëzore, në atë kohë, kishte filluar të prodhonte fryte të qëndrueshme dhe të pikej. U hoq skllavëria. Lufta Amerikane për Pavarësi u fitua. Revolucioni Francez doli me sukses. Toleranca fetare ishte pothuajse kudo në rritje. Në këtë lëvizje, në fillim kishte shumë elementë që ishin në favorin tonë. Brenda saj ishin përzier Ateizmi, Antiklerikalizmi, smira dhe etja për hakmarrje, si dhe disa përpjekje (tepër absurde) për të ringjallur paganizmin. Nuk ishte e lehtë të përcaktonim qëndrimin që duhet të mbanim ne. Nga njëra anë, ishte një goditje e hidhur për ne – dhe ende mbetet e tillë – që çdo njeri që kishte qenë i uritur, tani do mund të ushqehet, ose që kushdo që kishte mbajtur pranga për një kohë të gjatë, tani kishte mundësinë të çlirohej prej tyre. Por, nga ana tjetër, kjo lëvizje sillte me

vete refuzim të madh të besimit, materializëm, laicizëm dhe urrejtje, saqë menduam se ishim të detyruar ta mbështetnim.

Ndërsa, në pjesën e dytë të shekullit, situata u bë shumë më e thjeshtë, por edhe shumë më kërcënuese. Në sektorin anglez (ku kreu pjesën më të madhe të shërbesës sime në vijën e frontit), ndodhi diçka e tmerrshme. Armiku, me marifetet e tij të zakonshme, e bëri të vetën këtë lëvizje progresive dhe liberalizuese dhe e deformoi për qëllimet e Tij. Mbeti shumë pak nga anti-krishtërimi i saj i parë. Ky fenomen i rrezikshëm, i quajtur Socializëm i Krishterë, u përhap shumë. Pronarët e fabrikave të tipit të vjetër, të cilët ishin pasuruar me djersën e ballit, në vend që të vriteshin nga vartësit e tyre – kjo po që do të na kishte ndihmuar – tani po shiheshin me sy të keq nga vetë klasa e tyre. Gjithmonë e më tepër, të pasurit filluan të hiqnin dorë nga një pjesë e pushtetit të tyre, jo për shkak të revolucionit ose se ishin të detyruar, por si bindje ndaj ndërgegjes. Ndërsa të varfrit që përfituan prej kësaj filluan të silleshin në një mënyrë shumë zhgënjyese. Në vend që t'i shfrytëzonin liritë e reja – siç shpresonim dhe prisnim ne, normalisht – për të kryer masakra,

përdhunime dhe plaçkitje, ose të zhyteshin në dehje të përditshme, ata filluan të ngulmonin me përkushtim drejt pastërtisë, të bëheshin më të rregullt, më nikoqirë, më të edukuar dhe madje më të virtytshëm. Më besoni, djallushë, kërcënimi i një gjendjeje vërtet të shëndetshme të shoqërisë dukej shumë serioz në atë kohë.

Megjithatë, falë Atit tonë Atje Poshtë, edhe ky kërcënim u shmang. Kundërsulmi ynë u përqendrua në dy nivele. Në nivelin më të thellë, lojtarët tanë u përpoqën t'i jepnin jetë një elementi që kishte qenë i fshehur në lëvizje që nga ditët e para. Në zemër të kësaj përpjekjeje për Liri fshihej një urrejtje e thellë kundër lirisë personale. I pari që e zbuloi këtë ishte Rusoi, njeri jashtëzakonisht i dobishëm. Po ta mbani mend, në demokracinë e tij të përkryer lejohet vetëm feja shtetërore, skllavëria kthehet në fuqi, dhe individ i nxitet të besojë se e ka dashur vërtet (ndonëse nuk e ka ditur) gjithçka që Qeveria i thotë të bëjë. Nga kjo pikë fillestare, *duke vazhduar me* Hegelin (një tjetër propagandist i domosdoshëm në anën tonë), ne ia dolëm të shpiknim shtetin nazist dhe komunist. Edhe në Angli patëm shumë sukses. Dje dëgjova se në këtë vend, njerëzit nuk mund të prisnin as pemën e kopshtit

me sëpatën e tyre, as ta bënin dërrasa me sharrën e tyre dhe as t'i përdornin dërrasat për të ndërtuar ndonjë kasolle në kopshtin e tyre, pa marrë leje më parë.

I tillë ishte sulmi ynë në një nivel. Ju, që jeni thjesht fillestarë, nuk mund t'ju besohet punë e këtij lloji. Ju do të caktoheni si Tundues personalë të njerëzve. Kundër njerëzve si individë, ose përmes tyre, kundërsulmi ynë merr tjetër formë.

Demokracia është karremi me të cilin duhet t'i tërhiqni njerëzit për hunde. Puna e mirë që kanë kryer ekspertët tanë filologë për korruptimin e gjuhës njerëzore e bën të panevojshme t'ju paralajmëroj se nuk duhet t'i lejoni kurrë njerëzit ta përdorin këtë fjalë me një kuptim të qartë dhe të përcaktuar. Ata nuk do ta bëjnë diçka të tillë. Nuk do t'u shkojë kurrë ndërmend se *Demokracia* është faktikisht emri i një sistemi politik, madje një sistem votimi, dhe se kjo s'ka pikë lidhje me atë që u shisni ju. Gjithashtu, nuk duhet t'i lejoni kurrë të bëjnë pyetjen e Aristotelit: A nënkupton "Sjellja demokratike" sjelljen që demokracitë pëlqejnë, apo sjelljen që do të ruajë demokracinë? Sepse, nëse do ta bënin këtë pyetje, vështirë të mos e kuptojnë se ato nuk janë e njëjta gjë.

Duhet ta përdorni këtë fjalë thjesht sa për magjepsje; nëse doni, përdoreni thjesht për fuqinë e saj reklamuese. Ajo është një fjalë që nderohet nga njerëzit. Dhe, sigurisht, ajo lidhet me idealin politik se njerëzit duhet të trajtohen njëllëj. Pastaj, mund të bëni një kalim të fshehtë në mendjet e tyre nga ky ideal politik te besimi faktik se të gjithë njerëzit janë njëllëj. Veçanërisht me njeriun me të cilin po punoni. Për pasojë, mund ta përdorni fjalën *Demokraci* për të sanksionuar në mendjen e tij ndjenjën njerëzore më të degraduar (si edhe më pak të kënaqshme). Njeriun tuaj mund ta bëni të praktikojë, jo vetëm pa turp, por dhe me një shkëlqim pozitiv vetëmiratimi, një sjellje të tillë që, po të mos mbrohej nga fjala magjike, do të ishte përçmuar botërisht.

Po flas sigurisht për atë ndjenjë që e shtyn njeriun të thotë “*Unë jam po aq i mirë sa ti*”.

Avantazhi i parë dhe më i dukshëm është se, në këtë mënyrë, e shtyni njeriun të kurorëzojë një gënjeshtër të mirë, të qëndrueshme dhe të përsëritur në qendër të jetës së vet. Me këtë dua të them se jo vetëm që deklarata e tij është e rreme, kur në fakt ai është i barabartë me këdo në mirësi, ndershmëri dhe arsyetim aq sa mund të jenë

mali dhe deti të ngjashëm me njëri-tjetrin. Dua ta keni të qartë se ai nuk e beson as vetë këtë gjë. Asnjë njeri që thotë “*Unë jam po aq i mirë sa ti*” nuk e beson këtë në të vërtetë. Nëse do ta besonte vërtet, nuk do të fliste kështu. Për shembull, asnjë San Bernard nuk ia thotë këtë një qeni lodër, apo një shkencëtar një gdhëje, apo i afti të paafit, apo gruaja e bukur të shëmtuarës. Pretendimi për barazi, jashtë fushës së kufizuar politike, bëhet prej atyre që e ndiejnë veten, në njëfarë mënyre, inferiorë. Ajo që shpreh kjo thënie është pikërisht ndërgjegjësimi acarues, brejtës dhe pa rehat i inferioritetit, të cilin pacienti juaj refuzon ta pranojë.

Dhe, për rrjedhojë, ai urren. Po, dhe madje urren çdo lloj superioriteti tek të tjerët; shpif kundër tij; dëshiron asgjësimin e tij. Pas njëfarë kohe ai fillon të dyshojë se çdo dallim i vogël i të tjerëve është pretendim për superioritet. Askush nuk duhet të jetë i ndryshëm nga ai në veshje, zë, sjellje, argëtime, dhe zgjedhje ushqimi. “Ja, ky njeri flet anglisht shumë më qartë dhe më bukur se unë – duhet të jetë një përpjekje e pështirë, hipokrite për t’u dukur shtresë e lartë. Ky tjetri thotë se nuk i pëlqejnë hot-dogët - doemos, nuk dashka ta ulë veten kaq shumë. Ja dhe ky

tjetri që nuk e ka ndezur gramafonin e zyrës – duhet të jetë ndonjë erudit që kërkon të duket. Po të ishin njerëz për së mbari, ata do të ishin si unë. Nuk kanë pse të jenë të ndryshëm. Kjo nuk është demokratike”.

Tani, ky fenomen i dobishëm, në vetvete, nuk është aspak i ri. Nën emrin Zili, ai njihej nga njerëzit prej mijëra vitesh. Por deri më tash e konsideronin gjithnjë si vesin më të pështirë, si dhe më qesharakun. Ata që ishin të ndërgjegjshëm se ndjenin zili, kishin turp prej saj; ndërsa ata që nuk ishin të ndërgjegjshëm, nuk ua falnin të tjerëve këtë ndjenjë. Risia e lezetshme e situatës së tanishme është se mund ta ligjëroni atë – mund ta bëni të respektueshme, madje të lavdërueshme – duke përdorur magjepsjen e fjalës *demokratike*.

Nën ndikimin e kësaj magjepsjeje, ata që janë inferiorë në një mënyrë, apo një tjetër, mund të punojnë me më shumë zemër dhe më tepër sukses se kurrë më parë për t’i tërhequr të gjithë të tjerët në nivelin e tyre të ulët. Por jo vetëm kaq. Të ndikuar nga kjo gjë, ata që afrohen, ose mund të ishin afruar, pranë njerëzillëkut të mirëfilltë, në fakt largohen prej tij nga frika se mos bëhen *jodemokratikë*. Nga informacionet e besueshme

që kam, di se të rinjtë e sotëm e fshehin ndonjëherë shijen e brendshme për muzikë klasike ose letërsi të mirë, vetëm sepse kjo do bëhej pengesë për të qenë si të Tjerët; se njerëzit që do të donin vërtet të ishin – dhe u ofrohet Hiri për t’u bërë – të ndershëm, të dëlirë, ose të përkorë, refuzojnë ta bëjnë këtë. Nëse do të pranonin, kjo mund t’i bënte të Ndryshëm, dhe do ta cënonte sërish Mënyrën e Jetesës, do t’i ndante nga Bashkësia, do ta pengonte Integrimin në Grup. Dhe më e keqja, (tmerri i tmerreve!) do të ishin thjesht individë.

E gjithë kjo përmbledhet në lutjen e një vajze të re nga këto krijesa e cila, thuhet se u shpreh kështu kohët e fundit: “O Perëndi, më bëj vajzë normale të shekullit njëzet!”. Falë punës sonë, kjo do të nënkuptojë, gjithnjë e më tepër: “Më bëj bishtpërdredhur, budallaqe dhe parazitë!”

Ndërkaq, si një nënprodukt i dëshirueshëm, ata pak njerëz (të cilët pakësohen çdo ditë e më shumë) që nuk dëshirojnë të bëhen Njerëz Normalë, të Rregullt, të Integruar, si të Tjerët, gjithnjë e më tepër priren të bëhen *vërtet* njerëzit e zymtë dhe të çuditshëm që turma e hutuar beson se janë. Sepse dyshimi shpesh e kthen në realitet atë që dyshohet se ka ndodhur. (“Meqenëse,

çfarëdo të bëj unë, fqinjët do të më shohin si shtrigë apo agjente komuniste, atëherë më mirë të bëhem e tillë në realitet, meqenëse si qengjat, ashtu edhe delet, në një vend përfundojnë.”) Si rezultat, ne tani kemi një elitë intelektuale e cila, ndonëse shumë e vogël, është shumë e dobishme për kauzën e Ferrit.

Por ky është thjesht një nënprodukt. Unë dua t’jua tërheq vëmendjen te lëvizja e gjerë, e përgjithshme drejt diskreditimit dhe, si përfundim, eliminimit të çdo lloj arritjeje njerëzore - morale, kulturore, sociale apo intelektuale. Ja, a nuk është bukur të shohësh se *Demokracia* (në kuptimin e saj magjepsës), tani, po kryen për ne të njëjtën punë dhe me të njëjtat metoda siç bënin dikur Diktaturat më të lashta? Ju kujtohet kur njëri nga Diktatorët Grekë (atëherë, njerëzit i quanin “tiranë”) i dërgoi një Diktatori tjetër një lajmëtar për t’i kërkuar këshilla për parimet e qeverisjes. Diktatori pritës e çoi lajmëtarin në një fushë me drithë dhe kur arritën, nxori bastunin dhe goditi me të çdo kokë kalliri që ishte një centimetër më lart se niveli i përgjithshëm. Morali ishte i qartë. Mos lejo asnjë epërsi nga ana e vartësve. Vrit këdo që është më i mençur, apo më i mirë, apo më i famshëm,

apo më i bukur se masa. Bëji të gjithë një prerje; të gjithë skllëvër, të gjithë të parëndësishëm, të gjithë askushë. Të gjithë të barabartë. Kështu, Tiranët, në njëfarë mënyre, praktikonin “demokracinë”. Por tani “demokracia” mund të kryejë të njëjtin shërbim pa ndonjë tirani tjetër, veç të sajës. Sot nuk ka nevojë që dikush të shkojë përmes fushës me bastun. Në ditët e sotme, kallinjtë e shkurtër ua presin vetë kokat të mëdhenjve. Të mëdhenjtë po fillojnë ta presin vetë kokën nga dëshira për të Qenë Si Kallinjtë e tjerë.

E kam thënë gjithmonë se për të siguruar dënimin e përjetshëm të këtyre shpirtrave pa vlerë, këto krijesa që pothuajse kanë pushuar së qeni individë, duhet një punë e mundimshme dhe e kujdesshme. Por nëse shpenzohen energji dhe mjeshtëri të duhura, rezultatet janë të sigurta. Mëkatarët e mëdhenj *duken* më të lehtë për t’u kapur. Por ata janë të paparashikueshëm. Ndonëse mund t’i përdorni si të doni për shtatëdhjetë vjet, Armiku mund t’jua marrë nga duart në vitin e shtatëdhjetenjë të. Ata janë, pra, në gjendje të kryejnë pendim të vërtetë. Janë të ndërgjegjshëm se janë vërtet fajtorë. Nëse gjërat marrin kthesën e gabuar, ata janë gati t’i sfidojnë trysnitë

shoqërore rreth vetes për hir të Armikut, ashtu si më parë ishin gati t'i sfidonin për hirin tonë. Ndonjëherë është më e vështirë të ndjekësh dhe shtypësh një grerëz që endet sa andej-këtej, sesa të qëllosh, nga afër, një elefant të egër. Por elefanti bëhet më i rrezikshëm kur nuk e qëllon në shenjë.

Përvoja ime, siç e thashë edhe më parë, u përqendrua më tepër në sektorin anglez, dhe ende marr lajme për të më tepër se për çdo sektor tjetër. Ndoshta ajo që do të them tani nuk mund të aplikohet plotësisht në sektorët ku do të operoni ju. Por, përshtatjet e duhura mund t'i bëni kur të mbërrini atje. Disa gjëra jam thujse i sigurt se do t'ju vlejné. Nëse janë vetëm pak gjëra, duhet të punoni ta bëni vendin me të cilin po merreni sa më të ngjashëm me gjendjen e tanishme të Anglisë.

Në këtë tokë premtuese, fryma e *Unë jam po aq i mirë sa ti*, tashmë është bërë më tepër se një ndikim përgjithësisht shoqëror. Ajo po fillon të depërtojë në sistemin arsimor. Sa larg ka arritur ajo deri tani, nuk mund t'jua them me siguri. Dhe nuk ka rëndësi. Në çastin që kapni prirjen e përgjithshme, mund t'i parashikoni me lehtësi zhvillimet në të ardhmen; sidomos meqë ne vetë do të luajmë rolin tonë në këtë zhvillim. Parimi bazë në

arsimin e ri është se kokëgdhëtë dhe përtacët nuk duhet ta ndiejnë veten inferiore para nxënësve inteligjentë dhe punëtorë. Kjo do të ishte “jodemokratike”. Këto ndryshime mes nxënësve — sepse janë vërtet ndryshime të qarta dhe të dukshme *individuale*, — duhen fshehur. Kjo mund të bëhet në nivele të ndryshme. Në universitet, provimet mund të përpilohen në mënyrë të tillë që pothuaj të gjithë studentët të marrin nota të mira. Provimet e pranimit duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që të gjithë, ose pothuajse të gjithë qytetarët të mund të shkojnë në universitet, ndonëse mund të mos kenë as kapacitetin, as dëshirën për të përfutur nga arsimi i lartë. Në shkollë, nxënësit që janë tepër të trashë, ose përtacë për të mësuar gjuhë të huaja, matematikë dhe shkenca elementare, mund të kryejnë gjëra që bëjnë fëmijët në kohën e lirë. Për shembull, le të bëjnë punë me plastelinë dhe ta quajnë kurs modelimi. Por, gjithë kohën, nuk duhet lënë as përshtypja më e vogël se janë inferiore, madje edhe që ua kalojnë edhe fëmijët në këtë fushë. Me çfarëdo marrëzie që të merren, duhet të ketë (besoj se anglezët tashmë e përdorin këtë frazë), “barazi vlerësimi”. Skemë më drastike se kjo nuk mund të krijoni.

Fëmijët që janë të aftë për të kaluar në një klasë më të lartë, duhen mbajtur mbrapa në mënyrë artificiale, sepse të tjerët do të *traumatizoheshin* – për Belzebubin, sa fjalë e dobishme! – nëse lihen pas. Nxënësi i zgjuar duhet të mbetet demokratikisht i lidhur pas grupmoshës së tij gjatë gjithë karrierës së shkollës dhe fëmija që do të ishte në gjendje të studionte Eskilin ose Danten, do t'i duhet të dëgjojë përpjekjet e moshatarit të vet teksa mezi shqipton fjalinë MAÇI U UL TE SAÇI.

Me pak fjalë, nuk është e pabazë shpresa jonë për shkatërrimin e plotë të arsimit kur shprehja *Unë jam po aq i mirë sa ti* të ketë marrë dhenë. Të gjithë stimujt, apo ndëshkimet në lidhje me mësimin, duhet të zhduken. Ata pak nxënës që mund të duan të mësojnë, duhen ndaluar; pse kush janë ata që të jenë mbi shokët e tyre? Dhe mësuesi (apo duhet të them, infermieri?), sidoqoftë do të jetë tepër i zënë duke i siguruar dhe duke u rënë shpatullave kokëgdhëve, saqë nuk do të ketë kohë për ta harxhuar me mësim të vërtetë. Nuk do të na nevojitet më të planifikojmë dhe të lodhemi për të përhapur fodullëk dhe injorancë të pashërueshme mes njerëzve. Kafsha e mjerë do të na e lehtësojë vetë punën.

Sigurisht, kjo nuk mund të realizohet nëse nuk arrijmë ta kthejmë gjithë arsimin në shtetëror. Por edhe kjo do të realizohet. Është pjesë e së njëjtës lëvizjeje. Taksat penale, të planifikuara për këtë qëllim, po e bëjnë trokë Shtresën e Mesme, atë shtresë që ishte gati të kursente dhe të bënte çdo sakrificë për t'u ofruar fëmijëve arsim privat. Asgjësimi i kësaj klase, përveçse do të sjellë anulimin e gjithë arsimit, është fatmirësisht edhe një efekt i pashmangshëm i frymës që shprehet *Unë jam po aq i mirë sa ti*. Në fund të fundit, ishte ky grup shoqëror ai që u ka dhënë njerëzve shumicën dërrmuese të shkencëtarëve, mjekëve, filozofëve, teologëve, poetëve, artistëve, kompozitorëve, arkitektëve, juristëve dhe administratorëve. Nga tufat e kallinjve të gjatë të cilëve u duhet prerë koka, këta janë të parët. Siç u shpreh para pak kohësh një politikan anglez “Demokracia nuk do njerëz të mëdhenj”.

Do të ishte e kotë të pyesje një krijesë të tillë nëse, përmes foljes “do”, ka dashur të thotë “ka nevojë”, apo “pëlqen”. Por një gjë duhet ta keni të qartë; sepse këtu hyn në punë edhe një herë pyetja e Aristotelit.

Ne në Ferr, do të donim që Demokracia — në kuptimin

strikt të fjalës; forma politike me këtë emër — të zhdukej. Si të gjitha format e tjera të qeverisjes, ajo shpesh vepron në avantazhin tonë; por, në përgjithësi, më rrallë sesa format e tjera. Dhe ajo që duhet të kuptojmë është se “demokracia” në kuptimin djallëzor (*Unë jam po aq i mirë sa ti*, Të Qenit si të Tjerët, Bashkimi), është instrumenti më i shkëlqyer që mund të kemi në dispozicion për të zhdukur Demokracitë politike nga faqja e dheut.

Sepse “demokracia”, ose “fryma demokratike” (në kuptimin djallëzor), bëjnë që kombet të mos kenë më njerëz të mëdhenj dhe kështu krijojnë kombe kryesisht me njerëz gjysmë analfabetë, moralisht të paqëndrueshëm nga mungesa e disiplinës në rini dhe me vetëbesim të kotë për shkak të llastimeve që i kanë shoqëruar gjithë jetën. Dhe kështu e do Ferri çdo popull demokratik. Sepse kur një komb do të hyjë në konflikt me ndonjë komb tjetër që ka fëmijë të cilët kanë punuar vërtet në shkollë, ku talenti vlerësohet shumë dhe ku masa e injorantëve nuk lejohet të ketë influencë në çështjet publike, vetëm një rezultat është i mundshëm.

Kohët e fundit, një shtet demokratik u habit kur pa se Rusia ia kishte kaluar në shkencë. Çfarë demonstrim i

shkëlqyer i verbërisë njerëzore! Pse prisnin ata që shkencëtarët e tyre të shkëlqenin, kur gjithë kohën e kishin udhëhequr shoqërinë drejt kundërvënies së çdo lloj arritjeje?

Detyra jonë është të inkurajojmë ato sjellje, gjeste dhe qëndrime që demokracitë pëlqejnë dhe shijojnë natyrshëm, pasi këto janë pikërisht gjërat që, nëse nuk kontrollohen, e shkatërrojnë demokracinë. Ndonjëherë të vjen habi se si është e mundur që njerëzit vetë nuk e shohin dot këtë. Edhe sikur të mos e lexojnë Aristotelin (sepse kjo do të ishte jodemokratike), prapëseprapë, nga Revolucioni Francez do ta kishin mësuar se sjellja që u pëlqen natyrshëm aristokratëve nuk është ajo sjellje që e ruan aristokracinë. Pastaj, do të mund ta aplikonin këtë parim në të gjitha format e qeverisjes.

Por nuk dua ta mbyll me këto nota. Ferri na ruajttë! Nuk dua të inkurajoj në mendjen tuaj atë iluzion që duhet ta ushqeni me kujdes në mendjet e viktimave tuaja njerëzore. E kam fjalën për iluzionin që fati i kombeve, *në vetvete*, është më i rëndësishëm se ai i individit. Rrëzimi i popujve të lirë dhe shumëfishimi i shteteve skllave shërbejnë si mjete për ne (edhe si argëtime, patjetër); por

qëllimi i vërtetë është shkatërrimi i individëve. Sepse vetëm individët mund të shpëtohen ose të dënohen përjetësisht, dhe vetëm ata mund të bëhen bij për Armikun ose ushqim për ne. Për ne, dobia më e madhe e një revolucioni, lufte, apo periudhe urie qëndron në ankthin, tradhtinë, urrejtjen, zemërimin dhe dëshpërimin e individëve që ajo shkakton. *Unë jam po aq i mirë sa ti* është mjet i dobishëm për shkatërrimin e shoqërive demokratike. Por kjo ka vlerë shumë më të thellë kur bëhet një qëllim në vetvete, një gjendje mendore, e cila, duke përjashtuar natyrshëm përlulësinë, dashurinë, kënaqësinë dhe të gjitha shprehjet e mirënjohjes ose admirimit, e largon qenien njerëzore nga pothuajse çdo rrugë që mund ta çonte përfundimisht në Qiell.

Por, le të flasim tani për pjesën më të këndshme të detyrës sime. Kam nderin të ngre një dolli, në emër të të ftuarve, për shëndetin e Drejtorit, Z. Gojëllëmsh, dhe Shkollës së Trajnimit të Tunduesve. Mbushini gotat. Çfarë po më shohin sytë? Çfarë është kjo buqetë e këndshme aromash që po nuhas? Mos është ajo që mendoj unë? Z. Drejtor, i tërheq mbrapsht të gjitha fjalët e rënda për darkën. Po shoh, dhe po nuhas, se edhe në kohë lufte,

qilari i Shkollës ka ende verë të vjetër dhe të mirë prej *Fariseu* me duzina. Pa shiko, pa shiko! Më duket sikur m'u kthyen kohët e vjetra. Mbajini pak gotat nën flegrat e hundës, djallushë. Afrojini tek drita. Shikojini ato deje të zjarra që përdridhen dhe spërdridhen në zemrën e tij të errët, sikur po grinden me njëra-tjetrën. Dhe kështu po bëjnë, në fakt. E dini nga çfarë përzierjesh vjen kjo verë? Tipa të ndryshëm Fariseu janë mbledhur, shtypur dhe fermentuar së bashku për të prodhuar këtë shije dinake. Tipa që e urrenin njëri-tjetrin me gjithë shpirt kur ishin në tokë. Disa ishin mbushur vetëm me rregulla, relike dhe rruzare; të tjerët vishnin vetëm rroba të vjetra, ngrysnin fytyrat dhe ruanin në mënyrë tradicionale heqjen dorë nga gjërat e vogla si vera, loja me letra, apo teatri. Të dyja këto grupe kishin të përbashkët vetëdrejtësinë dhe distancën pothuajse të pafundme midis këndvështrimit të tyre real dhe çdo gjëje që urdhëron dhe është vërtet Armiku. Ligësia e feve të tjera ishte e vetmja doktrinë e drejtë në fenë e tyre; sharjet ishin ungjilli i tyre dhe përçmimi ishte kthyer në litani. Sa shumë e urrenin njëri-tjetrin kur jetonin atje lart ku shkëlqente dielli! Dhe sa më tepër urrehen tani që janë përjetësisht të bashkuar me

njëri-tjetrin, por kurrë të pajtuar. Kombinimi i shtangies me zemërimin që ndiejnë ata, si dhe kalbja e inatit të tyre të përjetshëm e të papenduar, do të veprojnë si zjarr kur të kalojnë nëpër aparatin tonë tretës. Si zjarr i errët. Në fund të fundit, o miq të mi, për ne do të ishte fatkeqësi e madhe, nëse, një ditë, ajo që shumica e njerëzve quajnë “fe” do të zhduket nga faqja e Dheut. Ajo mund të na furnizojë akoma me mëkate vërtet të shijshme. Lulja e shkëlqyer e ndyrësisë mund të rritet vetëm në fqinjësi të ngushtë me të Shenjtën. Nuk ka vend më të suksesshëm për tundimet tona sesa në shkallët e vetë altarit.

Z. Drejtor, Poshtëmadhëria juaj, Turpmëdhenj, Gjemba, Hije dhe Djallushë: Përpara jush, ngre një dolli për shëndetin e – Drejtorit Gojëlëmsh dhe Shkollës!

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Lewis, C. S. (Clive Staples)

Letrat e Hirziut: drejtuar një djalli të ri, nga xhaxhai
i tij i moshuar / C. S. Lewis; përkth. Sergej Meçe;
red. Fabiola Kadi. – Tiranë: Vision Printing, 2021
226 f. ; 12.7 x 18 cm.

Tit. origj.: The Screwtape letters

ISBN 978-9928-295-64-4

1.Krishtërimi

2.Jeta e krishterë